


TEUTA KARANXHA (GANXO)



Elbasani



Gjirokastra

Prëfime
Abresa dhe Ryjtme

Shkëtitë libër
ja shfaq bibliotekën
se qytetit Catocastër qyteti
of 20.2.016 85H-94
K 31 i lindjes

TEUTA KARANXHA

MBRESA DHE KUJTIME...

*(Rrëfim autobiografik për jetën, punën, familjen,
shoqërinë dhe qytete që unë dua)*



Prill, 2015

Titulli: **“Mbresa dhe Kujtime...”**

Autori: **Teuta Karanxha (Ganco)**

Faqosi: **Diamanda Kapo**

Redaktore: **Manjola Hatellori**

Shtëpia Botuese: **Flesh Tirana**

ISBN **978 – 9928 – 121 – 39 – 3**

Shtypur në Shtypshkronjën **“Ylli Elbasan”**

TEUTA KARANXHA (GANXO)

H Y R J E

Ky rrëfim për jetën, punën, prindërit, familjen, shoqërinë si dhe qytetet e dashura të autores, është ndarë në disa kapituj nëpër të cilat tregohen ngjarjet, ndodhitë e jetës që nga fëmijëria, rinia e deri më vonë tek mosha më e pjekur. Në të flitet për familjen, bashkëngjitur me rrëfimin për jetën e saj, atë të prindërve, si dhe më vonë familjen e re. Gjithashtu rrëfëhet për aktivitetet si: për punën, shkollat dhe profesionin e saj. Është për t'u theksuar të treguarit për prindërit, veçanërisht për përkushtimin e tyre ndaj rritjes së fëmijëve, vështirësitë që ata kanë hasur dhe i kanë kaluar në kohën e tyre.

Këto ngjarje të jetuara e të treguara nga autorja, vijnë shumë reale, të vërteta, natyrshëm ashtu si kanë ndodhur dhe janë ngulitur në mendjen e rrëfyeses, në fëmijërinë e saj dhe në të gjitha etapat e jetës. Këto rrëfime kanë shumë rëndësi. Ato janë si një galeri; të grumbulluara si mineralet e jetës së saj, që nga më i liri e deri tek ai më me vlerë, diamanti. Kjo jetë e jetuar dhe e treguar është më shumë se një pasuri e madhe me vlerë, këto kujtime janë të pa krahasuara me vlerën e çdo malli, sado i kushtueshëm qoftë. Të ruajtura në memorje, tani ato kanë ardhur që të flasin vetë nëpërmjet autores, e nëpërmjet këtij shkrimi, të tregohen e të bëhen më të gjalla, më të freskëta për të mos u mbuluar nga pluhuri i harresës me kalimin e viteve të jetës.

Nëpërmjet këtij rrëfimi, njerëzit, familjarët, të afërmit, miqtë si dhe të tjerë lexues njihen me jetën e një gruaje të thjeshtë, në një jetë jo aq të zakonshme të saj, me problematikat e jetës e të punës së saj si në familjen e origjinës, po ashtu dhe atë të saj, me fëmijët e bashkëshortin e saj, duke u përballur me të gjitha vështirësitë si dhe të gjitha përpjekjet, me vullnetin për t'i kaluar ato. Kjo jetë ka kaluar nëpër disa qytete të vendit, prandaj dhe tregohet si e tillë, e ndarë në disa episode. Në mendjen e autores janë shumë të dashura kujtimet e saj të vegjëlisë, veçanërisht në qytetin e saj

TEUTA KARANXHA (GANXO)

të lindjes. Këto kujtime zenë vendin e parë për sa i përket ndjeshmërisë, nostalgjisë në terësinë e kujtimeve. Ato janë më të dashura, më të bukura, më të shtrenjta nga të gjitha, më të paharruara bashkë me ato që lidhen me prindërit si dhe motra, vëllezër në familjen e origjinës si dhe atë të re, me fëmijët e bashkëshortin. Këto kujtime do shërbejnë si një pasqyrë për t'u parë në to.

TEUTA KARANXHA (GANXO)

Të lindësh në një qytet apo në një tjetër është rastësi, është fat. Këtë asnjëri nuk e zgjedh dot vetë, por për mua kudo që të lindësh është mirë, është bukur. Secili prej nesh e ka një vend në të cilin ka lindur. Unë e pata fatin tim që të lind në një qytet të veçantë, unë kam lindur në një prej këtyre qyteteve, në qytetin e Gjirokastrës, aty nisi zanafillën, rrugëtimin, jeta ime. Përpara se të flas për jetën time, dua të citoj disa vargje të nënë Terezës për jetën.

Jeta është shumë e bukur, duaje/ Jeta është e shtrenjtë, mbroje/ Jeta është jetë, jetoje/ Jeta është luftë, fitoje/ Jeta është dashuri, dashuroje/ Jeta është këngë, këndoje/ Jeta është poezi, recitoje/ Jeta është sfidë, sfidoje etj

Ja disa vargje të bëra për jetën time:

Më prite o jetë në krahët e tu, kur unë u linda,
si një zogth i vogël pa krahë, ti më zgjate dorën,
e unë u ngrita dhe hyra në rrugën tënde e ja,
ashtu e vogël, topolake nisa të hedh hapat e parë drejt teje...
Ishin prindërit, që më deshën e më sollën në këtë jetë!

Ishte Zoti ai që deshi që unë të lindja,
isha dhe vetë unë që të doja ty, e doja të jetoja!

Po ti o jeta ime, çfarë bëre me mua?

Më deshe vërtet që të vija tek ty?

E di që më ke dashur që kur u ngjiza si embrion në barkun e nënës sime,

që kur linda prej saj.

Por pasi linda e hyra në rrugën tënde,

nuk dija të ecja të hidhja hapat e par, por u ngrita në këmbë,

ti më mësove, më hape krahët e tu, më përfshive,

më ndihmove që t'i drejtoja hapat, por më pas në rrugën tënde,

sa herë më ke ulur e më ke ngritur, sa herë kam rënë,

jam rrëzuar, jam shembur në gurët e tua,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

jam plagosur nga ato goditjet e tua, si dhe nga stuhitë, rrebeshet, sfidat e tua!

Sa herë më ke bërë për të qarë, po dhe për të qeshur, e sa herë jam tërhequr zvarrë si një shpend i plagosur pa këmbë e krahë?!

Sa herë ti më ke drejtuar trupin lart për të ecur përpara, sa herë.....o jeta ime, sa herë?

Po ti prapë më ke zgjatur duart e tua dhe më ke ngritur, se dhe unë kam dashur që ta vazhdoj rrugën tënde, kam dashur që të jetoj, kam dashur dhe të të sfidoj!

Jam mjekuar me melhemet e tua, me ato që më ke ofruar ti!

Jam drejtuar e ngritur në këmbë, kam ecur në tokën tënde, jam larë e rrahur në dallgët e lumenjve, si edhe të detrave e të oqeaneve të tu!

Kam thithur, atë ajrin tënd, kam kundruar çdo gjë tënden si: qiellin, kodrat, malet, fushat, pyjet, gjelbërimin tënd!

Unë i shijova të tëra, i durova të gjitha që më dhe, sëmundjet, vdekjet,

si dhe çdo gëzim e kënaqësi që më ke dhënë!

Çastet e lindjes së fëmijëve të mi, rritjen e tyre,

lindjen dhe rritjen e mbesave e të nipërve,

çdo gjë që më dhe, i kam shijuar të tëra, ca me kripë e ca me sheqer, e ca të hidhura farmak!

I shijova se m'i dërgove ti, prandaj dhe jam në këmbë e rrugëtoj në rrugët e tua!

E tani, që jam ulur për një çast, jam ndalur e po kthej kokën pas, që të shikoj ku unë kam ecur në gjithë këto vitet e jetës sime, për të parë ç'kam bërë, si e ku kam shkelur në rrugët e tua si bashkëudhëtare,

në atë rrugën tënde dhe atë timen, që ma drejtove e ma tregove ti,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

që unë kam ecur, herë me vrull e herë me hap të ngadaltë, apo dhe normal,

ashtu si e binte puna ime dhe si ka qenë dhe rruga jote, herë e drejtë dhe herë me zigzake!

Unë i kam kaluar të gjitha rrugët, të gjitha pengesat e vështirësitë, jam munduar të eci drejt edhe aty ku rruga ka qenë me kthesa e me pengesa,

kam bërë shumë rrugë e shumë punë,

por të gjitha këto i kam bërë, se kam pasur vullnet, dëshirë, dashuri për të të jetuar ty!

E kam pasur dhe detyrë përderisa u linda, duhej të kaloja në rrugët e tua,

kështu më mësuan dhe mua të parët e mi, ata që më lindën dhe më rritën,

sepse edhe ata kështu kanë bërë, ashtu bën çdo brez njeri pas tjetrit.

Jeta është si një stafetë, aty ku e le njeri, e vazhdon tjetri, ajo kalon nga prindi tek fëmija,

ajo është një cikël, që nuk mbyllet, që nuk mbaron,

por që kalon nga njeri tek tjetri...

Jeta është e vazhdueshme nëpër breza, por e papërsëritshme, e pakthyeshme për secilin,

ajo ka vazhdimësi, aty ku e përfundon njeri e nis tjetri,

prandaj dhe jeta nuk shteret, por vetëm lindin dhe jetojnë të tjerë pasardhës të secilit.

Në këtë stacion ku unë kam ndaluar, për të vazhduar sërish në rrugën tënde o jeta ime,

më pëlqen të rri dhe pak, të shikoj me sytë e mendjes të gjitha gjërat që kam bërë,

të kërkoj se çfarë nuk kam bërë e në se mundem ta bëj tani, sa jam duke të jetuar ty o jetë,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

se më pas nuk do të mundem të të kem më, nuk do jem më, që të të jetoj!

Tani po filloj t'i kujtoj pjesët më kryesore të jetës time dhe t'i hedh pse jo në letër me qëllimin, për t'i pasur para syve sa herë të dua t'i lexoj, t'i kujtoj si unë dhe familjarët e mi. Ja se si rodhi kjo jeta ime nëpër qytetet e mia, aty ku unë kam rrugëtuar, nëpër stacionet e mia në trenin e jetës time. Ajo nisi në një nga qytetet që unë dua më shumë, me Gjirokastrën. Pikërisht me këtë qytet, ndër të tjerët, ku kam qenë, më shumë është ky. Po çfarë ka të veçantë ky qytet për mua, do ta rrëfej më poshtë.

Gjirokastra dhe prindërit e mi

Do ta filloja rrëfimin e jetës time me qytetin më të dashur, më të shtrenjtë për mua me të parin në rrugën e jetës time, me atë **Gjirokastrën, vendin që më lindi, më rriti më bëri me ardhjen e moshës grua dhe nënë.** Unë do ta quaja fat që kam lindur në këtë qytet. Besoj se, shumë e kanë parë dhe njohur këtë qytet, të cilin pa dyshim e kanë pëlqyer, por po të më pyesni mua se çfarë ndjej për të t'ua them, ndjej shumë dashuri, shumë mall, shumë nostalgji, shumë krenari e që të mos vazhdoj më me këto shumë kam shumë të tjera gjëra të mira që unë ndjej për këtë qytet, që janë më shumë. **Eshtë qyteti i zemrës time i shpirtit tim, një qytet i lashtë e i hershëm sa vetë jeta, qyteti i princeshës Argjiro, e cila për të mos u dorëzuar tek turqit u hodh nga kalaja e qytetit, i cili ka marrë emrin e saj, duke u bërë i ngjashëm ky qytet, kjo kala me kalanë e Rozafës në Shkodër, ku sipas legjendës u muros nusja e djalit të vogël, për të mos u rrëzuar muret e kalasë. Kështu me një ngjashmëri të përafërt, por jo njëlloj edhe kalaja e qytetit të Gjirokastrës u la me gjak, me atë të Argjirosë që u vetësakrifikua në një farë**

TEUTA KARANXHA (GANXO)

mënyre. Gjirokastra është qyteti i Çerçiz Bajo Topullit, luftëtarëve e patriotëve të paepur të këtij qyteti, që u përlëshën me turqit për ta shpëtuar nga sundimi turk. Trimi, Çerçiz Topulli, së bashku me një luftëtar tjetër, Hiton, siç e dimë dhe nga historia, vranë bimbashin turk. Për këtë atij i këndohet edhe kënga: kush e vrau, kush e vrau, kush e vrau bimbash pashanë, Çeçoja me Hitojanë. Ashtu si e thotë dhe kënga, Hitoja ishte, një tjetër luftëtar, që së bashku me Çerçizin e çetën e tij kanë bërë sa e sa luftra kundër turqve. Përmendorja e Çerçizit është sipër kur shkon tek sheshi i madh i qytetit, kur do ngjitesh në pazarin e Gjirokastrës, pa u ngjitur dhe mirë pasi ke kaluar rrugën e Bendit, siç i ka mbetur emri qysh atëhere, aty ku sot pranë monumentit pak me sipër është hotel Turizmi, e sipër tij më lart fillon rruga me kalldrëm për në mesin e pazarit siç e quanim ne e siç e kanë quajtur të parët tanë e kështu quhet dhe sot akoma. Në mesin e pazarit sipër, është një kryqëzim rrugësh, i cili të shpie në lagje të ndryshme si në ato të lagjes Manalat, Cfake, Zinxhira, Dunavat, Partizani, e po të vazhdosh akoma më poshtë në qendër të qytetit, janë lagjet Palorto, Varosh, Hazmurat, Pllakë.

Në fillim fare, kur hyn në qytet, pasi kalon Gërhotin, në rrugën nacionale, te kryqëzimi, ngjitur me karburantin rruga drejt lart për në qytet, në kthesën e parë djathtas kur ngjitesh përballë me ndërtesën e NPV-së të atëhershme, fillon lagja 18 Shtatori, lagjja e re e qytetit e pak me sipër saj, lagjja Granice që është ndërtuar më vonë mbi kodër. Por më e rëndësishme në këtë prezantim të qytetit, të mos harrojmë të përmendim kalanë madhështore, që duket si një vapor i madh në det, që qëndron hijerëndë krenare e lashtë si për të na treguar që i ka shërbyer shumë këtij qyteti, banorëve të tij e ka mbrojtur, e ka strehuar në raste luftrash e bombardimesh me topa e mortaja, artileri e avione, ajo i ka mbajtur banorët e saj në bedena dhe i ka rezistuar kohës. Por

TEUTA KARANXHA (GANXO)

madhështi ketij qyteti i japin dhe malet e vargmalet si: Lunxhëri, Nëmërçkë, Dhëmbel, Mali i Çajupit, mali i Gjerë, më tej mali i Sopotit, në kufi midis Gjirokastrës dhe fshatit Topovë, Zagori si dhe kalaja e Shëndejadhës e të mos harrojmë lumin Drino, që kalon në anë të qytetit, i cili derdhet në Vjosë. Por qyteti ka dhe një liqen, ai i Viroit, i cili i ka shërbyer qytetit për të shëtitur duke bërë piknike qytetarët e këtij qyteti, për t'u argëtuar duke e bërë panoramën e këtij qyteti edhe më të bukur, në të cilin ka male, kodra, lumenj, liqen e kala, e ku ka më bukur se kaq! Po ky është qyteti im dhe nuk është vetëm i imi, por i të gjithë atyre gjirokastritëve, atyre që jetojnë aty apo dhe që janë larguar, i shumë bijve të tjerë heronj e dëshmorë që e kanë larë me gjakun e tyre këtë qytet, për t'a çliruar nga okupatorët si: Myzafer Asqeri, Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima, Musine Kokalari etj. Është dhe qyteti i shkrimtatit të njohur Ismail Kadaresë, që ka shkruar për këtë qytet, na ka nderuar ne dhe kombin e tij me gjithë ato krijimë, të pavdekshme si për qytetin e tij dhe për Shqipërinë mbarë, veprat e të cilit i kanë kaluar kufijtë e vendit tonë. Gjirokastra është qyteti edhe i skulptorit të njohur Montaz Dhrami, i cili ka bërë shumë vepra në skulpturë, i shkrimtarit për fëmijë Tasim Gjokutaj, ndjesë pastë i cili ka shkruar shumë bukur për fëmijët, e shumë e shumë të tjerë mësues të nderuar, mjekë të zotë, si: doktor Kalivopulli, i cili i ka shërbyer shumë si vendasve edhe të tjerëve që vinin nga larg për t'u vizituar, siç na tregojnë prindërit e gjyshërit tanë, si dhe e këngëtarit të njohur gjirokastrit, bylbylit të Jugut, Petrit Lulo, i cili i ka kënduar bukur qytetit të tij e shumë njerëz të tjerë të nderuar të profesioneve të ndryshme, që sot nuk janë më që kanë jetuar e punuar në këtë qytet.

Ky pra është qyteti i të parëve e të bashkëkohësve që jetojnë aty. Ky është qyteti im, me panoramën e tij të rrallë si dhe me konturet e tij e huret e tij të veçanta. Kjo është Gjirokastra ime nuse, Gjirokastra plakë që mban shumë vite mbi supet e saj, me sokaket

TEUTA KARANXHA (GANXO)

e saj të qenditur me kalldrëm, me anetë e plakat e mëdha e të moçme, si tregon i **madhi Ismail Kadare** në shkrimet e tij për Gjirokastrën në romanin e tij, “**Kronikë në gur**”, me shtëpitë e gurta e çatitë e tyre që duket sikur po ndjekin njëra-tjetrën, shtëpi këto që duken si pallate guri, **thekson Ismaili në shkrimin e tij “Vepra”**. Gjirokastra me gratë nikoqire e pastërtore, që dinë të kullandrisin shtëpinë edhe me pak lekë, duke bërë me duart e tyre byrekun e mirë e të preferuar me lakra, karkanaqet, trahananë për dimër e zahire të tjera, si: turshi të ndryshme e shumë gjëra të tjera, si: lakrori me mish apo me zorrë të mbushur me oriz me qepë e me mish të grirë ose me çopa mishi të qengjit me qepë e erëza, byrekët e tjerë me kos e djathë si dhe me kungull me qumësht, sheqer e pak kripë ose mishi i qengjit i pjekur në furrë me dru apo në saç në kushtet e shtëpisë, bakllavaja, hasudeja e bardhë si bora, që janë gatime tradicionale etj., gatime që janë për të lëpirë gishtat. Sa për byrekun me lakra, që më sipër e permenda si një byrek karakteristik, ai bëhet me lakra të egra, këtu e ka dhe veçantinë e tij për këtë qytet, por dhe e gjithë treva e jugut e bën këtë byrek. Për këtë byrek ka dhe një këngë të kënduar nga gjirokastritët. Ja disa nga vargjet e saj: “byreku me lakra / seç e gatoi e varfëra...” Por ky byrek që është bërë dikur në kohët e para, siç kanë qenë ato të luftës e të urisë, më pas saj si një gatim i shpejtë dhe me pak shpenzime, bëhet dhe në ditët e sotme dhe në krahina të tjera të vendit, sepse është i ushqyeshëm, me vlera të veçanta për organizimin e njeriut edhe dietologët e sotëm e vlerësojnë këtë lloj byreku, pasi është dhe i lehtë e i asimilueshëm për trupin e njeriut.

Por, përpos gatimeve tradicionale, Gjirokastra ka dhe të veçantën e saj tek banorët e saj. Kjo është Gjirokastra e burrave të fortë si vetë qyteti, punëtorë e të ndershëm, me karakter e me sedër, me zakonin e mikpritjes si për burra e gra e deri tek fëmijët që e presin mikun me gjithë të mirat, e nderojnë e respektojnë akoma

TEUTA KARANXHA (GANXO)

dhe sot, Gjirokastra e vajzave e nuseve të reja që ato dikur, uleshin në sofatet e gurta pranë shtëpive apo në oborret e tyre dhe qendisnin pajën e tyre, të cilën e shpinin tek shtëpia e burrit, kur ato martoheshin. Gjirokastra, mbahet shumë edhe për këngën e saj polifonike, në grup, këngën e jugut, që ja marrin e ja kthejnë 2 veta, d.m.th. një e merr dhe një e kthen, por ka dhe raste nga 3 veta, ku veç atyre 2 të parëve, i treti ja hedh e të tjerët që janë grupi, mbajnë iso. Kjo këngë është e veçantë dhe këndohet nga burra e gra, pa muzikë pa orkestër e vegla muzikore, por vetëm me zërin e tyre, me gojën e tyre, ata që e këndojnë që e ngrenë peshë e ajo buçet e fortë, e bukur, e dashur për të gjitha familjet gjirokastrite.

Këto këngë polifonike si të Gjirokastrës dhe ato të qyteteve të Jugut, siç janë: të Sarandës, Delvinës, Tepelenës, Përmetit, Himarës e Vlorës, pra të trevës së Jugut, janë shumë të hershme, mijëvjeçare. Këto këngë, ky epos, siç e përmend dhe Ismail Kadare në veprat e tij, kanë lindur pothuajse bashkë me njerëzimin, mund të jenë mijëvjeçare, afërsisht me jetën njerëzore. Këto këngë e valle të Jugut si dhe ato të krahinave të tjera të vendit, këndohen edhe në gëzimet familjare të këtyre familjeve edhe nëpër dasma, sidomos ato të Jugut të vendit, nuk rrihet pa kënduar sikur një këngë labe me iso të gjatë. Natyrisht gjatë kohës, këto këngë edhe mund të kenë pësuar ndryshime me atë të fillimeve të hershme, p.sh. të njerëzve që kanë jetuar shumë kohë përpara nëpër breza të ndryshëm njerëzore edhe kënga, vallja, rapsoditë, elegjitë, eposi si dhe legjendat e përrallat, kanë pësuar ndryshime që i kanë bërë njerëzit gjatë kohëve, por po të shikosh thelbin dhe përmbajtjen është e njejtë. Ashtu si në fillimet e kohëve letërsia gojore ka qenë përpara asaj të shkruar edhe kënga e vallja si dhe legjendat e thëna me gojë, kanë pasur dhe ato përparësi para shumë kohëve, por më vonë në Shqipëri, ashtu si dhe në vende të tjera, kur filluan që të shkruhen si letërsi, librat

TEUTA KARANXHA (GANXO)

e parë, vjershat, këngët, valet, atëhere doli më sipër më lart, kjo e fundit, ajo e shkruar. Kjo, sipas shkrimtarëve, e sidomos siç e thekson dhe Kadare, kur flet për zhvillimet e letërsisë, artit, në Shqipëri, thekson se, një vjershëtor ose rapsod, në ato kohërat e para, që ishte shumë i njohur dhe i dëgjuar, po të mos ia mësonte dikujt tjetër ato gjëra arti, të cilat i bënte me mënyrën e të folurit pa i shkruar, sepse kjo nuk qe akoma e mundur, për shkak të moszhvillimit, ai talent i atyre që e kishin, ai art apo muzikë do të vdiste, do të mbaronte me atë brez.

Bërja e mundur e të shkruarit të këtyre vjershave, prozave, këngëve, valleve me anë të librave, të koreografive etj., në të gjithë botën mbarë, bëri që ai art të mos të vdesi kurrë, të mos të shteret. Në vendin tonë midis shumë këngëve labe e atyre polifonike popullore, një pjesë e të cilave edhe kërcëhen në valle popullore të shtruar, dorë për dorë me grupin, pa orkestër, po me vete këngën e kënduar nga ana e atyre që e marrin vallen, është dhe kjo. **“Në bashtetë e tua moj, / 40 rrënjë molle, / seç na u rrit kjo vajza moj, / na i bën me dorë. / Mos na i bëj me dorë moj, / por folna me gojë, / se na shohin bota moj, / kushedi se çfarë thonë” / etj..., këngë si kjo. Një këngë tjetër e bukur dhe e veçantë është dhe kjo: “Dallëndyshe vogël o’ dale dale. / Pritëm sa të rritem o’ dale dale. / Të bëhem sa shoqet o’ dale dale, / sa Gjirokastritet o’ dale dale” / etj.. Të tilla këngë si dhe ajo që i këndohet trimit Çerçiz Topulli, këndohen dhe kërcëhen në gëzimet familjare, siç e thashë dhe më lart. E tillë është kënga si: **“Te rrapi në Mashkullorë, / foli Çerçizi me gojë, / Foli Çerçizi me gojë, / Mylazim largo taborë, / Mylazim largo taborë / Ieri djemtë e mi të shkojnë, / Ieri djemtë e mi të shkojnë, / do t’ju skuq t’ju bëj me bojë, / do t’ju skuq t’ju bëj me bojë, / Çerçiz Topulli më thonë”**. Edhe ne, në familjen tonë të madhe në Gjirokastër me njerëzit tonë të afërt i këndojmë e kërcëjmë këto këngë. Motrat e mia këndojnë bukur sidomos Lida**

TEUTA KARANXIIA (GANXO)

dhe Beta, me motër Lidën, unë bëja zërin e dytë kur këndonim duet, kur ishim vajza të reja të pamartuara, në shtëpinë tonë të prindërve në Gjirokastrë. Ajo ka zë shumë të ëmbël, por tani jeton në Greqi, e martuar prej vitesh. Edhe motër Beta këndon me mua akoma dhe bën dhe zërin e parë dhe të dytë, po kështu dhe xhaxhai im Mustafai, vajzat e mia si ajo më e madhja dhe sidomos dhëndri, po dhe mbesa ime e madhe, vajza e vajzës, Dea, po dhe djali nga pak na shoqëron, këndojmë të gjithë bashkë. Xhaxhai im, ka një zë si bariton i vërtetë. Kënga jonë e preferuar korçare që, ne këndojmë në gëzimet familjare unë, xhaxhai dhe motër Beta, është ajo si më poshtë: **“Perëndesh e bukurisë më je,/ unë për ty moj do të pëlcam,/ dashurinë që kam shtënë për ty,/ ububu si do tja bëj!”/ etj..** Ne të tre formojmë një trio shumë të mirë. Po ashtu dhe vëllezërit e mi bëjnë iso. Edhe hallat e mia këndonin, tani janë vetëm dy e nga këto hallë Bala, ja merr mirë këngës popullore gjirokastrite, ajo ka një zë të shtruar edhe kushërinjtë e mi nga nëna si edhe nga babai këndojnë, si psh: djali i hallës time të madhe, Limozi, këndon e kërcen bukur si, këngën dhe vallen popullore. Edhe dajallarët e mi këndonin mirë, ja mernin dhe ja kthenin mirë këngës së bukur popullore, e të tjerët mbanin iso, tani ata nuk jetojnë më si dhe 4 hallat e mia, kanë ndërruar jetë, ndjesë të kenë. Nga dajallarët e mi, më shumë më është dhimbsur kur ka vdekur ai më i vogli, Nazmiu, i cili së bashku me gruan e tij Hazbon, vdiqën të rinj, sidomos ajo, gruaja e tij, Hazbua, e cila iku shumë e re. Unë i doja shumë që të dy edhe ata më donin, na donin të gjithëve ne nipërit e mbesat, si nga ana e jonë dhe nga ana e njerëzve të nuses së dajkos tim. Ata nuk patën vetë femijë dhe për këtë ne i donim dhe i ndihmonim shumë, si p.sh.: në punë të rënda në shtëpi, si: prerja e druve që ja bënë vëllezërit e mi, si dhe të tjera punë. Unë i merrja dhe dilnim dhe shëtitje në ditën e dielë mbasdite, që ata nuk kishin punë, ishin pushim. Në një vit ne shkuam bashkë dhe në një kamp

TEUTA KARANXHA (GANXO)

pushimi, në Durrës, ku kaluam shumë mirë, me ne ishin dhe xhaxhai im dhe nusja e tij me vajzën e tyre 2 vjeçe, Blerinën. Duke shëtitur e luajtur me vajzën e vogël të xhaxhait tim, me Blerinën, gruaja e dajkos tim, Hazbua, e llastonte shumë atë, Blerinën, duke i thënë ylli i detit, pasi ajo ishte e vogël, topolake dhe e bukur si ndonjë kukull. Unë shkoja shumë me të dy çiftet e sipërpërmendura, si me dajkon dhe nusen e tij, Hazbon, ndjesë të kenë dhe me xhaxhanë dhe nusen e tij, Fatën. Kam qenë tip i shoqërueshëm edhe i afroja edhe më afronin e më donin.

Por, pa u larguar nga rrjedha e të rrëfyerit, duke qenë se jemi tek qyteti im i lindjes, duke treguar për të, theksoj se, Gjirokstrës, shumë i ka kënduar në vitet e diktaturës edhe këngëtarja e madhe e muzikës popullore, Fitnete Rrexha, e cila edhe e ka vizituar në kohën e festivaleve folklorike që bëheshin në këtë qytet pothuaj në çdo vit në muajt Shtator apo Tetor, ku vinin këngëtarë, valltarë dhe grupe nga e gjithë Shqipëria. Këto zhvilloheshin në kalanë e qytetit, e cila gjëmonte nga muzika, lodrat e daullet e orkestrave që i shoqëronin këngëtarët e grupet e tyre e të valltarëve, nga të cilat gjëmonte i gjithë qyteti. Kjo atmosferë zgjaste për 1 javë rresht e qytetarët gjirokastritë ishin bërë në ato kohë edhe streha e këtyre të ardhurve. Meqenëse ishin shumë, ata shpërndaheshin nëpër familjet gjirokastrite mbrëmjeve që mbaronin koncertet, për të vazhduar të nesërmen. Mikpritja ishte e madhe e me dëshirë. Njerëzit, mbaj mend, shkonin në kala për të parë e dëgjuar këto koncertet folklorike, e më pas, në mbarim të tyre, në mbrëmje nuk largoheshin pa masë sipas mundësive të secilit nga 1, 2, 3 apo me shumë persona për të darkuar e për të fjetur në familjet gjirokastrite. Si të gjithë edhe ne, në familjen tonë mernim nga këta folkloristë. Ishte si turp po të mos të merrje, pasi të gjithë merrnin, vetëm n.q.s. nuk të jepnin, sepse i kishin shpërndarë dhe e quaje si fyerje që, nuk të begenisnin, ndërsa ata që merrnin nga këta folkloristë, e quanin si nder, respekt. Para


TEUTA KARANXHA (GANXO)

dhe pas këtyre festivaleve të përvitëshme, grupet e këngëtarëve e të valltarëve, me veshjet e tyre nga më të ndryshmet, me xhubleta apo fustanella, me brekushe e me qeleshe, sipas krahinave të Veriut, Jugut e të Shqipërisë së mesme, këto grupe mbushnin rrugët e sokaket, e për qejfin e tyre e të qytetarëve që i shihnin, merrnin vallen e këndonin, jashtë programit, e rrugët buçisnin nga zërat e tyre melodiozë e toka tundej nga hapat e kërcimet e tyre. Rrugët në ato kohë dukeshin si një qyлим i madh shumëngjyrësh, që ishte shtruar në të gjithë qytetin, i cili valëzonte sipas ritmit të muzikes, nga lëvizjet e duarve e të këmbëve të këtyre kërcimtarëve e valltarëve folkloristë. Kudo kishte hare.

Në ato kohë i harroje ato hallet e problemet familjare që mund të kishe, 1 javë ishe me këngë në gojë e në vesh, pasi që lart nga kalaja edhe n.q.s. ti nuk doje të shkoje të shikoje, apo n.q.s. nuk kishe ku rrije se nuk kishte vende as në këmbë, zëri vinte vetë në të gjithë qytetin, buçiste bashkë me dajret e me lodrat e malësorëve që kërcenin e këndonin. Jo më kot i ka kënduar këngëtarja popullore tiranase, Fitnete Rrexha, Gjirokastrës në ato kohë, në periudhën e festivaleve. Ja disa nga vargjet e këngës së saj: **“Gjirokastra në shpat mali,/ guri shekullor,/ tundet sot nga festivali,/ Gjirokastra jonë./ Bukë e krypë, e zemër të bardhë,/ siç e kemi zakon,/ miq tek ty ne kemi ardhë,/ Gjirokastra jonë./ Hajd t’ja marim bashkë një kënge,/f ort ajo të ushtojë/ ti me iso, ne me dajre,/ kurrë mos të mbarojë”** etj... Po jo vetem Fitnetja, por edhe Petrit Lulo, që është dhe gjirokastrit, i ka kënduar gjithmonë dhe i këndon akoma qytetit të Gjirokastrës, si përshembull, një nga këngët e të cilit, nga ato popullore është ajo që mbaron me vargjet, po the Gjirokaster i ke thënë të tëra. Po ashtu ky këngëtar ka kënduar dhe me këngëtarën vlonjate, Majën, disa këngë.

Shumë e bukur është dhe një këngë tjetër që Petrit Lulo ka kënduar me këtë këngëtare vlonjate, për Gjirokastrën. Gjirokastrës i ka kënduar edhe një këngëtare tjetër nga Vlora, në mos gabo, Poni. Po citoj disa vargje te saj: **“Kush të thote se je e ashpër, kush të thotë se je e ftohtë, unë ty moj Gjirokastër, me asnjë nuk të ndroj”**. Kur unë kujtoj atë, Gjirokastrën time, më mbushet mushkëria me ajër, më gufon zemra, e ndonjëherë dhe lotoj, e për më tepër kur bie fjala e bisedoj për të, por më tepër kur shkoj aty, gjë që e bej shpesh, e kur jam në të afruar, sa shikoj konturet e kalasë e majat e maleve së largu kur fillojnë e duken, bëhem me krahë.

Ky është qyteti im i lindjes, ku unë u linda dhe u rrita, nga një familje e thjeshtë qytetare, nga dy prindër që më lindën e më rriten me dashuri, si mua dhe vëllezërit e motrat e mia. Unë u linda në lagjen Manalat të këtij qyteti, në muajin Maj 1954. Ne atëhere jetonim në shtëpinë e gjyshërve nga babai, ne lagjen Manalat i dytë. Babai im kishte dhe një vëlla të vogël, Mustafanë që ishte 3 vjeç kur u martua mamaja ime me babanë, dhe kur linda unë ai ishte 4 vjeç, si dhe kishte dhe 6 motra. Kështu ndodhte atëherë, gratë, vjehra shumica kishin edhe nga një të vogël, ishte koha që bëheshin shumë fëmijë por dhe ishte dhe dashuria më e madhe, edhe fryma, ndjenja e kolektivitetit, e familjeve të mëdha. Gjyshi im, Shaqoja, ndjesë pastë, ishte shumë punëtor, punonte shumë në bujqësi, ai ka emigruar dhe në Turqi, atëherë ishte dhe i fejuar me gjyshen time, siç e kam dëgjuar historinë nga babai im, dhe u kthye, pasi do martohej dhe sepse gjyshja ime ishte vajzë e vetme dhe jetonte me nënën e saj. Ai, pra gjyshi im, Shaqoja, ishte një burrë i gjatë, i pashëm, autoritar, shikonte punën e tij, nuk ngacmonte njeri, por ama kur i binin në qafë, me sa kam dëgjuar, që më kanë treguar, ua tregonte qejfin atyre ngacmuesve, duke ju treguar vendin. Kurse gjyshi tjetër nga mamaja ishte shumë i urtë, nuk trembte as macet, që thotë populli,



TEUTA KARANXHA (GANXO)

ai, ndjesë të kenë, ishte këpucar, ndreqte këpucë, ishte ca i avashët, por me zanatin e tij mbante shtëpinë. Ndërsa gjyshja nga mamaja, Inajeti, ishte si kapedane, e fortë, autoritare, e shkathët, aq sa ua kalonte dhe burrave, ajo, ndjesë pastë, ishte në tip krejt e kundërt me gjyshin tim, Nekiun. Kjo, pra, Inajeti, ka qenë në punë të shtetit, gjithë kohën, ndërsa gjyshja tjetër nga babai, Qerimeja, ndjese pastë, nuk ka punuar, ka qenë shtëpiake, pasi kishte dhe shumë fëmijë, por ajo, ndihmonte bashkëshortin e saj, gjyshin tim, Shaqon, në punët e bujqësisë së bashku me hallat e mia më të mëdha, të cilat ndihmonin në punët e bujqësisë në fushë.

Kur linda unë, që isha fëmija i parë, prindërit e mi nuk e patën problem që linda vajzë, përkundrazi më deshën shumë, e më pritën me dashuri, po ashtu dhe gjyshërit, si nga nëna dhe nga babai. Unë kisha 6 halla, motra të babait, tani jetojnë vetëm 2, hallë Fazua, dhe hallë Bardha, ose Bala si e thërrasim. Hallat e tjera vdiqën afër e afër, ndjesë paçin. Tani kam edhe xhaxhanë tim, Mustafanë, që e kam si një vëlla të madh, sepse, siç theksova më sipër, kemi 4 vjet diferencë. Kemi qenë shumë të lidhur bashkë e sidomos kur unë jetoja në Gjirokastrë, ishim si motër e vëlla edhe si shokë. Dilnim bashkë shpesh, bënim xhiro tek sheshi i Çerçizit, se aty behej xhirua, deri tek rruga poshtë, shkonim dhe në kinemanë e qytetit, herë pas here, pastaj edhe në shtëpitë e njëri-tjetrit, venim ne, vinte ai dhe gjyshja, nanaja si i thoshim ne. Babai im, Elmazi, ndjesë pastë, e donte shumë xhaxhanë tim, vëllanë e tij, kur vinte e bisedonin, ai e shihte atë në dritë të syrit, dhe e ndiqte me sy e veshë. Xhaxhai im ishte dhe orator, kishte një të folur të pasur, elokuencë, dhe dinte shumë gjëra, ishte i formuar mirë, veç kësaj ishte dhe me arsim të lartë, ekonomist. Bëhet fjalë për vitet 1974, 1975, kur babai im jetonte akoma. Babai im ndërroi jetë në 17 maj të vitit 1976. Për familjen time pas kësaj u krijua një gjëndje e vështirë si psikologjike dhe

ekonomike. Marëdhënien me xhaxhanë, ne si familje e kemi akoma, por largësia me mua, duke jetuar ne Elbasan, ka bërë që të flasim nëpër telefona e të meremi vesh në këtë mënyrë, sepse jeta në distancë të largon disi, por kur shkoj tek nëna ime në Gjirokastrë, që falë Zotit më jeton, takohem me xhaxhanë dhe herë herë, sipas mundësisë, varet se sa rri unë tek nëna, sepse ata janë në lagje të ndryshme, kemi pirë edhe ndonjë kafe. Nëna dhe babai, pasi na la prej afër 39 vjet më parë, babai, të cilët na lindën nga një martesë me dashuri e tyrja, na rritën me përkushtim edhe pse në një gjendje ekonomike të dobët, për arsye se ne ishim 7 fëmijë dhe me dy rroga të vogla të Postë Telegrafes, ku ata punonin të dy bashkë, njeri telegrafist, babai, dhe tjetra nëpunëse e sportelit si dhe e mandapostës, nëna. Po ne, pasi u larguam nga shtëpia e gjyshërve nga ana e babait, jetonim në një shtëpi të dhuruar më parë nga gjyshërit e mi nga nëna, e cila shumë shpejt u rindërtua, pak me sipër vetes, u bë një ndërtesë 2 katëshe, me 4 dhoma e dy korridore, falë një kredie që mori babai im në bankë atëherë, nga vitet 1968-69, s i dhe falë punës së krahut të prindërve të mi dhe të gjithë njerëzve të afërt, si nga ana e babait dhe nga ana e nënës, pasi ashtu bëheshin ndërtimet atëherë, me kontribute vullnetare nga ana e të afërmve, kur kishte punime, si: hedhje soletash betone, apo ngarkim shkarkime e transporte materialesh.

Shtëpia e jonë u mbarua shpejt, por jo e tëra, pasi kredia mbaroi dhe brenda shtëpisë kishte tavane të pa mbaruara si dhe ca gjëra të tjera, që ne i bëmë me vonë avash-avash, pas vdekjes së babait, po ne u futëm në shtëpinë e re, se disa muaj ndenjëm me qera në një familje afër nesh që kishte shumë dhoma, tek shtëpia e Qemal Gurit, i cili vetë që futur dhëndër tek familja e Hashove që ishin komshinj me ne. Shtëpia e tyre ishte si kështjelle dhe ne jetonim në katin e dytë të saj deri sa u bë shtëpia e jonë. Njerezit tanë të afërm na ofruan strehim, por prindërit e mi nuk pranuan, sepse ne

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ishim një familje e madhe. Kur mbaroi shtëpia, një shtëpi 2 katëshe me ballkon e me goxha avlli, babai jonë ndizte zjarr në oxhak, sepse shtepinë e kishim me oxhak, që të thaheshin muret e njoma të suvatuara atëherë nga ustai i talentuar, xha Sakua, i cili ishte një burrë i urtë, me muhabet të këndshëm, e me duar të arta. Atij i vinte keq për ne se ishim shumë fëmijë dhe vetë vinte nga një shtresë e varfër dhe na ndihmonte duke punuar me orare të zgjatura. Vëllai im i madhi pas meje, Avduli, i rinte pranë e i mori zanatin, edhe sot ai bën ndërtime, si: mure, suvaton etj. Atëherë, ai ishte i vogël, 12 a 13 vjeç. Po ne, duke parë prindërit tanë që punonin shumë si kur u ndërtua shtëpia dhe më parë dhe më pas, morëm edukatën e punës dhe atë e kemi dhe sot. Me shumë barra e shtëpisë më ka rënë mua, që isha dhe fëmija i parë, pastaj vëllezërve të mi, e sidomos Avdulit që vinte pas meje, se motrat e tjera ishin më të vogla. Ne jemi në dy a një vit e gjysëm nga njëri-tjetri e kjo ka bërë që ne të ishim dhe shokë e të luanim me njëri-tjetrin, po ne luanim pak, më shumë punonim, sepse të tilla i kishim kushtet familjare, po kur e mendoj sot, them se na ka bere mirë kjo gjë, sepse nuk i kemi marrë gjërat e gatshme nga prindërit, por kemi punuar dhe vetë.

Ne në pushimet e shkollës punonim në ndërmarjen pyjore apo në fermën bujqësore, punë të ndryshme, po edhe në ndërtim kemi punuar. Me lekët që fitonim ne blenim librat e shkollës për vitin shkollor që do fillonte dhe ndonjë veshje. Siç e thashë dhe më sipër prindërit e mi punonin shumë, edhe para se të ndërtohej shtëpia e re dhe më pas, nëna dhe babai im punonin në tokat rreth shtëpisë, koshtat që i quanim ne, apo bahshtetë që i quanin disa të tjerë, duke mbjellë dru frutorë të rinj se disa i gjetëm nga gjyshërit, apo duke punuar e mbjellë tokën me kultura të ndryshme bujqësore, si: domate, patate, bostane, kunguj, qepë, hudhra, specat, zorzavate, të cilat na ndihmonin ekonominë tonë fammijare. Babai im mbolli dhe shumë hardhi rrushi, fidanë

TEUTA KARANXHA (GANXO)

dardhe, kumbulla të ndryshme, fiq, etj., pemë frutore. Në bahçen sipër, afër me familjet e Govacajve, meqë toka ishte e pjerrët dhe pak më e varfër, siç thoshte babai im, e mbillnim me duhan, të cilin, pasi e vilnim i hapnim fletët një e nga një, e pasi i shkonim në vargje me një sakoraf ose një si tip gjilpëre e madhe e trashë me një vrimë të madhe në fund, si e quajnë disa krahina, për të shkuar spangon e trashë që do mbante duhanin e bërë varg, të cilat pastaj këto vargje i thanim duke i varur mbrapa shtëpisë ku nuk kishte shi, pasi ishin sprethet, anët e çatisë, që ato të thaheshin, se nuk duhej të lageshin. Këtë duhan të thate babai im, më pas e grinte e bënte të hollë si kadaif, e një pjesë e pinte vetë, me të dredhur, ndërsa pjesën më të madhe e shiste.

Po dhe nena ime ishte shumë punëtore, edhe pse ka qenë vajze e vetme në familjen e babait të saj, Neki Sokollit, ajo u mësua me punë nga nëna e saj, Inajet Sokolli, dhe punonte pa pushim, si me punët e shtëpisë, ashtu dhe në kopshtet e saj me punë bujqësore. Në kohën kur shtëpia e re po ndërtohej, prindërit e mi morën një gomar për ta përdorur për transport, por ky gomari ishte i egër, i sertë, kur mbaronte punë babai im e lidhte tek një kumbull që kishim aty afër shtëpisë së re, që po ndërtohej. Një ditë mamaja ime u afrova tek ai, pra tek kjo kafshë, me qëllim për të kaluar aty për të shkuar për punët e veta të tjera që kish, po ajo, kaloi shumë afër gomarit, sa që ky e tërhoqi me dhëmbë nga barku, duke e kafshuar. Nëna ime bërtiti shumë fort, unë e dëgjova e shpejt iu afrova. Babai për momentin nuk qe aty. Unë e tërhoqa nënën nga dhëmbët e gomarit, e nuk dija se ç'të bëja. Me vrap mora një leckë të pastër, e laga me raki, e po i pastroja gjakun e po e dizifektoja, pasi kjo qe ajo që më erdhi në mend që duhej ta bëja shpejt. Pastaj shpejt vrapova për te infermjerja e lagjes, që ishte Drita Asqeri, ndjese pastë, po ajo nuk qe në ambulancën e lagjes që ne e kishim afër, por qe në orar dreke, ishte në shtëpinë e saj, në lagjen Cfakë. I shkova në shtëpi, ajo erdhi me vrap dhe e mjekoi, por nena ime

TEUTA KARANXHA (GANXO)

më pas shkoi në spital dhe bëri gjilpëra kundër ndonjë infeksioni a tërbimi. Kur erdhi babai im dhe e mori vesh, u çudit edhe pse e dinte që ai gomar që i sertë, e mori gomarin i cili nuk që i yni, por ia kishte marrë motrës së vet të madhe për punë, e rrahu gomarin shumë, e nuk e mbajti më atë gomar, edhe pse punet e ndërtimit të shtëpisë nuk kishin mbaruar.

Kështu me punë e sakrifica kanë punuar prindërit e mi dhe ne më të mëdhenjtë e fëmijve të tyre, si në ndërtimin e shtëpisë dhe më vonë. Unë si më e madhja, bashkë me vëllezërit pas meje i shkonim nga pas prindërve e i ndihmonim. Mbaj mend në koshtin pas shtëpisë babai im bëri një gropë të madhe për ta mbushur me ujë për të vaditur bashtetë në verë, që mbilleshin me kultura të ndryshme. Koshti i parë pas shtëpisë mbillej me domate, specia apo piperka, si i thonë gjirokastritët nga greqishtja, si dhe me bostane e sallatorë ose kastraveca, në koshtin e dytë, vinim qepë, hudhra, si dhe presh ndonjëherë, ndërsa në të tretin lart, vinim patate dhe duhan se ishte shumë i madh. Ngjitur tek gardhi i shtëpisë tonë herë pas here dilte një burrë plak që quhej Hiqmet Shehu, ishte shumë punëtor, bujk i mirë dhe dilte e shikonte se çfarë bënim ne dhe shumë herë na ka ndihmuar, na jepte mendime për bujqësinë se dinte shumë nga bujqësia, e ndihmonte babanë tim dhe ne fëmijëve më pas kur na vdiq babai, si e thashë dhe më sipër, në moshen 46 vjeçare duke na lënë neve, kokë kokë, të pa rregulluar, me nënën tonë të re 41 vjeçe e me shumë halle. Unë isha 22 vjeç, sa i kisha mbushur, kasha 15 ditë, se në datën 17 maj na vdiq babai, nga një peritonit, në spitalin e Fierit, pas një operacioni ditën e tretë, pas operacionit. U kapëm fort pas nënës tonë dhe me ndihmën edhe të të afërmve tonë e kaluam dhimbjen, por kishim shumë nevoja ekonomike që duhej t'i kalonim vetë. Vetëm unë sa kisha filluar punë në Uzinën Metalike, Gjirokastër, në repartin e galvanizimit. Aty me vendosën pasi mbarova shkollën e mesme Teknologjike në Tiranë për laborante, por

TEUTA KARANXIIA (GANXO)

Komiteti i Rrethit që quhej atëherë aty më caktoi, në atë repart ku kishte helme, si; avuj të kromit apo anhidrite, si: avuj të cianurit, pasi aty bëheshin galvanizimet e prodhimeve, që prodhoheshin aty. Ne na jepej qumësht si antidot për ta pirë çdo ditë. Paga ishte e mirë sipas kategorisë, kualifikimit që kishte secili. Aty punova afër 7 vjet dhe shoqet i kisha të mira, si Doloren, Kumen, Valin, Leonorën, Trëndafilë Gjoksin e Siri Llockon, si dhe inxhinerin kimist Filipin, pastaj me kaluan në zyrat lart, si në atë financë e më vonë në plan, pasi vazhdoja e më vonë mbarova shkollën e lartë ekonomike, dega financë pa shkëputje nga puna në Tiranë.

Pasi mbarova studimet e larta më vjen emërimi nga Komiteti i Rrethit Gjirokastër për në Ndërmarrjen e Grumbullimit, ku punova 1 vit, e më pas u largova në qytetin e Elbasanit ku dhe u rimartova, për së dyti pas një fatkeqesie që mua më ndodhi me vdekjen e bashkëshortit tim të parë, në Gjirokastër, e cila ngjarje kjo më goditi në moshë shumë të re, si dhe pa e gëzuar martesën time të parë, pa u mësuar akoma dot, duke u bërë kjo ngjarje, me kalimin e viteve, sikur kisha parë një ëndërr të keqe, dhe në mëngjes isha zgjuar, tani mbas kaq shumë viteve që e kujtoj. Por, koha, jeta, vazhdimësia e saj është ilaç që të mjekon plaget, melhem që bën që ato të zenë kore, me qëllim që të vazhdosh përpara, kjo është dhe dora e zotit, që me raste të tilla ndihmon që të largosh kujtimet e këqija të hidhura, duke u përzier me kujtime të tjera më të mira. Kështu është jeta.

Në Gjirokastër, unë kam qenë e aktivizuar në pushtetin e lagjeve, këshillat popullore që quheshin atëhere, isha anëtare, por edhe në këshillin popullor të rrethit kam qenë e zgjedhur, sekretare e këtij këshilli të zgjedhur, jo të emëruar, në kohën kur kryetar i këtij këshilli ka qenë z. Zive Cami, ndjesë pastë, që me sa mbaj mend ka qenë avokat. Në këtë këshill, në mbedhjet e tij, që ishin 1 mujore dhe 3 mujore, kur unë kam qenë në moshë 22-23 vjeç, diskutoheshin e miratoheshin si buxheti i rrethit, si dhe ai i qytetit,

e të tjera gjëra, si: punësimet, bursat e shumë problematika të qytetit. Ndërsa në këshillin popullor të lagjes shkuarja ishte më shpesh, sipas problemeve të lagjes, që ishin nga më të ndryshmet, si zënie të banorëve me njeri-tjetrin, të fqinjëve, por kishte dhe të afërm, si dhe vëllezërit që i kishin këto probleme ne i diskutonim në këshillin e lagjes, e aty caktonim njerëz, si anëtare këshilli që në bashkëpunim me ata të frontit të lagjes, iu shkonim nëpër familjet e tyre, deri sa ata t'i pajtonim me njëri-tjetrin. Në këto mbledhje shpesh na vinin edhe nga kryesia e qytetit, komiteti ekzekutiv i tij, si qe z. Mihal Xuhano atqhere. Nëse shoqet e mia, bënëin jetën e tyre, unë, përveç punës e aktiviteteve të saj, si e kam thënë dhe më lart, qaja hallet e problemet e popullit, të lagjes, bashkë me të tjerët, që ishin të zgjedhur si unë. Xhirot e qejfet e mia kanë qenë shumë të pakta, në krahasim me moshataret e mia. Por nuk jam penduar që i kam bërë, ndjehem mirë, e këtë aktivizim e pjesëmarrje në aktivitete shoqërore, kulturore edhe politike, unë e kam vazhduar edhe kur erdha në Elbasan, ku u integrova si me shoqërine edhe me aktivitetet e partisë socialiste, ku kam kontribuar për 30 vjet në qytetin e Elbasanit, duke qenë si në komisione zgjedhore, dhe në të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar nga ana e Partisë Socialiste në këtë qytet. Edhe sot, unë vazhdoj akoma.

Do të kisha dashur që sikundër dhe në qytetin tim të lindjes, ku unë jetova 30 vite si dhe u aktivizova, edhe në Elbasan, ku unë jetoj aktualisht dhe kam po aq vite, 30 vite sa kam jetuar e punuar në qytetin tim të lindjes, të vazhdoj akoma të punoj dhe të aktivizohem, si në jetën politike, shoqërore, kulturore të qytetit të Elbasanit. Kam dëshirë që sikundër kam qenë e zgjedhur në organet drejtuese të qytetit të Gjirokastrës të jem edhe këtu, por jo funksionare, dhe jo në organet qendrore, por në ato lokale vendore, si është p.sh Bashkia e qytetit tim ku jetoj, të jem një herë të vetme në Këshillin Bashkiak të Elbasanit, pasi kam

TEUTA KARANXHA (GANXO)

punuar, i kam dhënë Partisë Socialiste në Elbasan, e nuk kam marrë asgjë në këmbim për 30 vjet në Elbasan, si mund të kenë bërë shumë të tjerë që kanë punuar për partitë ku kanë aderuar, a po ku kanë qenë aktivistë. Unë kam pasur diplomën e U.R.T. të Tiranës për ekonomiste të lartë dega Financë si e kam thënë dhe më lart, jam ekonomiste, për 35 vjet, e për të qenë në punë nuk kam pasur nevojën e partive, i kam gjetur vetë punët, në të dy ndërmarrjet që kam punuar në Elbasan. Me këtë rast, nuk dua që të them se kërkoj shpërblim për punën time, jo nuk e kam këtë gjë, kuresesi, por e kam më tepër si dëshirë, passion, për të marrë pjesë në këshillin e bashkisë së qytetit, si një intelektuale që jam të jap mendimet e mia, aftësitë e mia, organizuese, drejtuese, gjithpërfshirëse, të cilat i kam patur që 20 vjeç, si kam folur dhe më sipër, e i kam edhe më shumë tani që jam në moshë të pjekur, e kjo gjë më mundësohet vetëm duke qenë e zgjedhur në këtë keshill bashkiak, e propozuar nga ana e partisë time, asaj Socialiste. Do ndihesha e privilegjuar dhe me fat që të isha ca vite si e tillë, pasi une kam potenciale mjaftushëm, si edhe kontribute, për të qenë e tillë. Por kjo gjë nuk është në dorën time, edhe pse unë tani jam 60 vjeç dhe kam kohë që të merrem disi, se jam në pension, kjo mundësi është relative, jo absolute, dhe veç asaj theksoj se duhet të jenë shumë në rradhë nga partitë, njerëz të propozuar, unë asnjëherë nuk kam kërkuar gjë prej partisë që i kam shërbyer, por pse jo këtë here dua që të përfshihem dhe unë një 4 vjeçar, them se për këtë i plotësoj kushtet pak a shumë. E them këtë edhe për faktin se më vonë do të jem e moshuar dhe nuk do ta kem më mundësinë dhe as fuqinë, si dhe forcën intelektuale, si atë të mendimit, veprimit e të përfshirjes në këto probleme. Tani jemi në muajin mars do dhe afër 3 muaj deri në zgjedhjet e ardhëshme vendore, për bashkinë e Elbasanit, ku si kandidat të mundshëm për kryetar bashkie, mund të kemi sërish z. Qazim Sejдини, njeri i nderuar, dhe i respektuar për këtë qytet,

por dhe që ka bërë për Elbasanin, e ka ndryshuar mjaft pamjen e tij. Nuk dua që të më marrin për karrieriste, si dhe për servile, por unë kam dëshirë që të merrem me keto punë, se jam marrë gjithnjë, por me ato të qeverisjes nga ana e pushtetit vendor, si është bashkia Elbasan, nuk kam marrë pjesë ndonjëherë, dua që të jem dhe une në debatet, diskutimet, propozimet që bëhen për mbarëvajtjen e punëve e jetës në qytetin ku jetoj për më se 30 vite. Por, si e theksova dhe pak me sipër, kjo gjë nuk është në dorën time, për të mos thënë që ka dhe prishje radhe, në ndonjë rast. Ndikojnë shumë faktorë, si propozimi nga ana e partisë, ku unë jam angazhuar, formula në këto zgjedhje, d.m.th. raporti, numri si ai ndërmjet të propozuarve, si dhe i atyre që do të fitojnë në bazë të radhës, e ku di se çfarë tjetër. E, tani pa u shkëputur nga thelbi i shkrimit tim, qëllimi i tij, le të flasim për qytetin, tashmë dhe pse jo dhe timin, Elbasanin, ku unë jetoj aktualisht me familjen time, i cili është i vendosur në zemër të Shqipërisë.

Elbasani dhe familja ime

Qyteti ku unë u martova, jetova e jetoj akoma prej më se 30 vitesh, me bashkëshortin tim dhe 3 fëmijët e mi, 2 vajza dhe një djalë, është Elbasani. Pas qytetit të Gjirokastrës, i dyti që unë e dua, është dhe qyteti i Elbasanit, qyteti i kulturës, i dijes, qyteti i këngës së bukur popullore Elbasanase, qyteti i **Isuf Myzyrit**, dhe i shumë patriotëve të shquar arsimdashës e liridashës, si **Kostandin Kristoforidhi**, **Jorgji Dilo**, **Sul Misiri**, **gjuhëtarit të nderuar Mahir Domi**, i cili ka dhe në këtë vit 100 vjetorin e lindjes, etj njerëz të nderuar, si dhe qyteti i nismëtareve e themeluesve të aktit të pavarësisë, të cilët janë shumë, si **Lef Nosi**, **Aqif Pasha** e të tjerë patriotë që u përpoqën me mish e shpirt për të ardhur në këto ditët e sotme ku ne jemi tani. Këta nismëtarë të aktit të pavarësisë, më vonë në 1920, morën pjesë

dhe në një ngjarje shumë të rëndësishme për vendin tonë ahëre, në Kongresin e Lushnjes, kongres ky që mori vendime shumë të rëndësishme, të domosdoshme për vendin. Ky kongres ishte dhe kuvendi i parë i Shqipërisë atëhere, ishte si parlamenti i parë shqiptar, ku njerëz patriotë e të vendosur, morën përsipër fatet e vendit, duke marrë në kongres ato vendime aq të rëndësishme për vendin në atë kohë. Prandaj për këtë duhet t'u jemi mirënjohës e të përulemi me respekt para të gjithë këtyre patrioteve të nderuar, cilët do prej tyre, qofshin këta si patriotë, dijetarë, historianë, politikëbërës apo dhe dëshmorë të luftës Nacional Çlirimtare. Meqenëse jemi tek dëshmorët, për të kaluar prapë në rrëfimin për qytetin e Elbasanit, në varrezat e dëshmorëve të qytetit, si shumë dëshmorë të tjerë, prehet dhe dajua i bashkëshortit tim, Arjanit, Xhemal Senja, i cili u vra në moshë fare të re 17 vjeç apo 18, kaq ishte. Ai ishte nga fshatrat e Belshit, me sa kujtoj nga të treguarit, nga Kajani, prej nga ishte dhe nëna e ndjerë e bashkëshortit tim, Bukurije Senja, motra e dëshmorit, e më vonë kur u martua, ajo, mori mbiemrin e burrit, Karanxha, të cilën më vonë e dërguan prindërit në qytetin e Elbasanit, ku e morën me dëshirën e tyre dhe e rritën qysh nga mosha 9 vjeç e deri sa u martua, një familje e dëgjuar bejlerësh, ajo e Vrionit, të cilët jetuan në Tiranë dhe e martuan nënën e burrit tim, si një vajzë të tyren. Djali i kesaj familjeje, Sadik Vrioni, ka jetuar në Tiranë, ne kemi qenë me bashkëshortin tim nja 2 herë për vizitë tek ata para disa vitesh, e i kemi kujtuar ato kohë. Tani dajë Sadiku, së bashku me bashkëshorten e tij, jetojnë më shumë jashtë, sepse atje i kanë fëmijët. Për këtë arsye, nuk jemi lidhur më e nuk dimë gjë më për ta. Me sa më kanë treguar, më vonë, pas martesës së nënës së burrit tim, familja e saj u shpërngul në qytetin e Elbasanit, ku vazhdoi deri më sot. Kjo ka ndodhur edhe për shkak të luftes së klasave që ishte shumë e fortë atëhere, pasi familja Vrioni, quhej familje borgjeze atëherë, e për këtë, bashkëshorti i nënës së burrit

tim, deshi që të largoheshin nga Tirana ku jetuan për disa kohë edhe të martuar në Tiranë me familjen Vrioni bashkë. Kur lindi bashkëshorti im, kjo familje e nderuar ia vuri emrin, emër shqiptar, Arian, kjo tregon që ata i kishin shumë të respektuara, të shtrenjta, si dashurinë dhe ndjenjat për kombin e tyre, pavarësisht se ç'mendonte partia në pushtet, e cila i luftonte këta njerëz të nderuar, pse ishin me prona të trashëguara nga etërit e tyre e ca dhe nga vetë puna e tyre, si tregtarë e zanatçinj. Elbasani, është qyteti i Normales, që sot mban emrin shkolla e gjuhëve të huaja, shkollë kjo ku kanë studiuar me dhjetra breza mësuesish, shkolla e parë në Elbasan për atë kohë, që prodhonte qindra, e që tashmë që kanë kaluar shumë vite, janë bërë një armatë e tërë, me mijëra quadro mësuesish të respektuar, që janë shpërndarë në mbarë vendin, duke përhapur dijet e tyre në qindra e mijra nxënës.

Elbasani, qyteti, që emri i tij është i lashtë, shumë i hershëm, u bë qyteti i vazhdimit të jetës sime. Unë kur erdha në këtë qytet isha 30 vjeç, tani jam 60 e pak, eci për 61. Ky qytet, është i dyti që unë dua. Ashtu si përmendet dhe nga historianët, si dhe në shkrime të shumë shkrimtareve, emri Elbasan ka disa perkthime, por, thuhet, se midis të tjerave, në kohën e sundimit Otoman, njeri prej sulltaneve që ka ardhur në Elbasan, e që ka bërë edhe ndërtime, si: rrugë, etj., e ka quajtur me këtë emër, Elbasan, që do të thotë “me vu dorë”, ose “vura dorë”. Me sa kam dëgjuar, nëpër Elbasan, ka kaluar rruga shumë e hershme, rruga Egnatia, e cila ka qenë aq e hershme, sa nëpërmjet të cilës ecnin karvanet nëpër botë për të bërë tregti, me anën e kuajve, pasi atëherë nuk kishte makina. Por, **për Elbasanin, Gjirokastrën etj qytete të Shqipërisë ka folur me shume dashuri një diplomat i shquar francez, Zhustin Gudart, i cili i ka vizituar qytetet e Shqipërisë nga veriu në jug, dhe disa kohë qëndroi këtu në vendin tonë dhe ka riardhur disa herë në Shqipëri. Ai bën një**

përshkrim për vendin tonë nga vitet 1920 deri në vitet '50 dhe flet me përshtypjet e tij për vendin tonë, si: për natyrën dhe për njerëzit, të cilët i përshkruan si njereëz shumë mikpritës, punëtorë, te ndershëm e liridashës. Ai flet për vendin tonë, për poziten e tij të vështirë, për ndarjen e padrejtë territoriale të Shqipërisë në 1913, për përpjekjet e grekëve, jugosllavëve, etj., për të marrë nga Shqipëria akoma dhe ndonjë copë veç atyre që morën. Ai flet për kontributin e përpjekjet e Austro-Hungarisë e të Francës për ta ndihmuar Shqipërinë në vitet 1920, '30, '40, e deri në luftën Nacionalçlirimtare, si dhe me ndihmën e aleateve angleze. Diplomati francez përmend edhe përpjekjet e tij individuale tek konsulli i vendeve si Austro-Hungaria e Franca, si dhe Anglia, të cilëve u kërkonte që të negocionin tek vendet e tjera si Gjermania, Italia, Anglia etj., vende të fuqishme, për ta futur Shqipërinë në Lidhjen e Kombeve, me qëllim për ta mbrojtur nga synimet territoriale të mëtejshme të tyre për ta gllabëruar Shqipërinë e për ta ndarë në copa të tjera midis Greqisë, Jugosllavisë, Malit të Zi e ndonjë vendi tjetër që ka shfaqur oreks për territore, përveç ndarjes së 1913, ku në traktatin famëkeq të Londrës, u coptua vendi ynë, duke iu aneksuar shumë territore tonat, vendeve fqinje me ne, në mënyrë të padrejtë. Jo më kot populli ynë, i ka ngritur këngë, duke e treguar me vargje e me këngën popullore të Jugut të vendit tonë dhimbjen për këtë ndarje territoriale, këtë coptim të padrejtë nga ana e Fuqive të Mëdha. Ja cilat janë vargjet e këngës: “Abdyl prishe pasurinë, një barrë flori, shkove te Bismargu vetë dhe u ule në skami, mos e ndani Shqipërine sikur ska njeri, unë vij nga Shqipëria, jam Abdyl Frashëri”. Ky diplomat, pra Zhustin Gudart, ka përmendur edhe Ahmet Zogun në veprën e tij. Ai e përmend këtë të fundit, si nga një familje me një ekonomi jo të mirë; nga krahinat e rrethit të Matit mos gaboj, si një

djalë të ri me ambicje për t'u vënë në krye të lëvizjeve patriotike që atëherë, që kur qe në moshë shumë të re, duke ndihmuar lëvizjen për pavarësi, por e paraqet më vonë si një monark, i cili për t'u bërë një drejtues shteti përdori çdo mundësi dhe që ne fillimet e rinisë së tij, kur ishte në vendlindjen e tij, shiti tokat e prindërve për të bërë para se ishin dobët nga ekonomia, duke qenë dhe një familje tejet e madhe. Ai, pra Xhustin Gudart, diplomati francez, që i ka dhënë një ndihmë të madhe vendit tone, duke bërë bisedime me personalitete të larta e diplomate të vendeve të fuqishme, si theksova me sipër, për të ndërmjetësuar për të mirën e vendit tonë, për fatin e tij, ky diplomat nuk flet me shumë mirësi për Ahmet Zogun, por më tepër le të kuptohet se ka rezerva për të në drejtim të mënyrës, rrugës, se si erdhi në pushtet, e si ai i ngjiti shkallët, dhe për më tepër, kur u largua dhe e la vendin të pa mbrojtur, të pa armatosur, në ditet e pushtimit nga Italia. Por megjithë rrëfimet e këtij diplomati, nga historia e vendit tonë dimë se Ahmet Zogu, ka kontribut në formimin e shtetit, dhe para tij duke u angazhuar qysh më herët në lëvizjet për pavarësi, duke iu bashkuar kësaj të fundit si delegat i krahinës së tij për në Vlorë, për të shpallur pavarësinë, edhe pse ishte shumë i ri, 17 vjeçar, dhe që për shkak të peripecive të rrugës arriti me vonesë në Vlorë dhe nuk e arriti momentin e formulimit të aktit të pavarësisë dhe të firmosjes nga 40 delegatët, firmëtarët, që erdhën nga të gjitha viset e Shqipërisë. Përpos të metave e gabimeve, për të cilat kanë folur të tjerë njerëz me influencë politike apo historianë, për mua dhe për shumë të tjere, ai, pra, Ahmet Zogu, bëri shtet, pavarësisht se qe monark, ai atë mënyrë, ate model shteti zgjodhi, sepse atë kopjoi nga të tjerë më parë që kanë pasur modelin e shtetit të tyre, shtete shumë para nesh me histori e me fuqi e zhvillim e influencë shumë më të

madhe, e të konsoliduar, nga ku A. Zogu mori më të mirën që iu duk atij. Mund që të kishte zgjedhur dhe një republikë parlamentare e jo monarki, por kjo iu duk më e përshtatshme për vendin tonë, kështu mendoj une nga sa kam lexuar, si dhe besoj se edhe kështu do t'i jetë sugjeruar edhe nga elemente të tjerë me eksperiencë në fushën e diplomacisë së shteteve, e mbase ky model i përshtatej më mirë vendit tonë në ato kushte. Prandaj, si është dhe shprehja, ti japim Çezarit atë që meriton. Sa për mua nuk kam as statusin dhe as të drejtë ta gjykoj A. Zogun. Për atë dhe për të tjerë pas e para tij flet vetë historia e shkruar dhe e lexuar. Në veçanti regjimin e Ahmet Zogun dhe vetë Ahmet Zogun nuk e deshën dhe shumë patriotë të tjerë e shkrimtarë të dëgjuar të vendit tonë, si: Fan Noli, etj., i cili në shkrimet e tij, e dënonte këtë regjim totalitar, ai ishte një shkrimtar, një patriot demokrat i vendit, dhe donte një demokraci të mirëfilltë për qeverisjen e vendit, por Ahmet Zogu, me mënyrat e tij, e rrëzoi qeverinë e Fan Nolit, atë qeverinë e parë demokratike në vendin tonë, e cila qëndroi për vetem 6 muaj dhe si pasojë, Fan Noli i dëshperuar, u largua në emigrim, ku qe andej vazhdonte shkrimet e tij, për t'i treguar popullit shqiptar rrugën e vërtetë të luftës e të punës, duke vazhduar tashmë një luftë e përpjekje për popullin e tij, me anë të penës së tij, për t'ju hapur sytë.

Por, përveç diplomatit francez që kam përmendur më sipër, vendin tonë e kanë vizituar dhe të tjerë njerëz me emër, me famë, me kontribute të medha në punën e tyre, i tillë ka qenë dhe lord Bajroni, i cili, në vizitën e tij që ka bërë në vendin tonë në vitin 1809, e përshkruan atë me një mënyrë të kënaqur e të veçantë, si për nga natyra dhe nga ana e njerëzve të tij, duke i vlerësuar si të pritshëm, bujare, e sidomos me një karakter të fortë e virtyte të mira. Kështu ky personalitet, ka folur veçanërisht në vizitën e tij që ka bërë, në Tepelenë, kur duke përshkruar në rrugëtimin e tij

nëpër Shqipëri, ndaloi dhe në qytetin e Ali Pashait, për të cilin kishte dëgjuar shumë heroizma e trimëri, e kështu ai e vizitoi dhe bujti në këtë qytet, në kështjellën e Ali Pashë Tepelenës, duke e njohur atë më nga afër, e duke folur për të, e për vendin tonë, për të cilat, i nisi një letër nënës së tij, që kur ishte akoma pa u larguar nga vendi ynë, duke i përshkruar e treguar asaj, nënës së tij për ato që kishte parë e jetuar vetë në Shqipëri. E, tani për te mos u larguar nga ajo që dua të them, në lidhje me vazhdimësinë e rrëfimit tim për rrugën që mori jeta ime, duke ardhur në qytetin e bukur të Elbasanit.

Isha e re akoma kur erdha në Elbasan, isha nuse e re, një vajzë, një grua e pjekur 30 vjeçare, me pjekuri të moshës, me formim të përgjithshëm e të lartë profesional. Une lashë qytetin tim të lindjes që më përkundi foshnje, që më rriti e më bëri një grua të formuar e të plotësuar, me të gjitha eksperiencat e mundshme, për t'u përplasur me të gjitha dallgët e jetës, e për ta vazhduar më tej jetën në Elbasan. Në fillim e pata të vështirë që të levizja, por edhe pse nuk qe një martesë me dashuri, prapë unë e desha burrin tim, që në prezantimin e parë, më pëlqeu, e më vonë, avash avash, e ushqeva vetë dashurinë me pjekurinë e moshës time, e iu përkushtova familjes time të re edhe pse ishte një familje e madhe, pasi ishin dhe prindërit e ndjerë të bashkeshortit tim si dhe motrat e tij, Firdesi dhe motra tjetër me e vogël, Rajmonda, ndjesë pastë se ka ndërruar jetë e re, para 2 vitesh. Por kjo e fundit, kishte shtëpinë e saj qe e martuar, me burrë, e me tre fëmijë, djem në shtëpinë e saj, por që tek ne vinin përditë, fëmijët e tyre tek ne u rriten, i mbajti të tre nëna e burrit tim, që qe dhe e sëmure, me një veshkë e shkreta, ndjesë pastë, në shtëpinë ku rrinim të gjithë bashkë. Kështu ishte atëherë, jetohej në bashkësi, sepse ishte edhe mentaliteti i kohës, por edhe sikur të doje të ishe nismëtare e ta thyeje këtë tabu, nuk kishte shtëpi, as me qera e as ta blije. Kapacitetet e ndërtimeve atëherë ishin te vogla, por edhe

TEUTA KARANXHA (GANXO)

sikur të ishin më të mëdha mundësitë e blerjes nuk ishin, se ne ishim të rinj dhe s'kishim mundësi ekonomike, e jo për ne, po as dhe për shumë më të mëdhenj se ne në moshë, që kishin vite pune më shumë, e para më shumë. Atëherë, shtëpitë më shumë ndërtoheshin me leje nga shteti e me kredi në truallin e tyre, të njerëzve, pallate ndërtoheshin shumë pak. U sistemova në punë disa muaj pasi u martova, në ndermarrjen Ruga Ura si ekonomiste e lartë, llogaritare e parë. Drejtor në atë kohë ishte F. Qyrciu, ndjesë pastë, njeri i rregullt, i kulturuar, dhe shefe finance kisha N. Cekën. Ishim një kolektiv i mirë shkonim edhe me punëtorët edhe me administratën ku unë bëja pjesë. Vitet e punës, rregullsinë, harmoninë që kemi pasur me njëri-tjetrin në këtë ndërmarrje ta mbaj mend, ishte e veçantë, kishe qejf të shkoje në punë. Edhe drejtuesit e ndërmarrjes i kishim njerëz të rregullt, serioze e të njerëzishëm. Aty punova 10 vite, e më pas nga një reformë, kur ishte drejtor z. Dh. Dule u shkurtova nga kjo ndërmarrje edhe pse nuk e mora vesh sepse me hoqën vetëm mua dhe një inxhinjer, N. Milorin, edhe ai, ishte i ardhur nga Korça, si unë e ardhur nga Gjirokastra, vetem ne të dy u hoqëm nga administrata, në mos gaboj, sepse nuk pyeta se kush u hoq nga puna nga punëtorët. Unë për më tepër, isha jashtë shtetit, në Greqi, për një vizitë mjekësore e për të bërë disa analiza, pasi vuaja nga infeksioni në veshka, e me një epikrizë nga mjekët e këtushëm, ika në Greqi me një vizë nga konsullata greke që ishte në Gjirokastër. Vizat atëherë sa kishin filluar, sepse sa që hapur konsullata, Greke në Gjirokastër, po une kisha vendlindjen Gjirokastër e kjo më favorizoi.

Largimin nga puna, padrejtësinë, unë, nuk e kërkova sepse kur erdha nga Greqia, çdo gjë kishte marrë fund, emri im ishte afishuar tek xhami i derës jashtë, e kështu e quajta të kotë që ta kërkoja të drejtën, por gjithsesi mendoj se, mua, më është bërë një padrejtësi, por përderisa nuk e kërkova, nuk mund t'i fajësoj

TEUTA KARANXHA (GANXO)

dhe aq shumë drejtuesit e atëhershëm, pasi kur nuk je vetë e pranishme, edhe pse është shkelje që të hiqesh nga puna pa u njoftuar, por edhe n.q.s. hesht e nuk e kërkon të drejten tënde, gabimi i atyre që të kanë bërë padrejtësi, zbutet paksa, pasi ndoshta, po të isha ankuar, do të isha rregulluar prapë në atë ndërrmarje, kështu e mendoj unë, pasi, muà nuk m'u suprimua vendi i punës. Por përpos kësaj që më ndodhi me të padrejtë në Ndërrmarjen Rruga Ura, unë me të gjithë kolektivin e atjeshëm, si administratën dhe punëtorët, kemi kaluar shumë mirë, po ashtu dhe me drejtuesit e ndërrmarjës. Atëherë, ishte edhe një kohë paksa më ndryshe, kishte frymë kolektiviteti, e një marrëdhënie shoqërore më të mirë, nuk kishte shumë interesa e babëzi për para si tani, duke prishur raportet ndërmjet njeriut dhe lekut, që në keto kohë është bërë, një raport shumë i ashpër, jo sa duhet i rregullt, pa një normalitet, duke nxjerrë më lart paranë se sa njeriun, në këtë raport, në këtë marrëdhënie individ-para. Kjo gjendje sapo vjen e bëhet me keq, sidomos tek ata persona që kane biznese të fuqishme, ose tek pushtetarët, tek të cilët, nga teprica e parave që fitojnë, po u ngushtohet zemra, po bëhen më të ngurtë e më të ashpër dhe nga ana shpirtërore, pasi është paraja e madhe që i tjetërson njerëzit. Do të ishte shumë e mirë dhe do i bënte mirë dhe për veten e tyre, kësaj kategorie njerëzish, të cilëve iu ka rënë për hise, pra për pjesë e thënë shqip, që, të realizojnë kaq shumë para, që të bënin herë pas here ndonjë dhurim, ose ndonjë ndihmë për të vobegtit, si psh, shtresat në nevojë, si dhe fëmijë të braktisur, invalide, etj.. të cilët janë jo të pakët si në Elbasan, ku unë jetoj, po dhe në të gjithë vendin, ku ka njerëz në nevojë. Duke bërë këtë gjë, pra duke ndihmuar të tjerët, kjo kategori, pra kjo shtresë e pasur, do të ndihet më mirë, mendoj, dhe nga ana shpirtërore, pasi do tju zbutet si zemra, shpirti, do jenë më të ndjeshëm, me miqësore, si në familjen e tyre por dhe në raporte me të tjerë.

TEUTA KARANXHA (GANXO)

Në kohën kur erdha në Elbasan dhe u sistemova në ndërrmarjen Rruga Ura, merresha herë pas here me ndonjë shkrim, si në gazetën Shkumbini që quhej atëhere gazeta, që sot quhet Elbasani, por shkruaja dhe në revistën Hosteni që quhej atëherë, për shkak të satirës, humorit. Mbaj mend kam shkruar një vjershë të quajtur “Servili”, më duket. Në qytetin e Elbasanit atëherë ishte kryeredaktor Mefail Pupuleku, njeri shumë i mirë, që mua si një të re si nga moshë dhe nga shkrimet, me afronte, e me stimulonte. Para shumë vitesh, afër 30 vjetësh, me personelin e kësaj gazete, si dhe vetë Mefaili, e disa të ftuar, kemi qenë në Gjinar, për të festuar përvjetorin e kësaj gazetes Shkumbini. Z. Mefail më kërkoi atëherë që të bëja dhe një shkrim për luftën që duhej të benim kundër bestytive fetare, si p.sh. kundër vajtjes së njerëzve, qytetarë e fshatarë të Elbasanit, në kodrën e Krastës ku ishin vendet e mira. Unë nuk ia mora përsipër duke i thënë se isha e re, pa shumë eksperiencë, por të them të drejtën edhe mundesha ta bëja, po nuk desha ta bëja, kështu më thoshte mua një zë i brendshëm, sepse edhe pse koha, regjimi, diktatura, na kishin bërë ateistë, përsëri, unë besoja në një fuqi të mbinatyrshme. Kur isha vajzë e vogël dhe më vonë kur u rrita, ne së bashku me mamën time dhe me gjyshen, shkonim në vende të mira, në dylbe, si i themi ne andej nga jugu, ose ne tyrbe si i thonë më duket këndeje, ose në teqe. Ne jemi bektashianë, muslimanë, dhe prandaj shkonim atje. Duke dale nga rrëfimi për Rruga Urën, ku punova 10 vite, si e theksova dhe më sipër, unë isha në Greqi, në kohën kur kjo ndërrmarje bëri reformë, si të thuash, pas kësaj, pasi erdha nga Greqia, pas vizitës mjekësore, prej një jave, u ktheva në familjen time, në qytetin e Elbasanit, ku vazhdova të merresha me mirërritjen e fëmijeve, pra për 6 vite u ktheva në një grua shtëpiake, kjo për mua ishte ca e vështirë, sepse unë isha një grua energjike e nuk rrija dot duke u marrë vetëm me shtëpinë e me fëmijët. Pasi vajza e vogël më u bë 8 vjeç, unë fillova që të

TEUTA KARANXHA (GANXO)

kërkoj sërish që të punësohem, isha akoma e re 45 vjeç, e nuk mund ta mbyllja jetën time si një shtëpiake rëndom, veç asaj kishim nevoja ekonomike, po veç këtyre, unë isha e arsimuar dhe me një degë të tillë, si ekonomiste, që kërkohej shumë. Atëherë nuk i kisha më dhe prindërit e bashkëshortit, kishin ndëruar jetë, edhe femijet e mi ishin rritur disi, e unë i kisha tamam kushtet për të punuar sërish.

Keshtu rifillova punë në Ndërmarrjen e Albtelekomit Shqiptar në Elbasan, në degën e financës, si llogaritare e parë. Drejtor ishte J. Biçiku, e në financë shefe llogarie ishte Sh. Hamiti, me të cilën unë kisha thjesht raporte pune, jo tjetër. Kishin kaluar disa vjet pushime në shtëpi, e unë kisha ngecur me ato njohuritë e ekonomisë të socializmit, me ligjet e saj. Po ato tashmë kishin ikur, kishte filluar ekonomia e tregut, e si e tille edhe praktika e punës kishte ndryshuar. Kur isha në universitet, kisha marrë njohuri për ekonominë e tregut të kapitalizmit, për ligjet e saj, por shumë pak, ato atëherë prekeshin, pak si për të bërë dallimin, ndryshimin me ekonominë e socializmit, qe ishte deri në vitet '89 e '90. Por tani ishte krejt ndryshe. Ekonomia e tregut kishte filluar, edhe ligje te tjera ishin, krejt ndryshe nga më pare, e keshtu edhe plani kontabël e mbajtja e llogarive kishte ndryshar. Kisha shumë për të bërë. E para, që kisha bërë një pushim të gjatë, në punën time, në profesionin tim, ne ushtrimin e tij prej disa vitesh, po veç kësaj nuk merrja vesh nga ekonomia e tregut, se ndërkohë që unë rrija në shtëpi e rrisja femijë e bëja punët e shtëpisë, jashte mureve të shtëpisë time koha kishte ikur, kishin ndodhur shumë ndryshime, kishte ndryshuar shoqëria, ekonomia, igjet e rregullat e saj, praktikat si dhe edhe ato të punës, dokumantacioni i saj. I fola vetes time se më duhej shumë punë, e iu përvesha vetë asaj, duke hapur dokumentet tek puna ime duke punuar e mësuar njëkohesisht ato që nuk i kisha parë e degjuar, ndryshimet e kohës në ekonominë e tregut në vendin tonë, në

TEUTA KARANXHA (GANXO)

sektorin e punës sime. Kisha dëgjuar atë thënien e popullit, që zanatin po e le, të le dhe ai, por, unë, me guxim e me shumë punë iu riktheva prapë profesionit tim të ekonomistit.

Me kalimin e pak muajve falë vullnetit tim dhe ndihmës së shoqeve të mia, ato të zyrës atëherë, të dy Shpresave, se kështu quheshin të dyja njëlloj, arrita të kap kohën e humbur, u azhornova dhe arrita aty ku duhej të isha. Kur fillova punë në Ndërrmarjen Telekom, m'u duk sikur fillova punë për herë të parë në jetë, se ishte Ndërrmarje e re, shoqëri e re, si dhe kohë tjetër, tanimë ishim në demokraci. Edhe pse isha tip i shoqërushem, si dhe jo e ndrojtur, me duhesh një mbështetje, e si e thashë më lart m'u dha, si nga ana profesionale dhe ajo shoqërore. Por jo të gjithë të afronin. Në zyrën ku u caktova të punoj, si fillim më mbështetën disi, ndërsa për shoqëri, për të patur diçka më tepër se marrëdhënia e punës ishte më e vështirë. Më bëri përshtypje në grupin e punëtoreve, të atyre që punonin në sektorin me popull, si telegrafistet, centralistet, etj., ishin më të afrueshme. Nuk mund të harroj afrinë që më treguan disa shoqe të kësaj kategorie, si Adelina, Mimoza Canga, por dhe të tjera si Moza Zikaj, Lumja, Elsa, të dy Dianat, Liljana etj., tek Permutatori, ose makineria, ku ishin dhe shoqe të tjera, si Miranda, Kristina, Emanuela por dhe nga zyrat, Marjana, e më vonë Merita, që erdhi 1 vit më pas, e plot gra dhe burra të tjerë që të ofronin një shoqëri më të afërt, një lloj marrëdhënie më shumë se ajo e punës rutinë vetëm. Po ecja mirë në punë, punonim, kishim rezultate e tregues të mirë në realizim të veprimtarisë së ndërrmaërijes sonë, e për rezultat të saj ne shpërbleheshim çdo tremujor apo 6 mujor me shpërblime mbi pagën. Kështu vazhdoi deri sa u privatizuam nga firma turke, ku për pasoje u prenë si rritja e pagës që bëhej çdo vit, po ashtu dhe shpërblimet u ndalen. Ne punonim po atë punë, biles, tani që ishim privatizuar rinim dhe jashtë orarit për ta mbaruar punën ditore, por pagat nuk na u

ritën për 4 vjet rresht dhe shpërblime nuk morëm më. Po me e keqja ishte se edhe drejtuesit e ndërrmarjes edhe pse qenë shqiptarë, silleshin keq, pa etikë, e me preferencë të veçante politike, për socialiste, ndryshe e ndryshe për demokratë, preferonin punonjesit e krahut të vet politik, e diskriminonin ata të krahut tjetër. Kjo po ndodhte në kohën kur ne kishim drejtorin, i cili kishte zëvendësuar, atë të mëpareshtin, z. B. Bardhi i cili ishte njeri i rregullt e i trajtonte të gjithë njëllë, pavaresisht bindjeve politike. Po kështu po ndodhte tashmë në të gjithë vendin, sepse drejtoret viheshin nga funksionarët e të zgjedhurit e partisë në pushtet, e kështu ndërroheshin në çdo 4 vjet. Po në ndërrmarjen tonë ky diskriminim ishte dhe më i madh më dukej mua. Këtë gjë e shihja jo vetëm tek vetja ime, pse isha e majtë, por edhe tek shoqet e shokët e mi të punës. Drejtuesit tek ne e sidomos pas privatizimit silleshin si kur të ishin padronë, sikur ne, në ndërrmarje, t'i kishim pasur drejtuesit turq, besoj do ishin më të mirë, do komunikonim më mirë. Kështu vazhduan reforma pas reformash, dhe ne nga afër 2500 punonjës që ishim para privatizimit si republikë, u arrit në një numër afër 500 punonjës që mund të jenë sot, e them me rezervë, por në Elbasan disa punonjës, pak kanë mbetur, që në numër mund të jenë s'ë di dhe aq mirë po afër 15 apo 20 persona. Nejse, kjo ska lidhje shumë me sjelljen e drejtuesve, se këto reforma ishin në politiken e programet e drejtorisë qendrore të Albtelecomit, pra të pronarit të ri të tij, atij turk. Problemi im, e i të gjithëve është se firma turke nuk është treguar korrekte me të gjithë ne, pasi ne jemi aksionerë prej mëse 7 vitesh, e nuk kemi marrë asnjë lek nga aktiviteti, realizimi i të ardhurave që ushtrohet për çdo vit. Kjo nuk është e drejtë, edhe pse e kemi kërkuar në çdo mënyrë e formë, në bazë të rregullit, prapë asnjë reagim, as nga firma e as nga shteti ynë që është palë në privatizim. Tani jemi në muajin Dhjetor 2014 e për disa ditë fillon viti tjetër, 2015, e pronaret e rinj të Apbtelecomit

TEUTA KARANXHA (GANXO)

nuk ndihen fare, për këtë ata justifikohen se kanë bërë investime shumë si dhe shpenzime të cilat i kalojnë të ardhurat. Kjo gjë nuk na bind sepse ata kanë punuar, kanë marrë pagat për vete, edhe ndonjë shpërblim për festa, pra nuk kanë falimentuar që të justifikojnë këtë veprim e qëndrim të tyre ndaj nesh pastaj, punonjësit, nuk duan që t'ja dinë për shpenzime, ato i bën ajo ndërrmarje që ka, realizon të ardhura mjaftueshëm ose të mira, e që dalin edhe për shpenzime riparimi apo investime themelore, nuk e dimë se si i kanë pasqyruar nëpër bilancet e tyre keto të ardhura dhe shpenzime, që atyre nuk iu rezulton sipas thënieve të tyre, disa punonjësve që janë ankuar për këto probleme, për të na paguar ne, për sa na detyrohen për pjesën e aksioneve që kemi. Këto probleme, ne i kemi ndjekur, kërkuar, si në drejtorinë e Albtelecomit, ku kemi dërguar një kërkesë të protokolluar për ankesat tona, por dhe tek avokati i popullit, edhe duke shkruar në media për problemet tona si punonjës, si me artikuj nëpër gazeta dhe në televizione, me pamje vizive, me kamera në televizione, si në Ora Njuz, i cili e ndoqi problemin duke ardhur në Elbasan para disa vjetësh, dhe e ka ritransmetuar përsëri filmimin, në të cilin ne ishim 2 shoqe të Telecomit, para godines së Telecomit, në të cilin u morëm në kamera etj. Edhe tek emisioni Fiks Fare kemi shkruar për këto problem, pasi kemi dërguar mesazhin zanor, jemi pranuar të hyjmë brenda ambienteve të këtij televizioni në dt. 28 Maj të vitit 2013, dhe pasi kemi paraqitur dokumentacionin përkatës, të cilin ia kemi dorëzuar gazetares, që me sa mbaj mend quhej Alisa, apo Melisa, të më falni për mossaktësinë e emrit, na kanë marrë me kamera më pas ,neve grupit përfaqësues të punonjësve të larguar nga puna, duke na premtuar se do ta transmetonin. Dokumentet e paraqitura nga ana jone i mbajtën ata. Pritëm disa muaj, e janë bërë afër 2 vjet dhe nuk e kanë transmetuar. Sa çudi për një emision aq investigativ, të mos të jepet, ajo që u xhirua, u filmua,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

e u premtua. Por ne nuk e lamë me kaq si grup, e ndoqëm çështjen, duke kërkuar, pranë këtij emisioni, zyrave të tij, arsyen e mosdhënies së filmimit që bënte fjalë për problemin tonë. Përgjigjia që iu kthye një shokut tonë, ish punonjës Telecomi në Elbasan, Shkëlqimit, i cili u paraqit pranë atyre për këtë problem, ishte se ashtu e pamë të arsyeshme që të vepronim, dhe se jo të gjitha problemet, ankesat nga qytetarët shqyrtoheshin, jepeshin në këtë emision. Ky qe justifikimi. Deri tani asgjë nuk na është zgjidhur. Edhe ne u lodhëm nga kjo heshtje nga ana e firmës turke, si dhe e mediave dhe e shtetit tonë, qeverisë tonë, duke na lënë mënjanë, e sidomos, në punonjësve të larguar, si dhe të tjerët që punojnë akoma, duke mos na shpërblyer për pjesën që ne jemi aksionerë për mëse 7 vite, e kemi hyrë në vitin e tetë, e të gjithë punonjësit që kanë punuar shumë vite në këtë ndërmarrje, presin më kot me shpresë, po si thotë dhe fjala e urtë e popullit, dielli duket që në mëngjes. Unë vetë, duke qenë se i kam ndjekur këto problemet me punëdhënësin e punëmarrësin, që kur punoja në Telecom, pasi kam qenë nënkryetare e Sindikatës, pasi kryetar kishim A. Boriçin, e unë së bashku me një grup punonjësish, një përfaqësi që na autorizuan, na lejuan shokët e shoqet e larguara nga puna, nga reformat, ku ishin, përveç meje, shokët si Lumja, Shkëlqimi, Emanuela, që bashkë me mua, u organizuam kaq kohë, e kemi luftuar nëpër instancat shtetërore, kemi kërkuar dhe bashkëpunimin e ish kryetarit të Sindikatave të pavarura të Telecomit, që atëherë ka qenë z. Sh. Vojka, me anën e të cilit dërguam për në Drejtorinë e Telecomit të Tiranës një kërkesë, ankesë, nga ky grup përfaqësues i punonjësve, dhe ish punonjësve, të Telecomit Elbasan, i cili ky z. Shpëtim, duke qenë se e ka ndjekur këtë çështje dhe në gjykatën e shkallës së parë Tiranë, e mori këtë kërkesë, dhe pasi e **protokolloi me nr. 8 të prot. në vitin 2012**, me sa mbaj mend, e dorëzoi në drejtorinë e përgjithëshme të Telecomit Tiranë, që tashmë zyrat i kishte në

TEUTA KARANXIIA (GANXO)

Kashar. Po ne, si e kam theksuar dhe më lart, kemi përdorur dhe mediat për këto problemet e mospagesës, si nga ana e shtetit, që nuk na ka dhënë pagat shpërblim që na takonin nga privatizimi, për të cilat, arritëm deri në gjykatën e lartë, po ashtu dhe pala turke, që nuk na ka dhënë ato që na takojnë, kemi lëvizur nëpër Tiranë disa herë, sa në një vend e sa në tjetër. Nuk mund të le pa përmendur kontributin në të holla të shumë shoqeve e ndonjë shoku, që na dhanë për të lëvizur si e theksova nëpër vende të ndryshme nëpër Tiranë disa herë, që ne kemi shkuar për problemet që kishim si punonjës. Në grupin e atyre punonjësve të pa paguar, përta i përket këtyre aksioneve, është midis të tjerëve, dhe motra ime, në qytetin e Gjirokastrës, e cila edhe kjo është shkurtuar nga reformat e bëra të Albtelecomit, duke u shkurtuar jo më të drejtë, pasi nuk iu suprimua vend i saj i punës, në mos gaboj, si shumë të tjerë, që mund të jenë bërë gabime nga ana ose e drejtorisë të firmës turke, ose më shumë nga ana e drejtuesve të filialeve të rretheve, pra nga ana e drejtuesve shqiptarë, që në disa raste nuk i kanë zbatuar si duhet reformat e bëra nga ana e firmës turke. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia edhe e ndonjë parregullsie nga ana e firmës në zbatim të këtyre reformave. Këtu, mendoj se ka pasur dhe ndonjë gabim subjektiv. Por të paktën, në përgjithësi, nga reformat që ka bërë, firma turke e ka zbatuar ligjin, pasi i ka shpërblyer dhe lajmëruar punonjësit më parë. Shpërblimi ka qenë paga e afër një viti pune, si dhe bonus për rastet kur reforma ka qenë e bërë mes pëlqimit të palëve, punëdhënës e punëmarrës, ndërsa për dhënien e parave për pjesën e aksioneve që ka secili nga ne, punonjësit, nuk po bën asgjë, edhe pse jemi në Dhjetor 2014. Kështu e ka ushtruar në vendin tonë aktivitetin e vet firma turke. Për këto probleme, besoj është detyra e shtetit i cili si rregullator që duhet të jetë, pasi ai ka lidhur kontratën dypalëshe, duhet të dijë t'i menaxhojë këto situata, dhe në ato raste kur nuk respektohen kontratat midis

paleve, duhen përdorur sanksionet përkatëse. Por kështu ndodh rëndom në vendin tonë në shumë raste me sa shohim, shteti mbyll sytë para firmave apo kompanive private që operojnë në vendin tonë, kur këto të fundit nuk respektojnë kontratat e lidhura të punës, lidhur me detyrimet që kanë ndaj punonjësve të tyre. Kushedi të shpresojmë se mbase ndonjë dite iu bie ndër mend të dyja palëve si asaj të shtetit dhe asaj të privatit, që të përmbushin detyrimet e tyre.

Me Ministrinë e Ekonomisë, në punëtorët e Albtelecomit, të përfaqësuar nga sindikata, jemi akoma në gjyq në gjykatën e lartë, për sa i përket shpërblimeve që na takojnë nga privatizimi i kësaj ndërrmarrjeje gjigande, e nuk dimë se si ka perfunduar gjyqi, besoj se do jetë bërë, se ka shumë vite, po nuk dimë së çfarë e si është vendosur, pasi në Gjykatën e Shkallës së Parë e fituam në punëtorët çështjen, të përfaqësuar nga Sindikata jonë e pavarur, që e ndoqi çështjen tonë, e që për këtë kjo përfaqësi e sindikatës, d.m.th. z. Vojka, kryetari i kësaj Sindikate, mori një avokat, që u pagua besoj me fondet e sindikatës. Pastaj ne na apeloj në shkallën e dytë Ministria e Ekonomisë. Por një gjë është fare e qartë, që ato 4 a 5 pagat e firmosura nga ana e Genc Rulit, ministër i atëhershëm, dhe të miratuara dhe në parlamentin shqiptar, në kohën kur kryeministër ishte z. Sali Berisha, ne duhet t'i kishim marrë me kohë dhe jo të zvarriteshim nëpër gjykata, për diçka që na takonte dhe që vetë shtetarët tonë e kanë firmosur e aprovuar, në institucionin më të lartë ligjvënës, siç është Parlamenti shqiptar. Nuk dimë më se çfarë të bëjmë ne si punëtorë, të gjitha i kemi bërë, për ne të dy palët kanë faj, kanë shkëlur të drejtën tonë, por si i thone fjalës, fjala jonë, kërkesa jonë mbase shkon në veshin e perëndisë se kështu u katandisëm, të bëhemi fatalistë, të presim e shpresojmë në fat, ose mbase kjo qeveria e tanishme na zbardh gjë. Por ne tani, siç përmenda dhe më sipër jemi shpërndarë si punonjës, ca nga reformat e ca në

TEUTA KARANXHA (GANXO)

pension, kanë mbetur shumë pak në punë, e këta nuk e ngrenë zërin, se janë dhe të rinj në punë një pjesë, ndersa ata, më të vjetrit që kane mbetur në punë, mjaftohen me marjen e pagës e kanë frikë besoj të hapin gojën, për të kërkuar ato që na takojnë si nga ana e shtetit dhe nga ana e firmës turke.

Nga puna në ndërrmarrjen e Telecomit, ku punova 10 vite, përpos të gjithave sa kam theksuar më sipër, nuk mund të mos përmend faktin që në punën time, në zyrën time nuk pata një kompjuter timin, për të punuar, pasi më duhej shumë, si për evidencat që unë bëja, si ishte ajo e asaj të sigurimeve shoqërore që bëhej çdo fund muaji, po ashtu dhe rakordimet që bëja me zonat, si ato të Peqin, Librazhd, Cërrik, Gramsh, në çdo 3 mujor që mbyllej rezultati financiar, e që bëhej bilanci, përveç të tjerave punë, në fund viti, si ishin inventaret, të cilat punë këto të gjitha që unë i bëja duke shëtitur nëpër kompjutera të shoqeve, në zyrat e tjera, si atë të shefes time, apo në atë të degës së personelit, pasi një kompjuter që kishim në zyrë, ishte dhe shoqja ime e zyrës që kishte punët e veta dhe qe kompjuteri i vetëm i zyrës ishte në tavolinën e saj të punës. Por kur ishte i lirë ky kompjuteri i zyrës, që ndodhte rrallë, unë uleshja e punoja. Edhe pse vinin, kohët e fundit, gjithmonë kompjutera, mua, nuk mu dha kurrë një kompjuter, qoftë dhe i përdorur, nga ata që linin ata që mernin keto të rinjtë që vinin, por babëzia e atyre që kishin kompjutera të mirë, por qe donin edhe më të mirë, nuk na linte radhë ne të tjerëve. Ky qe dhe një organizim jo i mirë nga ana e drejtorisë së ndërrmarrjes, por dhe një kërkesë jo me ngulm ndoshta dhe e kryetares së degës sonë të financës, e cila e dinte gjendjen e kompjuterave, e mungesës së tyre në zyrën tonë, por ndoshta kaq e dëgjonin dhe atë, sepse ndoshta dhe ka kërkuar.

E kështu, unë punova 10 vite, dhe e mbylla punën time pa një kompjuter personal, që është një gjë jo e mirë për një punonjëse moshatare si puna e ime, financiere e lartë, që isha afër pensionit,

po kush ta qante hallin. Këtë problem, ose më mirë, pakënaqësi, unë e kam më teper me drejtorinë e ndërrmarjes këtu në Elbasan, se nuk e besoj që nuk donte që unë të mos kisha kompjuter, drejtoria turke në Tirane, kjo gjë nuk bën vaki, sepse ajo, siç kam theksuar dhe më sipër gjithmonë ka dërguar kompjutera, kjo gjë ka qenë difekt i njerëzve tonë në ndërrmarje, i atyre që mereshin me këto punë, por sa para bën tani, unë e mbylla karrierën time pa një kompjuter në tavolinën time të punës, si ekonomiste e lartë, financiere, deri në vitin 2010, që unë punova, se me vonë u largova. Ky merak më ka mbetur në punën time, sepse unë punën e beja, si i thonë, e haja me dhëmbë, se kisha sedër dhe vullnet, e dija t'i përmbushja detyrimet e mia, por, Telecomi Elbasan, drejtuesit e tij janë në borxh me mua, ata të fundit që kanë drejtuar ndërrmarjen, në vitet e fundit të punës sime, si nga ana e sjelljes, komunikimit, po ashtu edhe për mungesa të mjeteve të punës, kur është fjala për ato kryesore për ne ekonomistët, si p.sh. kompjuterat, sepse, para se t'i kërkosh punën një punonjësi duhet që t'i sigurosh mjetet e punës, ku në rastin tonë me kryesori ishte kompjuteri, sepse makina llogaritese kishim. Ky është regulli numër një.

Gjithsesi, unë tani që jam në shtëpi, ngaqë nuk e kam pasur një kompjuter timin për vite me rradhë, tani e kam një në shtëpi, një lap top, falë vajzes time të madhe, Terezëz, që ma mundësoi, me të cilin unë punoj herë pas here, dhe në këtë lap top unë po bëj edhe këtë rrëfimin e jetës time. Edhe pse për të gjitha këto vërejtje ose mbresa jo të mira tek unë për çështjen e punës, të shprehura në forme kritike nga ana e ime, për të cilat unë ngaqë i kam jetuar e përjetuar, jo mirë, përsëri kërkoj ndjesë ndaj lexuesve, për ndonjë teprim, por ato janë të vërteta, reale, të jetuara. Por, pavarësisht këtyre, unë në ndërrmarjen e Telecomit, kam pasur dhe periudha të mira, në të cilat unë e kam kaluar mirë. Kjo ka qenë marëdhënia ime me te gjitha shoqet e punës, ku une ndërtoja

marrëdhënie të mira, ose mesatare për disa të tjera, sipas rastit, ose shoqeve të ndryshme, me tipe e karaktere të ndryshme, unë mundohesha të gjeja gjuhën, si për kryerjen e punës, kur kisha lidhje me to për të kryer punën time, ose dhe jashtë pune, për një marrëdhënie më të ngushtë shoqërore, kur ne dilnim jashtë kohës së punës, jashte ndërmarrjes, nëpër aktivitete të ndryshme, ose vizita apo disa raste nëpër festa individuale apo kolektive, në grupe të mëdhe apo dhe të vogla ose sebepe, të njëra-tjetrës, si ka qenë ps.sh. festa e gruas, 8 Marsi etj. Më shumë festa kemi bërë në kohën kur qe drejtor Bardh Bardhi, por dhe në kohën kur qe Janaq Biqiku. Po ne organizonim dhe vetë festa, pa drejtorinë. Të tilla kanë qenë, si ditëlindjet, si dhe raste të ndryshme familjare të shoqeve, qofshin ato të mira, apo dhe të tjera, jo të mira, që ishte ndonjë sëmundje etj. raste më të dhimbshme, ku ne shkonim me patjetër. Kjo gjendje sidomos ka qenë sidomos tek gratë, por dhe për burrat.

Mbaj mend që, në këtë ndërmarrje, ne kemi organizuar dhe eskursione të ndryshme, kjo ka ndodhur para se ndërmarrja jonë të privatizohej. I tillë ka qenë rasti i ekskursionit në Greqi, kur unë nuk isha sepse sa kisha ardhur në këtë ndërmarrje, dhe mua nuk më takonte, me të drejtë, sepse kishte shumë të tjerë para meje, me vjetërsi në punë. Atëherë ishte drejtor z. J. Biqiku. Më pas u organizua një ekskursion tjetër në Turqi, në Stamboll. Në këtë rast, këtë ekskursion, kur drejtor ishte Bardh Bardhi, mua më takonte dhe isha në listë, e kaluam mirë, ikëm me avion. Kur ikëm ishim 3 veta afër në rradhë, pasi kur ikëm ishim në një avion më të madh dhe fluturoam mbi 10000m lartësi, ishim siper reve, një pamje shumë e bukur që nuk e harroj, ishim aq lart, sa sipër kur ngrinim kokën kishte qiell të kaltër, ndërsa poshtë nesh ishte shtresa e reve e bardhë si në të përhimtë. Pasi ishim afër Turqisë, kaluam sipër detit Marmara, e ndaluam në aeroport, i cili ishte shumë i madh. Që prej aty na morën me autobuza e minibuza se

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ishim shumë persona në këtë ekskursion, afër 80, s'e mbaj mend mirë, por që ishim shumë, e kur u kthyem nga Turqia, erdhëm me një avion tjetër më të vogël, i cili i kishte vendet dyshe jo treshe si ai pari. Ky avion fluturoi në një lartësi 5000 m sipër tokës, e kishim mundësi që të dallonim si më mirë pamjet poshte nesh, si ndërtesat, malet, fushat, lumenjtë etj. Në këtë ekskursion ishin dhe shoqet e mia të zyrës, të dy Shpresat, si dhe Lida Ashiku me të cilën isha ulur ngjitur, si dhe Lida Papadhima, Moza Selita, shoqe dhe këto të zyrës, ishin dhe shoqet e mia që unë shkoja më shumë, si Marjana, Merita, i shte dhe kryetarja e konfederatës për Elbasanin, Shpresa Llate si dhe drejtori ynë, Bardh Bardhi. Në këtë ekskursion kishim dhe shumë shokë, si të ndërrmarjes dhe të tjerë, si Fatjon Kajanaku nga ndërrmarja dhe një mjek që erdhi me ne, Ben Kamami. Mbaj mend që në këtë ekskursion në Stamboll, një natë shkua në një lokal shumë të veçantë, aty kishte dhe balerina haremi, ku pasi pamë kërcimet e këtyre balerinave, kërcyem e kënduam edhe ne grupi i shqiptarëve, pasi kishte grupe vizitorësh dhe nga vende, shtete të tjera, hëngrëm dhe një darkë shumë të veçantë, kjo që nata e fundit e ekskursionit në Stamboll, pasi të nesërmen do ktheheshim, ajo natë ishte një mbyllje shumë e bukur për atë ekskursion. Ia kaluam shumë mirë. Kur zbritëm nga avioni, pasi arritëm, ngaqë nuk patem qenë herë tjetër me avion, e një pjesë e madhe patën shumë frikë, kur arritëm në aeroport, të gjithë përplasën duart, e para që e filloi duartrokitjen që Shresa Duka, ndjesë pastë se nuk jeton më, kjo, meqenëse arritëm shëndoshë.

Gjatë rrugës me avion, ndjesia që pata ishte e veçantë, por vetëm nisja dhe mbërritja kishte atë zhurmën e motorrave e të shurdhonte veshët. Një shoqja ime, me të cilën isha dhe në rresht afër, Lida Ashiku, i zuri veshët me tapa e nuk dëgjoi gjë. Unë nuk e dija, nuk e kisha provuar më parë. Në Stamboll, të cilin unë e pashë për herë të dytë, pasi kisha qenë dhe një herë tjetër para

TEUTA KARANXHA (GANXO)

shumë vitesh me ndërrmarrjen Rruga Ura ku kisha punuar më parë, dhe kisha qenë me autobus, që ishte një rrugë shumë e gjate e lodhshme, kisha mundësi të shikoje më shumë gjatë rrugës, si shtete e qytete, si p.sh. vendet si: Maqedoninë, Bullgarinë, e pastaj hyje në kufirin e Turqisë. Në këtë udhëtim ne e pamë më mirë rrugën e sidomos kur kaluam në urën e Bosforit, që ishte shumë e bukur. Po ashtu në Stamboll ne vizituam kishën e Shën Sofisë, ku hyrja brenda në të ishte me dollarë, më duket se 25 dollarë, si dhe Xhaminë Blu, pallatin e Sulltanëve, si dhe ndonjë vend tjetër, ku ne ikëm anës detit Marmara me traget. Por, në udhëtimin me traget, që ishte dhe ky shumë i veçantë e i bukur, kemi parë nëpër det e mbi kokat tona shumë pulëbardha .Mbjaj mend se frynte shumë erë, dhe brenda në traget servirej çaj. Kjo puna e çajit në Turqi, ishte karakteristike e veçantë, sepse dhe kur shkoje për të parë nëpër dyqane e për të bërë blerje, të servirej çaj. Ajo që më ka bërë përshtypje tjetër në Stamboll, ishte se nëpër dyqane kishte shumë mallra, të mbyste malli. Tregetarët të luteshin që të blije, e arrinin deri aty sa mund ta blije dhe gjysëm përgjysëm në çmim mallin që doje. Pra kishte mbifurnizim me mall. Të shumta ishin dyqanet e floririt, në qendër të Stambollit, ato ishin të gjitha në një vend, qe quhej tregu qendror, e që ngjante si nje tunel pa fund kur hyje. Atje shndrinte floriri, kishte shuma dyqane ku shitej flori. Aty kishte dhe shumë tregtarë kosovarë që me sa duket kanë emigruar shpejt në Turqi e merreshin me shitje blerje. Në Stamboll të merrej mendja nga ngjyra e verdhë e ndritshme e majave të minareve, të xhamive, që duhej të ishin të lara me flori besoj, kështu na treguan. Në udhëtimin në Turqi ne kemi qene me leket e ndërrmarrjes. Më ka ardhur keq për ata punonjës, gra dhe burra që nuk morën pjesë në këte ekskursion, per efekt të numrit të kufizuar, por dhe sepse detyra e tyre, puna për disa, ishte e pa mundur t'i lejonte, po kishte dhe ndonjë rast që u harrua të përfshihej, nga ana e atyre që u morën me këtë, e

TEUTA KARANXHA (GANXO)

që e bene të mundur, e organizuan, gjithmonë ndodhin kësoj gabimesh, janë të pashmangeshme.

Kur u kthyem nga Turqia, në avion isha me një shoqen time, që e kam shumë shoqe, me Meriten, ishim ngjitur, kemi dalë dhe në fotografi në avion. Si e kam theksuar dhe më sipër, kjo si dhe disa të tjera janë hequr me pa të drejtë, por sidomos kjo Merita, të cilës nuk iu suprimua vendi i punës. Ky rast ishte më shumë rast subjektiv, varej nga ata që e zbatonin reformën e jo nga ata që e orientonin, pra ata që ishin drejtues në bazë, nëpër ndërrmarrje. Kështu nga puna u hoqën më pas tani vitet e fundit, mund të ketë 1 apo 2 e 3 vjet, shume gra e burra, në moshë pune, shumë janë nga 40 apo 45 vjeç, por dhe 50 vjeç, e kjo gjë u justifikua, me zvogëlimin e administratës, me përqendrimin e punës në Tiranë, në drejtorinë e përgjithëshme. Sa keq të vjen për të gjithë këto shoqe e shokë që kanë ikur, të cilët kanë qenë më arsim të lartë, ekonomistë, inxhinjerë, shkolla teknike. Por edhe më keq të vjen për ndonjë rast tjetër, si ka qenë ai i heqjes të grave me aftësi të kufizuara, invalide, si ai i Lumturi Gjocit, Adelina Duzhës apo Shefikat Xhyrës, që dhe pse iu suprimua vendi punës, ku do punonin këta njerëz, kush do t'i merrte. Por kjo ka qenë në politikën e programin e reformave nga ana e Drejtorisë së Telecomit, pasi një pjesë të këtyre punonjësve iu suprimua vendi i punës.

Për të dalë nga ky episod i dhimbshëm i heqjes së një mase të madhe nga puna, po vazhdoj me rrëfimin për eskursionet, aktivitete këto që ne i bënim, e ku më vonë, kemi qenë dhe në një eskursion tjetër kur isha në këtë ndërrmarrje, por këtr herë në Kroaci, në Dubrovnik, por, këtë herë me pagesë. Ishte muaji nëntor, dhe une kisha 4 muaj që isha operuar nga tëmthi, e hoqa, e për këtë kërkova një vend të mirë në autobus, përpara, e kështu u bë, kryetarja e sindikatës së Elbasanit, e asaj të konfederatës, Shpresa Bardhi që e organizoi, ma siguroi vendin në radhën e

TEUTA KARANXHA (GANXO)

dytë, ku u ula bashkë me shoqen time, Marjanën. Në këtë eskursion kishte dhe nga ndërrmarje të tjera, si nga Bashkia e qytetit, mësuese, etj. Në këtë eskursion ishte dhe një motra e shoqes time Meritës, që dhe unë e kam shoqe dhe atë, Natasha Gjorga, një person i shkathët energjik, aktiviste e zonja, punëmbuarar. Mbjaj mend që rrugës në autobus, këndonim e bënim dhe kafe në kushte rrethanore. Në eskursionin e Kroacisë kemi kaluar nga periferia e Shkodrës, e pastaj pasi kaluam kufirin në Muriqan, hymë në tokën e Malit të Zi, aty kaluam në disa qytete, si: Budva, Podgorica, etj., e pastaj, me target kaluam në tokën për në Kroaci. Në këtë eskursion ne vizituam dhe ishullin e Shën Stefanit, që ishte shumë i bukur, aty, në ishull, ne pamë dhe disa hyrje, banesa të vogla, që na thanë se ishin të disa vipave, si të: Sofia Lorenit, Silvester Stalones etj. Në hotelin ku qëndruam në Dubrovnik për 3 ditë, ku u akumuduam unë me dy shoqe në nje dhomë, me Marjanën dhe Emanuelën, më bëri përshtypje shumë, shumëllishmeria e ushqimit, pakufizimi i tij, mund të haje e të pije lëngje e te konsumoje fruta sa te doje. Në restorantin e hotelit, kur shkoni për të ngrënë, e sidomos në mëngjez, kishte një muzikë të qetë, që të nanuriste jo vetëm të flije, por, dhe të zgjoheshë butë-butë, si me pambuk. Por dhe pamja e hotelit si holli dhe dhomat ishin shumë komode, të rregullta shumë, e çarçafet borë të bardhë.

Këto eskursionë që kemi bërë na kanë lidhur direkt me botën larg nesh, me shtete të qyteteruara, të zhvilluara, e më të fuqishme se ne. Ajo që më ka bërë një përshtypje më shumë në Kroaci, ishte pastërtia shumë e madhe e rrugëve, gjelbërimi i rrugëve e i vendeve, ngjyra e gjetheve të pemëve dhe e barit ishte një jeshile e bukur, e blerte, ato shkëlqenin e nuk kishin aspak pluhur. Për më tepër aty nuk shikoje fare dhe, çdo gjë ishte e sistemuar në vendin e vet, të thoje se aty nuk bëheshin ndërtime, që hedhin mbetje sa andej këndeje pa kujdes. Çdo ndërtim aty kishte rrethim

TEUTA KARANXHA (GANXO)

e izolim nga ambient tjetër ku vazhdonte jeta, me qëllim që të mos përhapej ndotja. Por këteë e bëjnë shtetet e kulturuara, ato që ruajnë mjedisin, ruajnë shtetet e tyre, ku dhe jeta e ndërimet të vazhdojne normalisht e pa krijuar probleme ndotjeje. E tani, pasi po mbaron dhe të treguarit për eskursionet, para se të vazhdoj me rrëfimin e rradhës, po kërkoj ndjesë për ato shoqe dhe shokë të punes emrat e të cilëve nuk i kam përmendur më sipër, e të tjerët nuk mund t'i përmend dot, sepse ata janë shumë, sidomos ata dhe ato me të cilët unë kam shkuar, të cilët kanë qenë shoket e shoqet e mia si p.sh. Avniu, Skënderi, Petriti, Arjani, Miljana, Elsa, Kozeta, Shpresa e permutatorit, Anila, Fatimja, etj., që për arsye të kohës, apo dhe të volumit të shkrimit, nuk i kam përmendur, por jo se kanë qenë të parëndësishem për mua, por dhe të tjerët, me të cilët unë kam pasur vetem një përshëndetje, e një marrëdhënie më të zakonshme.

Por unë tani, pa u zgjatur më shumë, dhe pa devijuar më shumë nga tema e shkrimit tim, po vazhdoj jetën time, jam në shtëpi, kam dalë në pension, i jam përkushtuar sërish më shumë familjes time. Fëmijët e mi tani janë rritur, vajza e madhe është e martuar me dy fëmijë në Tiranë, djalin e kam në punë si dhe të fejuar, me një vajzë shumë të mire që ka mbaruar për mjekësi, dhe që tashme sapo ka filluar punë dhe që ndërkohe pret të bëjë dhe ndonjë specializim, pasi ka mbaruar me rezultate shumë të mira. Djali im, vazhdon punë si dhe vajza e madhe ndërsa vajza e vogël, ajo e pleqërisë si i themi ne, vazhdon masterin në vitin e dytë në Tiranë. Une e dua shumë të fejuaren e djalit tim, nuk e ndaj nga vajzat, besoj se në këtë rast ia vlen të përmendet dhe shprehja e popullit, që thotë, nusja e djalit, si sytë e ballit. Tani po pres që të mbarojë shkollën dhe vajza e vogël, të rregullohet, e ne, me pas t'i kushtohemi më shumë vetes tonë, si unë dhe bashkeshorti, sepse tani për kushtet që ka ekonomia shqiptare, si dhe ajo familjare, jemi marrë më shume me fëmijet e jo me veten tonë,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

sepse jo vetëm ne, po kështu ndodh në Shqipëri, femijet mbahen vetem nga prinderit, deri sa ata të gjejnë ndonjë punë e cila është me zor, pasi oferta për punë me kërkesat për të janë shumë të pabarazuara, nuk janë njëlloj, ky është tregu i punës. Megjithatë edhe vajza e vogël imja, krahas shkollës, është përpjekur që të gjejë ndonjë punë me orar të reduktuar, për të përballuar më mire shpenzimet. Tani ka ardhur koha që fëmijet tanë, si të gjithë të tjerët e kesaj moshe të shikojnë jetën e tyre, e ne prinderit tonën. Po faleminderit Zotit dhe falë punës tonë si prindër, pak a shumë jemi të kenaqur deri tani, me jeten deri diku, e me nxjerrjen e fëmijëve në jetë, e cila nuk ka qenë vetëm në dorën tonë, por edhe të kushteve që ka vendi ynë, e sidomos Elbasani, ekonomia e të cilit është më e dobët, por me shpresë te zoti dhe të njerëzve do të ndryshojë besoj, e sidomos tani që u be dhe rruga e re, ajo Tiranë- Elbasan. Tani qyteti i Elbasanit do të ketë më shumë mundësi punësimi në Tiranë. Kjo gjë do të sjellë dhe ndryshim të gjëndjes, sidomos të ekonomisë në Elbasan.

Mbaj mend kur fëmijët e mi ishin më të vegjël, vajza e madhe afër 12 vjeç, djali 5 vjeç, kurse vajza e vogël nuk kishte lindur akoma, donim që të bënim synet djalin. Kështu e mblodhëm mendjen që ta benim, gjetëm dhe doktorin, e do e çonim në spital. Por nuk i kishim thënë djalit, po mendonim si t'i thonim, e më në fund er regulluam t'i thonim afërsisht, se si t'ja shpjegonim, që i vogël. Unë i bleva dhe një çokollatë të madhe, mezi e gjeta, se nuk kishte atëherë, dhe caktuam ditën. Por atë ditë, babai i burrit tim, ndjesë pastë, na i prishi planin, se pati frikë. E kështu, ne për ta marrë me të mira, i dhamë djalit atë çokollatën, se mos i prishim mendjen, por nuk u bë gjë, se dhe ai na e ktheu fjalën se që i vogël, e dëgjoi dhe vjehrin tim, i cili kishte frikë. Keshtu kaluan vitet e jetës time dhe në Elbasan, e tani që jam një grua që i lashë të 60 vitet, rri e shikoj se nga jam nisur e ku kam arritur, po them se asnjëherë nuk mbarojnë detyrat, kam akoma për të

TEUTA KARANXHA (GANXO)

bërë, deri sa t'i rregulloj fëmijët e mi përfundimisht, t'i sistemoj, 'ti martoj, kuptohet, kur të martohen vetë, e pastaj ne të dy bashkë me bashkëshortin, të vazhdojmë jetën si të moshuar, që do jemi për pak vite, se tani akoma nuk quhemi të tillë, por, pas të 65 viteve do hymë në moshën e tretë. Kështu janë fazat e tona si ato të punës si edhe ato të gjithë jetës sonë pasi, neve lindim, rritemi, punojmë, martohemi, lindim fëmijë, i rrisim, i shkollojmë, i fusim në rrugën e tyre të jetës derisa te ndreqen, jemi me sy e veshë të ngrehur, e pastaj kur janë rregulluar, rrimë e i ndjekim, i shikojmë familjet e tyre e gëzohemi që ia kemi dalë me ta. Por prapë asnjëherë nuk mund të themi se i mbaruam detyrat, punët tona, sepse më vonë do jemi të interesuar, se çfarë behet me nipat e mbesat, si mësojnë, si rriten, pse u sëmuren, si u sëmuren, si janë tani etj., probleme që nuk mbarojnë sa të kemi jetën. Kështu ndodh në familjet tona në Shqipëri.

Por mua mosha nuk më tremb, kjo është e pashmangshme. Jetuam pa dhe do te moshohemi, por të them të drejtën, nuk më pëlqen që të më quajnë plakë, kur të bëhem, por të më thonë e moshuar, sepse fjala plakë është e ashpër, sikur të vret, të tkurr, të dobëson moralin. Më ka bërë përshtypje, këtu në Elbasan, që kam 30 vjet që jetoj, i quajnë si me përkëdheli nënat, e sidomos kur i thërrasin, o plake, ma ka thënë dhe mua ndonjëherë djali im si me shaka, e ndonjëherë edhe e përsërit, për të më ngacmuar, por unë i them, plakë mos më thuaj, se nuk jam bërë akoma, pastaj, se si i thotë edhe kënga popullore, njeriu nuk plaket kur vjen mosha, por ai plaket kur don vetë. Rëndësi ka se si ndihesh, e jo se si je, sa vjeç je, por sa vjeç e ke zemrën, shpirtin, pastaj trupin. Po përveç kësaj fjala nënë, kur të drejtohet fëmija, ose mama, është e bukur, e ëmbël, e shenjtë.

E, tani që të mos largohemi më shumë nga tema e këtyre shkrimeve të mia, qyteti i Elbasanit, ku ne me familjen po jetojmë, ka ndryshuar shumë, janë zgjeruar rrugët e janë bërë të

reja, bulevardi ka disa vjet që është rregulluar, me lulishtet në rrëzë të kalasë në të gjithë gjatësinë e saj, me shatërvanet në krahun tjetër me ujë, që janë disa, me parkun e qytetit që është frymëmarrja e këtij qyteti e që në verë mbushet me njerëz, që nga mëngjesi që bëjnë xhiron e mëngjesit, si ecje sportive, vrap, apo kush bën shëtitje, e deri me mbasditen, apo shëtitjen e darkës. Aty ka edhe lokale që njerëzit ulen për të pirë edhe ndonjë kafe, çaj etj. E vetmja rrugicë në Elbasan që me nxjerr mallin e Gjirokastrës është rruga dhe rrugicat e kalasë, që janë me kalldrëm si qyteti im i dashur i lindjes. Mëngjeseve, unë kaloj shpesh në këto rrugica, pasi dal për ecje tek parku i qytetit në verë. Kur unë kthehem i bie nga parku ose e kundërta. Qyteti i Elbasanit është i qetë, i butë, por burrat në këtë qytet e duan shumë pijen, janë pijedashës e sidomos rakinë, ndërsa djemtë e rinj, birrën, pije. Po të shikosh lokalet janë plot me burra e djem si në mëngjes dhe në mbrëmje. Tani kanë filluar dhe gratë të dalin për kafe, se disa vite më parë edhe pse ishim në fillimet e demokracisë, nuk shikoje gra nëpër lokale. Ndryshe ndodhte në qytetet e jugut, si Gjirokastrë, Korçë, Sarandë, etj, kanë qenë më të civilizuarat gratë, dhe kjo shpjegohet me emigracionin më të hershëm që ka filluar në keto qytete, i cili ka sjellë edhe civilizim më të shpejtë të njerëzve si burra dhe gra. **Edhe qytetit të Elbasanit i kanë kënduar shumë, si këngëtarë të hershëm dhe të tanishëm. Një nga ato këngë është dhe kjo, vargjet e së ciles po i citoj: vajzat si sorkalle djemte si pëtrita, hedhin këngë e valle, anembanë, si ylber me ngjyra, vezullojnë dritat, Elbasan i bukur Elbasan. Ka dhe shumë këngë të tjera, si ajo për pusin që lahet vetë, si ajo ra Faja prej fikut, kënga e Behijes, kënga e Zenepes, ose Nepit, kënga e byrekut e dyqanit te usta Muratit, etj etj, këngë popullore të Elbasanit, të cilat unë i pëlqej dhe shpesh i këndoj nëpër shtëpi duke bërë punë, kur jam në terezi ose në humor. Kjo punë e madhe që është bërë**

TEUTA KARANXHA (GANXO)

në qytetin e Elbasanit për ta ndryshuar, si është sot, është sidomos dhe meritë e Qeverisë në rradhë të parë, por dhe e bashkisë së qytetit.

Edhe Elbasani si Gjirokastra, ka lumë, Shkumbinin, i cili dhe ai vjen që nga larg, anës qytetit, në rrëzë të kodrave të tij, e aty këtu kalon edhe në ndonjë fushë e luginë, e më pas derdhet dhe ky në det. Elbasani ka në lindje të tij kodren e Krastës, nga e cila në dimër vjen një erë, të cilën unë e ngjasoj me atë të grykës së Tepelenës, e cila, pra kjo erë, i bën mirë pastrimit të ajrit të ndotur prej tymrave të metalurgjisë, që edhe pse janë pakësuar e disi janë filtruar, prapë ka, si dhe tymit që krijohet nga djegja e plehrave të qytetit, i cili flitet se do të ndalet me berjen e landfillit të ri që do të fillojë së shpejti sipas fjalës e projektit të qeverise aktuale. Ne përëndim të këtij qyteti, janë kodrat e ullishtës, që zgjaten dhe pak nga jugu e pak nga veriu i Elbasanit. Këto kodra janë një kurorë e bukur, e gjelbër e këtij qyteti, dhe që filtrojnë edhe ajrin e qytetit duke i dhënë oksigjen, përveç bukurisë. Por përveç këtyre, Elbasani ka dhe Byshekun, që për mua është një pikë e bukur turistike, një fshat me një natyrë e pejsazh të bukur e të qetë për t'u shplodhur, ku atje, të gjithë elbasanasit, për festa, kur shkojnë, ose dhe kot për qejf, gjejnë ujin e ftohtë e të pastër që del nga burimi, si dhe gjelbërimin, si dhe ajrin e pastër e të freskët. Në këtë pikë turistike shkohet sidomos në verë.

Përveç qytetit të Gjirokastrës si dhe atij të Elbasanit, unë dua shume dhe e kam për zemer edhe një qytet tjetër, Tiranën. Gjithmonë kam dashur që të jetoj edhe në Tiranë sidomos, në Tiranen e asaj kohe, të viteve 1970-'71 e përpjetë, që frynte pak erë demokraci, në arsim, kulturë si dhe në muzikë, por me sa duket, qeverinë e asaj kohe, në regjimin totalitar e kishte zënë pak gjumi dhe i lejoi, sa mirë që i lejoi ca kohë, se u bë mirë për rininë dhe popullin, dëgjuan ca muzikë të huaj, si dhe panë ca kohë televizor, si dhe dëgjuan radio në stacionet e huaja, por pak, për

TEUTA KARANXHA (GANXO)

nja 2 a 3 vite, se pastaj, shteti u zgjua, e magjia u prish, e princesha u kthye në hirushe përsëri, kështu u mblodh dhe rrypi, filloi të shtrëngohej çdo gjë, si në muzikë, art, letërsi, ishte koha, e ashtuquajtur e Realizmit Socialist, kur filloi revolucioni, përndjekja, në këto fusha, ashtu si ndodhi edhe tek simotrat, në Bashkimin Sovjetik e sidomos, më pas në Kinë, ku revolucioni Kulturor, i masakroi shkrimtaret e artistët. Edhe Shqipëria nuk i shpëtoi dot kësaj rryme. Filluan shkrimet e muzikat, kompozimet, kooreografitë, këngët e vallet që i këndonin vetëm atij dhe vetëm atij më të famshmit; socializmit, partisë, diktaturës së proletariatit, kooperativave bujqësore, partizanëve të luftës, punës vullnetare të të rinjve nëpër aksione etj. Kështu ndodhte në çdo krijim, në çdo vepër arti. Nuk mund të botohej një vepër e asaj kohe, në sistemin totalitar, e sidomos pas viteve 1972, nëse nuk kishte Brenda personazhe apo heronj të luftës ose të punës socialiste, kështu të gjitha krijimtaritë, si ato në letërsi, art, muzike kalonin më parë në sitë. Ato kontrolloheshin nga njerëz të vënë nga partia, komisione të posaçme, të cilat kishin si qëllim që të pastronin çdo shfaqje apo dukuri të huaj. Ato komisione ishin gati që të sakrifikonin edhe ndonjë krijim shumë të arrirë, vetëm dhe vetëm që të ishte i pastër nga ndotjet e botës jashtë. Në këtë mënyrë edhe krijuesit, që kur do të mernin përsipër një krijimtari, e kishin të ngulitur mirë në kokë këtë gjë, këto kufizime. Kështu çdo vepër e tyrja duhej që të prezantonte bukur jetën e vendit, si dhe me mbështetjen në popull e tek Partia, biles kjo e fundit duhet të ishte në ballë, që të printe, të udhëhiqte atë, kopenë që quhej popull. Në krye të partisë, në keto krijime, nuk duhej që të harrohej, e të dilte në pah, pse jo, edhe ai, gjenerali i luftës, komandanti i madh fare, ai për të cilin duhej të thurreshin veç lavde, pse jo, dhe të këndoheshin dhe këngë. Kështu i këndonte i shkreti popull, këngët e bëra nga rapsodët e poetët për

të. E tani le të flasim pak më shumë e më gjatë për Tiranën, qytetin e rinisë time e të shkollimit tim.

Kjo luftë e ky cungim që iu bë letërsisë dhe arteve sidomos në vitet 1966-1967, viti kur filloi edhe lufta kundër fesë e besimit fetar në vendin tonë, vazhdoi deri në vitet '70. Më vonë në vitet '71-'72 pati një liberalizim të lehtë. Në vitet 1966-1967, kjo luftë u përqëndrua në të gjithë vendin, por më tepër në Tiranë, ku jeta kulturore artistike ishte më e gjallë dhe e larmishme. Qëllimi ishte që të luftoheshin të gjitha "idetë dhe shfaqjet e huaja". Në krye të kësaj lufte qëndronte Partia e Punës. E tani le të flasim pak më shumë e më gjatë për Tiranën, qytetin e rinisë time e të shkollimit tim.

Tirana qyteti i rinisë e shkollimit tim

Edhe ky qytet, kryeqyteti, më mirë të themi, ka historinë e tij, të veçantën e tij, si për historinë e tij, po ashtu dhe atë timen të jetuar në të në vitet e shkollimit tim. Kjo është Tirana e Qemal Stafës, si dhe e shumë dëshmorëve, heronjve të luftës e punës, e veteranëve, e intelektualëve të shquar, e profesorëve, doktorëve, shkencëtarëve, e kengëtarëve, që i kanë kënduar asaj, pra Tiranës, e të gjithëve që kanë jetuar e jetojnë në këtë qytet. Në këtë qytet filloi lëvizja komuniste, grupet e para, e më pas, lëvizja N. Çlirimtare, këtu u krijuan celulat e para, grupet e para të lëvizjes, të quajtur komuniste, që udhëhoqën më pas e shtrinë lëvizjen në mbarë vendin. Edhe para lëvizjes, luftës për çlirim, ky qytet ka qenë i mbushur me ngjarje, me histori. Në këtë qytet, janë vënë themelet e para të demokracisë, të shtetit të parë demokratik, me qeverinë e F. Nolit, e më pas ato të shtetit monarkik në qeverinë e A. Zogut. Tirana ka qenë qendra me e madhe në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së vendit tonë. Por

TEUTA KARANXHA (GANXO)

veçanërisht sot që arrijtjet janë më të mëdha. Tirana ka qene vendi ku janë lidhur aleancat politike, ekonomike, etj.

Ky është qyteti që unë kam vazhduar studimet, si ato të shkollës së mesme dhe asaj të lartë. Tirana më ka formuar mua, nga ana profesionale, intelektuale, shoqërore. Aty unë kam marrë të gjitha bazat e përgjithëshme, e më vonë ato të arsimit të lartë në degën ekonomi kontabël, financë. Në Tiranë kam shkuar shumë herët, që në moshën 14 e 15 vjeç. Atëherë, fill pas shkollës 8 vjeçare, që e bëra në atë Naim Frashëri të qytetit Gjirokastër, e ku kisha një shoqe, Liljanën, me të cilën shkoja shumë dhe e kisha dhe në klasë, e në bangë. Në këtë shkollë ne kishim mësues të mirë, si Agron Kabilin e lëndës së rusishtes, Lirika Harxhin, Feraset Kumbaron, Vaso Peshën, etj. Mbaj mend që një ditë, mesuese Feraseti, në një moment pas mësimit duke bërë humor me klasën, na këndoi një këngë të sajuar prej saj, ose një vjershë më mirë të them. Kjo ishte kështu. Lilit në pazar, taka iu këput, ndreqja o këpucar, vete dhe e lut. Mësuese Ferua, pra Feraseti, kishte 2 vajza, që quheshin, njëra Liljana dhe tjetra Teuta, ashtu si i kishim dhe ne emrat, dy shoqet që ishim në një klasë e në një bangë dhe që ajo na donte. Mbas mbarova shkollën 8 vjeçare, mua më doli për të studiuar në të mesme shkollën e gjuhëve të huaja, dega rusisht në Tiranë. Shoqes time të bangës, Liljanës, i doli për frëngjisht. Ajo shkoi në shkollë në Tiranë, kurse une jo, sepse më doli me lekë dhe nuk e përballonim dot se ishim familje e madhe e shumë fëmijë, motra e vëllezër, e me ekonomi të dobët, si e kam thënë dhe më sipër.

E kështu, u ndanë rrugët tona, imja dhe e shoqes time, Liljanës, me të cilën une jam takuar më vonë e takohemi ndonjëherë se jemi në qytete të largëta nga njëra-tjetra, pasi ajo jeton dhe është e martuar në qytetin e Përmetit. Më pas, une shkova në një shkollë tjetër, një kurs 1 vjeçar, profesional, si e kam përmendur dhe më lart, për të mësuar për trikotazhe në Tiranë. Pasi e mbarova atë,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

fillova punë në moshën 15 vjeç e gjysëm, në Ndërrmarrjen e prodhimit të veshjeve e quajtur me emrin e heroinës gjirokastrore të rënë në luftën për çlirim, Bule Naipit, tek reparti i trikove, në Gjirokastër. Atje punova një vit, me tre turne, ky repart u hap për herë të parë. Unë ngaqë isha dhe e vogël, akoma 15 vjeçe e gjysëm, me vinte gjumë, pas orës 12 e 1 të natës, mezi e shtyja, por ia dola, edhe normën e arrita, se puna ishte me normë. Puna ishte në këmbë 8 orë, si dhe duhej kujdes që trikot e punuara, e që, ato, trikot, në makineri, bëheshin me pjesë, si, krahët veç, pjesa përpara veç, e pastaj mëngët e jaka veç e veç, pastaj qepeshin me dorë nga punëtore të tjera. Puna ishte e bukur, artistike, por e lodhshme, e sidomos në turnin e tretë, veç kësaj duhej të kishe kujdes se mos bëje ndonjë difekt, se të kthehej mbrapsht puna, do e shqepje e do e bëje prapë. Po më e keqja ishte se mos duke punuar, pa dashje, nga nxitimi ose nga pagjumi, pra, nga mos përqendrimi i duhur, të thyheshin gjilpërat e makinës, apo më keq kur dëmtohej makina, duke u shtrembëruar tek pjesa që ishte me kanale, ajo si shinë ku rrëshqiste koka e makinës sa majtas djathtas, për t'u endur trikoja, e filli i akrilikut lëvizte lart i kaluar në një paisje që e mbante edhe të shtrënguar edhe e lejonte që të rrëshqiste e të vinte tek makineria, ku gjilpërat me një si punë grepi, si bize, ngriheshin lart dhe duke kapur fillin tek kokat e gjilpërave, thurej trikoja, ose bluzja. Si e thashë më sipër, nëqoftëse do të shkaktoje difekt në makineri, pa dashje, kuptohet, puna ndalonte dhe vinte tekniku për ta parë e rregulluar, sipas difektit, varej dhe shkalla e gabimit, dhe pas kësaj edhe vërejtja apo masa që mund të merrej ndaj punëtorëve. Mua, për vehte, më ndodhi nja dy herë, por jo difekte shumë të mëdha, pasi isha e kujdesshme dhe makinën e drejtoja me kujdes, jo shumë shpejt, që edhe n.q.s. më ndodhte ndonjë difekt, përplasja e kokës së makinës, tek shina mos të ishte e fortë, e për pasojë edhe difekti nuk do qe shumë i madh, e për pasojë edhe dëmi i shkaktuar. Puna

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ishte, që me rastin e ndonjë defekti të mos të shtrembërohej shtrati i makinerisë, pasi nuk rreshqiste me koka e makinës mbi të sa majtas e djathtas, e për pasoje nuk beheshin dot trikot e bluzat e akrilikut, pasi atëherë nuk para kishte të ardhura, pra të prodhuara nga jashtë, po prodhoheshin në vend. E kështu për difekte të tilla të rënda makineria dilte dhe jashtë funksioni e kërkonte riparim kapital, që do të thoshte zv. të pjesëve kryesore, me një kosto të lartë riparimi. Reparti i trikove ku ne benim praktikën në Tiranë na mesoi nga ana praktike, pasi ne bënim dhe teori në kursin që e benim në orët e mësimin në Tiranë.

Për të mos u zgjatur më shumë me këtë punën e trikotazhit, mbarova një vit punë, pasi bëra kursin, mora ca para, me të cilat ndihmova familjen, se si kam thënë dhe më sipër ishim 9 frymë në familje nga ku 7 ishim motra e vëllezër, e une isha më e madhja. Pas kësaj, mamaja ime, e cila më shikonte që nuk e shtyja dot në punë se isha e vogël, por veç asaj nuk donte të më linte pa shkollë, sepse isha shumë e mirë me mësim, më futi dokumentet për të vazhduar shkollën e mesme, të cilat i dorëzoi në këshillin popullor të lagjes ku ne jetonim, bashkë me kërkesën e bërë për ndonjë bursë studimi se ishim me vështirësi ekonomike. Une atëhere isha 16 vjeç e gjysëm, kur m'u dha e drejta e studimit për në shkollën e mesme teknologjike në Tiranë, për laborante, me një gjysëm burse, se ashtu e mendoj këshilli popullor i rrethit që i'a kaloi pastaj atij popullor të lagjes sime, se kështu funksiononte organizimi e ndarja e pushtetit atëherë. Prindërit e mi u gëzuan, ashtu dhe unë, më pas, unë lashë punën e në shtator të vitit 1971, fillova shkollën e mesme Teknologjike në Tiranë, e cila ishte në rrugën për në kombinat, kur shkon për aty, në të majtë, afër qytetit të nxënësve, që quhej, pasi aty kishte dhe shkolla të tjera profesionale. Nga shkolla ne e kishim afer fabrikën e bukës, tek e cila, kur nuk na punonin duset tona, se nuk kishte ujë të ngrohtë, shkonim të shtunave e laheshim në duset e punëtove

të kësaj fabrike, por në mes të javës, kur përsëri nuk na punonin dushet në konvikt, ne ngrohëm ujë me kova me rezistenca dhe laheshim me vështirësi. Unë atëherë i kisha floket shumë të gjatë, pas 2 vjetësh në konvikt i preva, sepse, edhe kushtet në konvikt nuk ishin për flokë aq të gjatë, por edhe doli moda e flokëve kesara, pasi ishte koha pas festivalit Italian të Sanremos, në mos gabo, si dhe ai i festivalit të 11 të këngës në radio Televizionin Shqiptar, ku ishin prezantues Bujar Kapexhiu dhe Edi Luarasi, festival ky që kishte erë pak liberale, duke marrë shembull si në veshje dhe interpretime paksa dhe nga festivalet italiane, si ai i Sanremos dhe të tjerë, ku këngëtarët italianë kishin këto modele flokësh, si femrat, por dhe meshkujt, pra dhe tek ne në Shqipëri, jeta në vitet 1971-72-73, ishte liberalizuar diçka në muzikë e kulturë, e kështu edhe ne filluam që diçka t'i imitonim, ishim të reja e kishim edhe ne qejf për një ndryshim. Unë për të mos rënë shumë në sy siç bënë ca vajza të tjera, nuk i bëra fiks kesara, por i thashë parukjeres që të m'i bënte më pak të ngrëna që të mos dukeshin shumë. E megjithatë bija pak në sy, se nga flokë shumë të gjata, deri në mes që i kisha, u prenë shume shkurt, por falë asaj prerjeje shumë të kujdesshme që më bëri parukjerja, nuk më tërhoqi njeri vërejtjen, kurse të tjerave iu tërhoq vërejtja nga komandanti ushtark i shkollës, që atëherë ishte Veleidin Kuçuku, nga zv. i tij si dhe nga mësuesit kujdestarë, drejtoresha e shkollës, Anthulla Dede, që ishte atëherë, si dhe nga sekretari i rinisë së shkollës. Unë dhe një shoqja ime gjirokastrite që e kisha në klasë, Z. Sino, ishim dhe në funksione drejtuese të shkollës e të konviktit, sepse ishim nxënëse të dalluara. Ne nuk na bënë asgjë, kurse shumë shoqe e shokët tonë, i nxoren nga rreshti që rreshtoheshim në mengjes para shkollës para se të fillonte mësimi, dhe i nxërrën dhe nga mësimi, e për ta u bënë mbledhjet e rinisë e të këshillit pedagogjik, e disave u dhanë vërejtje e disa

TEUTA KARANXHA (GANXO)

të tjereve u kërkuan të sillnin prindërit, e pastaj do të pranoheshin në mësim.

Shkolla jonë dhe konvikti që ishte pranë saj ishin ndërtesa të reja, dhe rrotull tyre kishte lulishte dhe stola ku ne uleshim dhe rrinim për t'u shplodhur në orët e pushimit. Në shkollë atëherë ne na aktivizonin nëpër spartakiada ose olimpiada që zhvilloheshin gjatë vitit mësimor. Mbjaj mend njëherë, kur u organizuan ato, olimpiada e spartakjada, ne na mernin e na bënë prova duke bërë lëvizje të ndryshme me uniforma apo dhe me flamurë nëpër duar, varej nga aktiviteti, e ku me ne nëpër stadium formoheshin kuadrate, apo edhe figura të ndryshme si dhe parrulla të ndryshme, të cilat ishin për partinë, Enverin, pushtetin popullor, diktaturën e proletariatit, luftën e klasave, etj., e po të mungonte një njeri, pasi prishej forma, simetria e kuadrateve, apo figurave a parullave, merreshin masa ekstreme, edhe në provat që bëheshin, pale po të mungoje në ditën që zhvillohej vërtet aktiviteti, përjashtohesh nga shkolla. Unë nuk mungoja asnjëherë, por një ditë mungova se isha e sëmurë me grip, e nuk vajta, ndenja shtrirë në krevat në dhomen time në konvikt. Për këtë më vajti emri në shkollë, tek drejtoresha, ajo më thirri në drejtori ,nuk e mori parasysh arsyen time, edhe pse isha nxënëse shumë e mirë dhe aktiviste dhe e zgjedhur në forumet e shkolës e konviktit, ajo më lajmëroi familjen time në Gjirokastrë. Kur ata më marrin në telefon e më folën, sepse ajo i kishte thënë që unë kisha shkëlur disiplinën e shkollës, meqë nuk kisha shkuar në provat e zakonshme të spartakjades, se kështu i mesonte Partia atëherë, por dhe ajo, drejtoresha, qe shumë e rreptë. Kur ajo veproi kështu me mua, që isha nxënëse dhe aktiviste shumë e mirë, vajhalli me të tjerët, e që atëherë, une edhe e sëmurë të isha shkoja në prova. Ishte kohë e diktaturës dhe në shkolla e konvikte kishte rregulla të forta. Ne kishim një kujdestar në konvikt që quhej Koço,edhe ai ishte i rreptë, po atij i mbahej goja e donte 1

orë ta thoshte një fjalë. Po kishim dhe një kujdestar tjetër që quhej Sadik, ishte burrë i moshuar dhe njeri i mirë. Ai sillej mirë me ne. Ditën në mëngjes ose në mbremje sipas turnit, ai rrinte roje tek dera e hekurt përjashta që ishte e mbyllur pothuaj tërë ditën. Edhe në mbasdite ai nuk të linte të dilje. Ne kishim liri dalje vetëm ditën e shtunë në mbasdite dhe të dielën. Në mbrëmje duhej të ktheheshe në konvikt, brenda orës 8 të darkës. Çdo ditë ne bënim studim të detyruar në një sallë, ku na rrinte një kujdestar na mbikqyrje tek koka. Mëngjezi, dreka dhe darka haheshin me orar. Po ne ishim të rinj, dhe kur na hahej ndonjë gjë, më tepër vakteve të caktuara, shkonim në mence e na jepnin pak bukë me djathë e qepë, kishim një guzhiner babaxhan. Unë isha me detyrë kryetare e këshillit të konviktit, e duhej të ndihmoja kujdestarin për zgjimin në mëngjes, për rregullimin e krevateve e dhomave, duhej t'u kërkoja llogari shoqeve e shokëve për rregullin e pastërtine e dhomave e të koridoreve, për rregullin në sallën e studimit, si dhe çdo ditë duhej të kontrolloja ushqimin e gatuar në mence, ku më lejohej që ta provoja unë dhe infermjerja e konviktit, Naimja, para se t'u jepej konviktoreve. Ne kishim dhe një grua, që qe kujdestare, Nafëriri, e cila ishte kërkuese, e rregullt.

Ne konviktorët, bënim dhe mbrëmje të shtunave, apo të dielave, ftonim dhe nga shkollat e tjera, vajza e djem, dhe ne sallën e televizorit, ku shikonim kur të mundeshim televizor, aty bënim dhe mbrëmje me orkester. Aty kalonim mirë, çdo javë e kishim nga një mbrëmje, e cila ishte e kontrolluar edhe nga mësues apo kujdestarë. Sidomos ai, komandanti i shkollës, Veledini, kërcente shumë bukur, kishte një kercim klasik, e për këtë të gjithë kishin dëshirë të kërcenin me të. Më duket se kish mbaruar studimet për ushtarak në Bashkimin Sovjetik. Ne kishim dhe disa mësuese të gjuhës ruse, të cilat ishin ruse, ishin martuar, dashuruar në Rusi me shqiptarë, që kishin qenë studentë në

TEUTA KARANXHA (GANXO)

Bashkimin Sovjetik, e këto ruset e ardhura, mësueset tona, na jepnin mësim. Mbaj mend që kur u prisën marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, nga fundi kur ne po mbaronim shkollën, disa nga keto mësueset, pedagogët, u larguan në vendet e tyre. Kishte dhe nga ato që ndenjën në Shqipëri, po ato vuajtën persekutimin e shtetit totalitar që qe atehere. Sa keq të vjen kur shikon se si janë trajtuar nga shteti atëhere edhe njeëz, si mësues etj profesione, ë cilet janë trajtuar si kriminelë, pa bërë fare krime, përkundrazi, ata ishin njerëz me shumë dashuri e devocion në punën e profesionet e tyre, në shoqërinë tonë, shumë prej të cilëve u keqtrajtuuan, pasi iu hoq e drejta më parë për të ushtruar profesionin e tyre. Ata kanë qenë kuadrot e para të vendit tonë që kanë studiuar nëpër universitetet e huaja, ishin ajka e shoqërisë, intelektualët e pare. Por këto ishin pasojat e rregjimit totalitar në vendin tonë, semundje kjo që kapi të gjithë lindjen e mesme. Sic e ka treguar historia, diktaturat si dhe diktatorët, kudo kanë pasur të njëjtën fytyrë, në çdo rregjim apo shtet totalitar.

Në klasë si e kam theksuar dhe më sipër, ne kishim dhe nxënës të jashtëm, tiranas, shokë dhe shoqe shumë të mira, si dhe të pashme, si Liljana Sulin, Sofien me kacurela të verdha, Meliha Grazhdanin, etj vajza si dhe një djalë shumë të mire, shok i mirë, aktivist i mirë, e me mësimë i mirë, Fatos Gramenon që e kishim dhe sekretar rinie të klasës. Por vajza më e pashme në klasen tonë qe kjo, Liljana Suli, e gjatë, bardhoshe, e folur, e qeshur, me sy të mëdhenj e në formë bajame, si sytë e personazhit në filmin japonez, Shpatarja e Verbër, Oici. Kështu, mua më iku viti i parë e me rradhë dhe të tjerët, derisa shkolla në Tiranë mbaroi. Gjate kohës së shkollës, unë si të gjitha vajzat, pata edhe propozime e pëlqime nga djem të viteve më sipër të shkollës time apo dhe të tjerë të jashtëm në Tiranë, por unë nuk u vija rëndësi, pasi kisha për qëllim të dilja mirë me mësimë, të ikja në vendin tim, Gjirokastër e të filloja punë, se për shkollën e lartë e kisha

TEUTA KARANXHA (GANXO)

mbledhur mendjen, që nuk do e bëja menjëhere pas shkollës së mesme, edhe pse m'u lutën petagogët, se isha shumë e mirë me mësim, por ashtu i kisha kushtet familjare, me duhej të dilja në punë, të ndihmoja familjen, të shkolloheshin e rriteshin edhe vëllezerit e motrat e tjerë. Vëllai im më i madh, pas meje, sapo kishte ikur ushtar në ishullin e Sazanit, e përveç nënës e babait tim që ishte dhe sëmurë, ne nuk kishim njeri në punë. Ata më prisnin mua. Kështu ndodh kur je femija i madh, ke më shumë detyra si dhe më përgjegjesi, detyrime. Po shkolla dhe jeta që bëra në Tiranë për mua ishte e kaloi shumë mirë. Në konvikt ishim mirë me njëra-tjetrën, aktivitete bënim, edhe filma shihnim, tek kinema 17 Nëntori që shkonim më shume edhe në ndonjë tjetër, shkonim në teatro, opera, koncerte etj. Ne edhe pse ishim në konvikt, jetën e kishim plot me aktivitete, unë aktivizohesha dhe nëpër grupe recitimi, teatrale apo dhe të këngës që organizonte shkolla. **Mbaj mend që në një koncert recital, në pallatin e kulturës në Tiranë, kam recituar vjershën partizani Meke ndërsa në një dramë teatrale që ka luajtur grupi i shkollës time, kam luajtur në rolin e nënës, tek Familja e Peshkatarit, ku unë në rol isha gruaja e Jonuz Brukës, që kisha 3 djem, e ku na udhëhoqi aktori profesionist, Petaq Zhillari. Me grupin e këngës në shkollë kam kënduar këngën e maliherit në duet. Këtë këngë e kam kënduar edhe në një shfaqje tjetër që kemi organizuar me grupin e Ndërrmarjes, Uzinës Metalike Gjirokastër, ku unë fillova punë pas mbarimit të shkollës, pasi vazhdoja akoma tëë aktivizohesha nëpër grupe apo koncerte me këngë siç janë zhvilluar në shkollën tonë, kam kënduar në duet me një shok, këngën e maliherit, vargjet e së cilës më vine akoma në mend. O seç më nxorre sot atë mall, me pushkë në krahë e me gjerdan, kur nëmoshë të re mora malet, dola partizan, etj. etj. Në ndërrmarrje këtë këngë e kam kënduar me një djalë nga lagjja Dunavat, një djalë gjirokastrit, Xhelal**

TEUTA KARANXHA (GANXO)

Angonin, që kishte një zë baritoni, shumë të mirë. Kështu kanë kaluar vitet e shkollës, të punës dhe të jetës time, me mësim, punë, detyra e aktivitete, unë isha një tip energjik, si dhe kisha edhe qejf edhe talent e doja vetë të aktivizohesha edhe me aktivitete artistike, por edhe detyrat që më ngarkoheshin në funksionet ku unë zgjidhesha në shkollë a punë i kryeja. Mua sikur ma lexonin në fytyrë pedagogët, që dija e doja të isha aktiviste e për këtë më caktonin.

Pas Gjirokastrës si edhe Elbasanit, Tirana është qyteti i tretë që unë dua shumë, për të mos të thënë që e kam shumë të dashur, si Gjirokastrën dhe Elbasanin, pasi është qyteti që unë kalova rininë time, moshën më të bukur. Tirana mua më mësoi, më edukoi, më formoi, nëpër shkollat e saj, më mbushi me jetën e saj kulturore artistike. Të ishe në ato vite në Tiranë ishte një gjë e rrallë. Shumë pak nxënës e studentë e kishin fatin që të shkonin aherë në Tiranë. Ne ndiheshim të privilegjuar, sepse Tirana ishte ndryshe nga qytetet tona, me ato rrugët e veçanta të saj, dyqanet, kinematë, teatrot, sallat e koncerteve, të pallatit të kulturës, që unë i kam shijuar, duke recituar, kënduar, aktruar, etj. Kur ne dilnim nëpër Tiranë, kënaqeshim me ato xhirot që bënim, me atë lirinë e kufizuar që kishim kur dilnim se ishim konviktore, por neve na shijonte shumë, kishim shumë shoqëri, me njëri-tjetrin në konvikt, por dhe me shokët e shoqet e klasës që ishin të jashtëm, sepse jetonin në Tiranë. Kënaqeshim kur dilnim e blenim akulllore, apo kur dilnim eskursion, si në malin e Dajtit etj. Mbjaj mend një herë kur në shkollën tonë, mesuesit e fiskultures na organizuan një eskursion, shkuaam në malin e Dajtit në dimër. Kishte borë në mal dhe aty qe lezeti. U ngjitëm me gara kush të ngjitej me shpejt. Pasi arritëm, u akomoduam në dhomat e hotelit dhe pasi ndenjëm ca në holl ku zhvilluam dhe aty një aktivitet, kërcyem dhe u kënaqëm, hëngrëm dhe darken dhe fjetëm nëpër dhomat e hotelit. Disa u çuan në mëngjes dhe bashkë me mesuesit

e fiskulturës u ngjitën në majë fare të malit, nga ku dukej çdo gjë, e gjithë Tirana në pëllëmbë të dorës. Po ne shumica nuk vazhduam më tej, se ishim të lodhur nga dita e parë, por edhe nga aty ku ne ishim dukej shumë bukur, kishte goxha panoramë. Në këtë eskursion na erdhi dhe na e mundësoi më shumë mësuesi ynë kujdestar, Agim Jakupi, i cili na jepte lëndën e matematikës dhe ishe shumë i ri dhe i mirë, ai mund të ishte 24 a 25 vjeç atëherë. Me të merreshim vesh mirë, e ndonjëherë kur nxehej, skuqej, mbase dhe nga muhabeti i lirë që kishim ne, por se ishte dhe i urtë dhe pak i turpshëm.

Tirana ka pritur e pret çdo vit studentë të cilët shkollohen, e me pas në sajë të lëvizjes së lirë që kemi tani që jemi në demokraci, punojnë e jetojnë aty një pjesë e mirë e tyre. Po jo vetëm këta, por tani në Tirane janë shtuar shume edhe të tjerë njerëz, që gjejnë punë aty, të ardhur nga qytete të tjera e shkojnë e vijnë çdo ditë, si ata nga Elbasani apo dhe nga Durrësi, Kavaja, që janë afër, ose të tjerë që edhe pse janë larg në distancë, punojnë aty, e lëvizin 1 ose 2, a 3 herë në jave për në familjet e qytetet e tyre, ose më gjatë, sipas mundësisë që kanë të punës. Shumë njerëz që vite më parë do shkonin në Tiranë e donin të takoheshin, vendi i parë, më i lehtë më i kollajtë për t'u gjetur e takuar me njëri-tjetrin, ka qenë tek Skenderbeu, ose tek Banka e Shqipërisë në qendër, si pikë referimi, takimi, por më shumë lihej për t'u takuar tek Skenderbeu, Monumenti, që aty është dhe sot, përveç sheshit përpara, që ndryshon sa herë ndërrohen partitë e kryetaret e bashkive, të cilët për ta ndryshuar disi, bëjnë konkurse për arkitektë e projektues, për të realizuar një projekt të ri, një pamje tjetër më ndryshe të qendrës, të sheshit. Unë, edhe tani që jam në pension, pak kam që kam dalë, dua që të vete ndonjëherë në Tiranë, e kam si të nevojshme, edhe pse kam familjarë të mi aty e të afërm që aty banojnë, prapë edhe po të mos i kisha aty, do shkoja ndonjëherë, sipas mundësisë se tani jam në pension, me të

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ardhura më të pakta në krahasim me ato që kisha kur isha në punë me pagë të plotë. Une them se të jetosh në Tiranë është gjithmonë mirë, pasi ajo të jep me shumë mundësira në jetë, sidomos për të rinjtë. Koha më e bukur që kemi kaluar në Tiranë, ishte ajo kur isha në shkollën Teknologjike, atë të mesmen, ne qytetin e nxënësve, afër tij. Shoqëria në atëshkollë, në atë moshë, ishte e pastër, e dliërë, e pafajshme, por ishte dhe koha e tillë, pasi ishin pothuaj të gjithë njësoj edhe nga pozita e jonë shoqërore, punë, ekonomia, të gjitha këto ishin, me ndryshime të vogla.

Në shkollën tone kishim edhe emigrante që ishin në konviktin tonë nga shtete të tjera, si një vajze, p.sh. që quhej Sanija Sinovarfi. Këto raste shteti i ynë i ndihmonte, ishin me bursë, dhe kjo Sanija trajtohej dhe ndihmohej nga shteti edhe me lekë shtesë, në çdo muaj ajo merrte një kuotë të caktuar si dhe i bliheshin veshje. Ne si klase u takuam me njëri-tjetrin pak herë pas mbarimit të shkollës, e më pas nuk jemi takuar më. Kemi 41 vjet që e kemi mbaruar shkollën dhe nuk i dimë fatet e njëri-tjetrit e jetën se si iu ka shkuar. Kishim një djalë sekretar rinie të klasës, quhej Fatos Grameno, ishte tiranas, ishte djalë shumë i mirë, i qetë, i sjellshëm, shumë i mire dhe me mësim, i cili u dashurua me një vajzë jo të shkollës tonë, e u fejua, ishte pak si e veçante fejesa se qe shumë i ri, 18 vjeç. Për një vajzë edhe mund të ndodhte, po për një djalë qyteti e sidomos nga Tirana, qe edhe më e veçantë, por kështu ndodhi, mbase dhe familjet e të rinjve kanë pasur ndikimin e tyre. Në shkollën time të mesme, atë teknologjike, sekretare rinie të sholles ne kishim një vajzë, një shoqen time të klasës si dhe patrioten time nga Gjirokastra, Zaho Sinon që ishte me banim në një lagje tjetër afër times, në lagjen Cfaqë në Gjirokastër. Edhe kjo ishte vajzë dhe nxënëse shumë e mirë si dhe aktiviste. Ashtu si dhe unë edhe kjo nuk e vazhdoi shkollën e lartë, por filloi punë, e me sa di as më vonë nuk e vazhdoi, ndërsa unë e vazhdova pas disa vitesh, si nga 3 a 4 vitesh

me pas. Ndryshe nga qytetet e tjera, të cilet u përkasin më shume atyre që kanë lindur apo që jetojnë aty, ose punojnë, Tirana është e të gjithëve, u përket nga pak të gjithëve, pasi është vendi ku të gjithë e kanë parë, vizituar, janë shkolluar, ose kanë punuar, është kryeqytet, metropol, që është bërë tashmë në vitet e fundit, nuk e besoj që të ketë ndonjë që nuk e ka parë a ndenjor sado pak në Tiranë. E sidomos tani që është bërë dhe rruga e re me tunele Tiranë-Elbasan, e cila do të mbarojë së shpejti me përfundimin edhe të asaj pjesës që po punohet akoma, Tirana po vizitohet edhe nga vizitorë nga Maqedonia, apo dhe shqiptaret e atjeshëm, si dhe ata nga Kosova, të cilët tani kanë një mundësi më të mirë për të ardhur nga ruga tjetër e re, ajo që mori emrin Rruga e Kombit, rruga Durrës-Kukës, rrugë të cilat këto janë rrugë bashkëkohore, me të gjitha parametrat e duhur. Këto rrugë të reja, e kanë bërë më të mundshme ardhjen e vizitorëve, qofshin këta të huaj apo shqiptarë, të cilet i sjellin shpesh në Tiranë. Kjo është Tirana e sotme, e të tërëve nga pak, edhe pak e imja.

Kur une isha në vitin e parë të shkollës teknologjike në Tiranë, nga fundi i saj, një djalë nga Berati që ishte po ne këtë shkollë, më vinte rrotull, si e kam përmendur dhe më sipër. E shikoja, më binte në sy, por ishte shumë i matur, i qetë, i pjekur për moshen që kishte. Ai ishte në vitin e fundit, por unë e kisha filluar shkollën 2 vjet me vonesë, për arsytet që kam përmendur më sipër. Pra i binte që ai të ishte 1 vit apo 2 më i madh, varej se sa vjeç e kishte filluar shkollën në klasen e parë apo dhe të mesmen. Ai ishte një djalë shumë i bukur, brun me sy e flokë të zinj, kaçurrela, i gjatë, elegant dhe nxënës i mirë me mësimet e me sjellje. Ai dukej që ishte djalë i mirë dhe përshtatej deri diku me mua, sepse ishim dhe nga jugu të dy e ma merr mendja se do ishim kuptuar po të kishim vazhduar lidhjen, por unë kisha frikë, s'kisha garanci, pastaj qëllimi im i ardhjes në Tiranë ishte vetëm kryerja e shkollës, prindërit mezi më prisnin që të mbaroja e të filloja

TEUTA KARANXHA (GANXO)

punë, dhe edhe për këtë nuk i jepja ndonjë shenjë atij që e pëlqej. Ai erdhi edhe vitin tjetër, kur vetë e kish mbaruar shkollën, si thashë më siper, erdhi, e me të njëjtin qëllim, donte të më takonte të bisedonte me mua. Ishte 1 vit më i rritur, sikur që burrëruar, ngulmoi, me priste në oborrin e shkollës kur unë po dilja e më ndaloi për 'tu takuar. Për të mos u treguar e pasjellshme, por edhe sikur më pëlqente të bisedoja, ndalova dhe në lulishten e shkollës në një stol dhe biseduam. Më tha se donte që të bisedonte më gjatë me mua, lamë një takim në Tiranë, u takuam e biseduam. Unë i thashë që të priste sa unë të mbaroja shkollën e pastaj të shikonim se çdo bëhej, pasi doja që të bisedoja edhe me prindërit e mi. Kështu e lamë e ai u largua për në Shkodër, ku po vazhdonte studimet e larta për mësues. Koha po ikte dhe ne nuk u pamë për nja 3 a 4 vjet, vetëm më shkruante letra, të cilat kur isha në shkollë m'i jepte një shoqe e imja që ishte nga Berati dhe që ai ja jepte asaj për të m'i dhënë mua, më vonë kur ika në Gjirokastër, ai m'i dërgonte me poste në shtëpi. Mamaja ime që punonte në poste m'i sillte, nuk mi hapte, unë i merrja i lexoja, dhe shumë herë nuk i ktheja përgjigje, mamaja ime e kishte kuptuar që ishte diçka, por kishte besim tek unë, unë i kisha thënë që ishte një shok i shkollës. Ajo, mamaja kurrë nuk m'i hapte letrat, të njëjtën gjë kam bërë dhe unë me fëmijët e mi sot, nuk i kontrolloj kurrë, as çantat, as xhepat, as dokumentet personale. Kaluan dhe nja 2 vjet të tjerë, e kur mbaroi shkollën ky djali, e kish filluar punë, vjen ne Gjirokastër, aty ku unë jetoja. Unë sapo kisha filluar punë dhe ai kushedi se ku me pa e më priste, po në lagjen time, që e dinte adresën, nga letrat që shkëmbej. Kur po vija nga puna, në rrugën për në lagjen time, më priste e më takoi. Ecem bashkë nuk ndaluan dhe më tha se koha që kishte kaluar e kishte bërë më të vendosur për t'u lidhur me mua. Me tha se kishte filluar dhe punë në Berat. Unë jo se nuk e pëlqej, po si dhe kam thënë më sipër, nuk isha akoma gati për të bërë një lidhje, mendoja të punoja e të

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ndihmoja familjen edhe për nja dy vjet, sa të fillonte punë dhe vëllai pas meje të pakten. Ai u largua, pa ndonjë shpresë nga unë. Pas ca kohësh që mua më ndodhi vdekja e babait, erdhi dhe një herë në Gjirokastrë, për të bërë një kurs 3 mujor që bëhej atëhere për oficer rezervist, që më pas i caktonin si komandantë a komisarë çetash vullnetare. Më vonë edhe unë e bëra një të tillë 3 muaj, në fshtin Arshi Lengo të Gjirokastrës, ku na mobilizuan, rrinim, stërviteshim, merrnim leksione, e flinim aty në kabanone, tamam si të ishim ushtarë efektivë. Kështu bëhej atëherë, edhe me vajza e djem të ri e të zgjedhur ,me biografi të mirë. Kur mbarova më caktuan komisarë në forcat vullnetare të qytetit, të lagjeve Manalat, Dunavat, Cfake. Edhe pse erdhi përsëri, e kishte më shumë mundësi për të më njohur e biseduar më shumë, me këtë djalin nga Berati, prapë nuk i dhashë shpresë, këtë herë isha dhe e mërzhitur për vdekjen e babait. Mbas 1 viti e gjysëm pas kësaj kohe erdhi përsëri, me takoi tek lagjia 18 Shtatori, më priste kur dola nga puna para ndërrmarrjes, e vazhduam rrugën duke biseduar, deri afër shtëpisë time. Aty më tha se donte një përgjigje përfundimtare nga unë dhe se kohën që kishte kaluar e kishte marrë si etalon, nuk kishte fare dyshime në personin tim. Por edhe këtë rradhë nuk qe e mundur, e kisha të vështirë, aq më tepër që ishte larg Gjirokastrës dhe nuk desha që në ato rrethana të ikja e t'i lija familjarët e mi, aq larg. Kaluan dhe disa muaj dhe sërish ky erdhi, këtë herë me tha se qe bërë dhe drejtor shkolle, m'u duk pak si çudi se qe akoma i ri, e mendova një herë se mos e bëri për mburje, por m'u betua që jo. Nuk qe ndonjë çudi, ai qe djalë i rregullt, kishte dhënë nja dy vite mësim, dhe ja ku e kishin bërë drejtor. Ç'kishte këtu për t'u çuditur nga ana ime. Me sa dukej fati nuk po më ndihmonte, ose më mirë të thëm qe ai, fati, më erdhi sërish, po unë e shtyva fatin, se nuk qenë kushtet aq të voliteshme se ky fat për momentin që po kalonim si familje qe larg. Në ato dite mua më kishin kërkuar dorën në Gjirokastrë për

t'u fejuar, isha e dyzuar, si të bëja, por e mblodha mendjen e ja preva shkurt këtij djalit që më deshi shumë, por pa e lënduar, i thashë se nuk isha gati, se nuk i kisha kushtet e të më harronte. Një shoqja ime që me pa qe e takova, e që dhe në sy të saj po më lutej, këtë e kisha dhe kushërirë të larget nga mamaja, e kisha dhe në punë dhe në lagje, i tha troç se unë isha gati për t'u fejuar, e të më linte rehat. Unë nuk ja thashë dot këtë, e ai më pa në sy e u çudit, por ajo shoqja - e kushërira e mamasë kishte të drejtë, i tha të vërtetën, por ia tha si një gjëmim, pa takt me shkrepëtimë, ai nuk e priste nga mua, se më besonte, po si thashë dhe më lart, nuk doja ta lëndoja e t'ja thosha që isha afër për t'u fejuar. Ai u largua, pasi unë nuk i mohova fjalët që i tha ajo kushërira, Merita Sokolli, quhej ajo. Që atëhere, s'e kam parë e dëgjuar më. Unë vazhdova jetën time, u fejova me atë djalin nga Dunavati nga Gjirokastra, dentist, mjek stomatolog, ma rekomanduan me krushqi, më kërkuan në familje sipas rregullit e më vonë u fejova, më pas u martova. Ja pra, unë vendosa të lidhesha me një djalë me mblesëri, pasi e pashë dhe bisedova nja dy herë. Në fakt, unë kam gene e pjekur si para kohe, prej jetës që bëra, me halle familjare, duke iu bashkuar prindërve në problemet e tyre, duke i jetuar dhe ndjerë dhe unë ato, si ata. Po nganjëherë them se mirë bëra që nuk u lidha me ndonjë djalë me dashuri, sepse dashuria nuk është vetëm zemra që rreh fort, sytë që verbohen prej saj, veshet që nuk duan t'i dëgjojnë të tjeret, për shkakun e dashurisë, apo uji që rrjedh si një ujëvarë, por dashuria është më shumë pëlqimi i ndërsjelltë me këmbë në tokë, me arsye, është mirëkuptimi me njëri-tjetrin, respekti i ndërsjelltë, të ndihmuarit e njëri-tjetrit në çift, sidomos në nevojë e në kohë të vështira, kjo mendoja dhe akoma mendoj unë, se ishte dhe është dashuria e vërtetë, pa e sfumuar atë dashurinë me shikim të parë, pa e bërë atë të pavlerëshme, atë që e jetojnë e përjetojnë shumë të rinj, e për më

TEUTA KARANXHA (GANXO)

tepër kur e çojnë deri në fund, e përfundojnë jetën me njëri-tjetrin me atë dashuri.

Mbaj mend që, kur u martova, në ditën e dasmës time, që ishte vetëm një darkë e thjeshtë, pa muzikë, me njerëzit më të afërt në shtëpinë time, pasi ne kishim qenë në zi nga vdekja e babait tim që atëherë kishte 2 vjet që kishte vdekur, unë u veshja me fustan të bardhë, sipas traditës. U bë një ceremoni e thjeshtë, pa kënduar, vetëm duke uruar e duke bërë muhabet, kaq ishte. Kur mbaroi darka, unë pasi ikën njerëzit e afërm, pa hequr mirë fustanin, fillova punët e shtëpisë, ngritjen e tavolinës, e më pas pastrimin, sepse isha më e madhja, motrat e mia ishin më të vogla. Të nesërmen do vinin të më merrnin njerëzit e bashkëshortit, ata do të bënin dasëm me orkestër. Atë ditë që unë kam dale nuse e veshur me të bardha, e përcjellë nga njerëzit e mi të afërm, duke zbritur kalldrëmin e rrugicës së shtëpisë time, më kapi syri tek rruga poshtë ku do zbrisja unë, po dilte një makinë e xhenazesë, unë u mërzita sa e pashë, e dëgjova dhe të tjerët që më shoqëronin seç pëshpëritën, ky ishte një ogur i keq, një shenjë e keqe që ma dha Zoti, e hajde mos e beso pastaj këtë shenjë, kur ashtu keq më eci fati, pasi bashkëshorti i parë vdiq shumë i ri. E unë, tani që jam në këtë moshë, e shikoj se kam gjykuar e vepruar mirë përgjithësisht mirë, pavarësisht fatit, që e pret çdo njeri. Martesa ime zgjati afër 1 vit, pasi bashkëshorti im ndërroi jetë i ri fare, nga një infarkt, e unë pas disa ditësh e mërzitur sa me s'kish ku të shkonte, se na u bënë 2 vdekje shumë afër në kohë në shtëpinë tonë, u ktheva sërish tek mamaja ime në moshën afër 25 vjeç, nuk i kisha mbushur akoma. Nganjëherë mendoj se mos më ka mallkuar ai djali që unë e lashë, që më eci kjo jeta kaq keq, po prapë them se nuk e lashë unë, po vetëm që nuk i pranova për kushtet e mia. Ishte thjesht fati që e kish shënuar rrugën time. Më pas unë vazhdoja jetën, punën, dhe më pas, pas 6 vitesh, mua më doli sërish një rast tjetër për t'u martuar, po me krushqi, pra me

TEUTA KARANXHA (GANXO)

mblësë, në qytetin ku jam dhe sot, në Elbasan, ku linda dhe fëmijët. Si për t'u cuditur, kisha shumë kërkesa për t'u fejuar e martuar sërish edhe pas fatkeqësisë, edhe në qytetin tim si dhe jashtë tij. Për ironi të fatit, që unë nuk kam dashur të largohesha nga vendi im, me këtë rastin në Elbasan, nuk e di se si m'u mbyll goja, pranova, kuptohet, me këmbënguljen edhe të mamase time. Tanimë, vëllai im kishte filluar punë, ai më i madhi, vëllai i dyte pas meje, edhe motrat e vëllezërit e tjerë qenë rritur dhe largimi im nga qyteti e familja ishte pak më ndryshe se në rastet më përpara, gjendja ekonomike e familjes ishte pak më ndryshe, edhe vëllai tjetër pas atij më të madhit, Fatosi, kishte filluar punë në U. M. Bujqesore, Gjirokastrë, kurse ai madhi, pas meje, në parkun e mallrave. Vëllezërit e mi kryen shkolla profesionale, të mesme, e pasi kryen shërbimin ushtarak të detyrueshëm, filluan punë. Pas vëllezërve filloi punë edhe motra më e vogël nga unë e vëllezërit, Elida, po më e madhe se dy të fundit, që babai im i la të vogla, pra filloi punë Elida, në fabrikën e lëkurë këpuceve, Gjirokastrë. Më pas filloi punë edhe motra më pas Elidës, Elisabeta, kjo filloi në Postetelegrafën e qytetit, pasi trashëgoi profesionin e babait tim, telegrafiste për të cilën e ndihmoi praktika që bënte me babanë tim në shtëpi, ku ai i mësonte taston, veglën e punës së tij me alfabetin Mors, të cilin e forcoi më shumë duke bërë një kurs 1 vjeçar pas gjimnazit në Tiranë. Ishin akoma një motër e një vëlla pa punë. Motra më e vogël, Kozeta, sa mbaroi shkollën e mesme, tekstile në Berat, kërkoi për të vazhduar universitetin, e i doli për degen inxhinieri tekstile. Në kohën që unë u largova e u martova në Elbasan, pasi isha fejuar, kjo motra ime, filloi universitetin që e mbaroi pas 5 vitesh. Më pas kjo u martua në qytetin e Delvinës, e sot jeton në Tiranë me bashkëshortin e dy vajza, si drita. Fëmijet e mi sot janë shumë të afërt të 3, por dhe bashkëshorti im është i dhënë pës të treve njëloj.

TEUTA KARANXHA (GANXO)

Ardhja ime në Elbasan u bë dhe nga një faktor tjetër, që më shtyu që të vendosja, të paturit e një kushëriri të pare, vajza e hallës time e cila qe martuar para meje në këtë qytet, Aisheja, kjo ma lehtësoi disi punën e të vendosurit, si dhe mamaja ime me atë, mblesin, që më bëri këtë lidhje, të cilin e kishim djalin e një gjitones tek mamaja ime, dhe që ky qe martuar në Elbasan e që ishte dhe burri i kunatës sime të ndjerë që sot nuk është me, ka vdekur para 2 vitesh e re dhe kjo. Duke qenë se me këtë kushërirën që përmenda, Aishen, kam shkuar që kur ishim në Gjirokastër, qytetin tonë të lindjes, edhe tani shkoj me të, herë herë dalim e pimë ndonjë kafe. Për të më vjen edhe keq, se përveç se e dua si kushërirë, sepse i ka vdekur dhe një djalë, ia kane vrarë në vitin e mbrapshtë, 1997, i ri fare 19 vjeë. E unë tani, tani jam në shtëpinë time në Elbasan me këta dy fëmijet, pasi vajza e madhe është e martuar me fëmije në Tiranë. Ka një bashkëshort të mirë, familjar e të përgjegjshëm. Mbesat, vajzat e vajzës, i duam shumë, ato na vijnë herë pas here, ato jane mjalti i mjaltit, si thotë populli, janë si drita, i paçim me jetë. Burri im i do shumë. Ngaqë kam punuar shumë vetë, që e vogel si e kam thënë dhe më sipër, fëmijët e mi, sidomos djalin e vajzën më të vogël, nuk i kam lodhur shumë, biles këtë të fundit nuk e kam lodhur fare, ndërsa, vajza më e madhe duke më parë mua që punoja, se ishim dhe me prindërit e burrit e kunatën bashkë, kishte dëshirë dhe vetë për punë e më ndihmonte, por dhe unë e kam vënë në punë, se si fëmija i parë, atë kisha më të madhe dhe vete isha e ngarkuar. Për sa i takon djalit e kam dalluar ca nga vajzat se ishte dhe i vetëm e ka qenë dhe i dobët, e më vinte keq që ta lodhja, pasi ka qenë dhe ngrënës keq dhe u rrit që i vogël fare me mungesa të ushqimit në treg atëherë, mezi që mernim një bidon qumësht në rradha të medha që në 4 të mëngjezit, por them se kam bërë gabim që e kam dalluar, sepse fëmijët duhen njëlloj, po ç't'i bëj tani është vonë për ta ç'bërë, por ka vite që kam vënë ekuilibra të rinj, atë

TEUTA KARANXHA (GANXO)

të barazisë në fëmijë. Por mbaj mend që ky, djali, pasi u rrit ca, ka pasur dëshirë të punonte si tregtar i vogël, të shiste artikuj. Kur unë dhe bashkëshorti im në Elbasan, ishim të dy pa punë, bleme një kioske të vogël që ishte në trotuar, buzë rrugës, bulevardit, në lagjen tonë e aty tregtonim gjëra industriale, kinkalerie, po më vonë edhe cigare e ushqime të paketuara etj gjëra. Asokohe u blenë shumë kioska në Elbasan të cilat qëndruan për disa vite e më vonë u hoqën. Djali im që ahëre ishte 8 a 9 vjeç, na shikonte ne në dyqan që shisnim artikuj, e duke ndenjtur me ne kishte dëshirë të shiste dhe ai. Një ditë unë i dhashë një çantë e ia mbusha me ca paketa, shkrepse e i thashë që t'i shiste tek rruga para nesh ku ishte një klub dhe mund t'ja blinin. Që andej ne e kontrollonim se nuk e kishim larg. Ditët e para shiti ndonjë, pastaj më mirë. Një ditë, djali erdhi i mërzitur. Unë dhe burri e pyetëm, se nuk na ra ndonjë gjë në sy, që andej nga e shikonim, e ai nuk na tregoi. Pastaj mua më shkoi ne mend e i thashë të më jepte lekët për ato që kishte shitur. Aty doli se i mungonin lekët, e unë thashë mos i kishte humbur. Po kjo nuk bënte vaki se ishte i kujdesshëm. Pastaj më vonë kur e pyetëm përsëri, me zor na tha që një djalë i ri, i rritur, i kishte marrë paketën dhe nuk i kishte dhënë lekët. I ati, d.m.th. bashkëshorti im i tha t'ja tregonte atë djalin, se para nesh që lokali, por ky femija im, që aq i zgjuar, sa nuk na e tregoi, na tha që ai kishte ikur. Kur ne hapëm përsëri muhabetin e këtij rasti, të nesërmen, ai na tha të vërtetën, se nuk na kish treguar që ne të mos të bënim sherr. Nga një anë kur e menduam më vonë, thamë që bëri mirë, sepse, kushedi se si mund të qenë nxehur gjakrat, midis atij djalit që mund të ishte dhe tip rrugaçi, me burrin tim, e të ziheshin. Që atëherë, ne nuk e lamë më djalin të shiste përjashta, po vetëm në kioskën tonë dhe kur ishim ne vetë, unë ose im shoq. Por djali im e mori si praktikë këte punë dhe më vonë, pasi u prishën kioskat, e ne bëmë një dyqan të vërtetë me mure e pamje të mirë, me të kur nuk ishim

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ne se qe dhe pak me i rritur. Mbaj mend, kur e hapëm dyqanin për herë të parë, falë prindërve të bashkeshortit tim, ndjesë të kenë, e sidomos të nënës së burrit tim që i mbushi mendjen babait të burrit tim, Avdullait, ndjesë pastë, falë fatit që e patëm shtëpinë në katin e parë dhe e adoptuam një dhomë në dyqan, e aty djali im shiste artikujt që ne kishim. Mbaj mend, ne në ditën e parë të hapjes së dyqanit, në 1994, ishte muaji Janar në mbasdite, shitëm një parfum. Ne ishim të dyja me vajzën e madhe dhe shitjen e parë e bëmë ne, vajza ime u gëzua shumë. E kështu vazhduam me këtë dyqan që e bëmë më shumë si kinkaleri, e tregtonim artikuj industrial e lule artificiale. Aty më shumë punonte bashkëshorti im se une fillova sërish pune, si ekonomiste e lartë në Telecom si e kam thënë e më sipër. Tani që jam në pension, mundohem të bëj një jetë aktive. Herë-herë dal si për ecje, herët në mëngjes kur jam mirë, ose dhe për ndonjë kafë me shoqet e mia të punës që kam pasur, si me Meritën psh, që dhe ajo u shkurtua nga puna me pa të drejte, pasi nuk iu suprimua vendi i punës e sot ajo punon si avokate, e që unë e kam shumë shoqe, jo vetëm atë, por dhe motrën e saj Tashën, që është një aktiviste e shkëlqyer e Partisë Socialiste dhe një ekonomiste e zonja.

Unë me familjen, pushimet e verës shkojmë në Pogradec, bëjmë plazh disa ditë, pasi na pëlqen dhe aty bashkohemi për disa ditë edhe me mbesat e kalojmë mirë. Qyteti i katërt, që mua më pëlqen, që e dua edhe këtë, e që shkoj në çdo verë, është Pogradeci. Po kush është Pogradeci, çfarë raporti kam unë dhe familja ime me kete qytet, çfarë më bën mua që dhe kete qytet ta dua, ta pëlqej shumë. Mos ndoshta kjo dashuri vjen ngaqë une jam lindur dhe rritur në një qytet me male, e me një natyrë paksa të egër, por, nuk e besoj, sepse unë edhe pse kam jetuar në vende pa liqene të mëdhenj e dete, përsëri kam shkuar në to për pushime kur vinte vera, si kur isha e re dhe më vonë kur u bëra me familje e fëmijë, në moshë më të pjekur, pasi më qëlloi që dhe

TEUTA KARANXHA (GANXO)

bashkëshorti im donte që të shkonim me pushime atëherë në vitet e monizmit, e kështu vazhdoi dhe më vonë, ku sipas mundësive ne shkonim nëpër plazhe familjarisht.

P o g r a d e c i Qyteti i Pushimeve Verore

Qytet i **Lasgush Poradecit**, nga ka marrë edhe emrin nga ky qytet, shkrimtari i madh i atyre kohrave, shkrimtari i fillim shekullit të XX, poeti, vjershëtori i shquar, i cili nuk e lëshoi penën e tij as në moshë të thyer, por si thekson dhe shkrimtari ynë i madh **Ismail Kadare**, i cili e cilëson si e quanin dhe të tjerët, një bjond, leshra verdhë, edhe pse nuk qe shumë bjond, pra Lasgushi, ka shkruar shumë për Shqipërinë, për shqiptarët, si dhe për qytetin e tij edhe në moshën 80-vjecare. Ky shkrimtar, ishte bashkëkohës me **Fan Nolin dhe me Migjenin**, shkrimtarë dhe poetë dhe këta të mëdhenj, të cilët me anë të shkrimeve të tyre, vargjeve, donin të vinin në dukje problemet e varfërinë e shqiptarëve, e të tërhiqnin vëmendjen e patriotëve të tjerë të vendit, që të kujdeseshin për këtë vend. Po në veçanti Migjeni ka qenë shumë kritik në shkrimet e tij, duke ju bërë thirrje shqiptarëve nëpërmjet vargjeve të tij, që të zgjoheshin e të shikënin varfërinë që iu kishte pllakosur në derë. Për këtë varfëri, edhe më shumë kritik ka qenë edhe F.Noli i cili bënte përgjegjës direkt, qeverinë e vendit, me saktë direkt atë të Ahmet Zogut qe ishte në atë kohë. Ashtu si thekson dhe shkrimtari i madh, Kadare, në veprat e tij, kur flet për këta shkrimtarë. Në shkrimet e tyre, herë direkt e herë me nëntekst, ata kritikonin shkaktarët e këtij mjerimi, e asaj gjendje që ishte në Shqipërinë e asaj kohe. Sidomos Fan Noli ka qenë më i drjtpërdrejtë me kritikën e tij, sidomos në përkthimet e disa veprave si, Don Kishoti etj., në të cilat ai kritikonte qeverinë e A. Zogut. Po ashtu edhe Migjeni, për aq sa jetoi, pasi si dihet jetoi vetem 27 vjet, ai ishte mjaft kritik në shkrimet e tij, duke iu drejtuar me vargje në formë thirrjeje

shqiptarëve, për të lënë kanunet e dasitë, e për të parë çështjet më të rëndësishme për ta, si varfëria, mjerimi, diktatura duke bërë bujë me shkrimet e tij, me vargjet e tij, sidomos ato për mjerimin, varfërinë i madh, me shumë për dashurine, bukurinë, natyrën, hapësirën qiellore, siç e cilëson dhe shkrimtari i **madh, Ismail Kadare**, ai pati sukses me veprën e tij poetike, për yjet, në një kuptim figurativ, nga ana e tij, për hapësirën qiellore, si atë për ndjekjen e yjeve, diçka të tillë. Por nga këta shkrimtare bashkëkohës, sidomos nga kjo treshe, Noli, Poradeci, Migjeni, Fan Noli ishte më shumë në luftë të hapur me regjimin e Ahmet Zogut, ai ishte një kundërshtar shumë i fortë e luftarak ndaj tij, sa edhe Zogu vetë e ndjente këtë gjë. Ndërsa për Lasgushin, Ahmet Zogu ishte shprehur se nuk përbënte rrezik, aq sa, siç e thekson dhe Kadareja në veprat e tij, Zogu ishte shprehur për të në këtë mënyrë: "...le të merret me qiellin, mua më mjafton toka!" E tani, pasi përmendem pak histori, le të kalojmë sërish në qytetin në fjalë, Pogradecin! Qyteti i Pogradecit, shtrihet buzë liqenit, i cili i jep një bukuri të veçantë Pogradecit, sidomos në verë. Në këtë liqen, janë vendasit ata, që merren me gjuetinë e peshkut. Pogradecarët, ata që meren me peshkim, zenë peshkun e bukur e të rrallë të këtij liqeni, belushken e sidomos koranin e bukur me pika të kuqe e shumë të shijshëm, i cili kultivohet në liqenin e Pogradecit, që është vend i dytë në botë që e ka këtë lloj peshku, sepse përveç ujrave të liqenit të Pogradecit, edhe në Rusi, në liqenin e Bajkalit kultivohet ky peshk. Po ta shikosh, në të gjithë vijën bregdetare të liqenit të Pogradecit, panorama është shumë e bukur. Tani që është regulluar edhe rruga, është zgjeruar dhe është duke përfunduar, rrugëtimi për në këtë qytet do bëhet edhe më i kollajtë dhe më i shkurtër në kohë. Ne e pëlqejmë qytetin e Pogradecit edhe për ajrin e pastër e të freskët, sidomos në verë. Kur jemi atje, ato ditë, unë nuk ngopem me ajrin, shëtitjet e mëngjezit buzë liqenit, por edhe ato të mbrëmjes, ku tregtarët i

TEUTA KARANXHA (GANXO)

tregtojnë ato petullat aq të mira e shumë të veçanta, kokoshkat, misrat e pjekur e të zier, si dhe petanikët, apo lakrorët që i thonë pogradecaret, e që pushuesit nga të gjitha anët i pëlqejnë. Pogradecin, bashkëshorti im, e ka për zemër, se që kur që i vogël, aty shkonte me pushime, e rrinte tek kushërinjtë e vet, në fshatin e babait të tij, afër Linit, e aty hipnin nëpër varka me më të rriturit që kapnin peshk, ose shkonte me moshatarët e tij me dhen ose dele për t'i kullotur dhe me kushërinjtë e tij, si Sherifin e Çelikun etj. Sot kur ja tregon fëmijëve, i tregon me mall e nostalgji historitë e ngjarjeve të moshës së vogël në Pogradec e në cilin qytet, tani në këto vite të jetës që kam përpara, do zgjidhja, për verë atë, Pogradecin, të parin për nga klima, pastaj të tjerë qytete për dimër. Po më tepër për dimrin do preferoja Elbasanin, pasi përveç që ka erën e Krastës, që e ftoh kohën, është klimë më e butë në dimër. Këtë e tregon dhe fakti që bëhen agrumet. Pogradeci, ka Drilonin, që janë disa liqene të vegjël, rrotull tyre me gjelbërim, ku qëndrojnë mjelmat, këto liqene, janë dhe në ditët e sotme, por që janë jo si ç'kanë qenë. Mendoj se nuk është vënë dorë, në këtë vend aq të bukur që është jo shumë larg Pogradecit, në një largësi jo më të madhe se rreth 5 apo 6 kilometra. pogradecarët, këtë vend e quajnë Volorek, e ky ka qenë në të gjitha kohët, një vend shumë i bukur, por sidomos me përpara se edhe mirëmbahej. Edhe njerëzit në qytetin e Pogradecit, janë të qetë, të urtë, mikpritës, kjo mbase ngaqë është qytet i vogël, e njihen me njeri- tjetrin. Po të shohësh nga bregu i liqenit, sidomos natën, dallohet Shën Naumi, një vend me pamje të bukur të cilin më parë e kemi pasur ne si teritor, por tani nuk e kemi më e ka Maqedonia. Po ashtu nga bregu i liqenit shihen dhe brigjet e qytetit të Strugës, dritat e tij, që është një qytet i vogël dhe i bukur, së bashku me atë të Ohrit, që është edhe ai aq i bukur. Këto dy qytete, bashkë me Pogradecin, ndajnë bashkë liqenin, i cili, vazhdon dhe andej, në pjesën më të madhe të tij. Në këtë

TEUTA KARANXHA (GANXO)

liqen, përveç peshqve të rrallë, të shumtë e të mirë që ka, janë edhe ca peshq të tjerë, si troftat, krapi, cironkat, që janë peshq të vegjël, këto të fundit, kështu i quajnë pogradecarët, e të tjera lloje. Si në çdo qytet, ku pallatet e rinj janë ngritur ngado, e kanë pushtuar sipërfaqe të tëra toke, dhe në qytetin e Pogradecit janë bërë shumë ndërtime të reja e po bëhen. Po të shikosh fushën e Starovës është mbushur plot me shtëpi të reja private, vila të bukura 2-3, apo 4- 5 katëshe si dhe me pallate me shumë kate. Në këtë qytet, shumë vite para, gjuetia e peshkut ka qenë e kontrolluar, por në vitet e demokracisë ky regull u prish, dhe kjo e ka dëmtuar peshkun, i cili është i rrallë, si korani, belushka duke e gjuajtur atë edhe në kohën e shumimit të tij, është shumë keq, pasi dëmtohet shtimi i pjellorisë, riprodhimit të peshkut, e sidomos kjo është më e dëmshme për peshkun e rrallë koranin, pasi rrezikon pakësimin e tij dhe po vazhdoi kështu, zhduken racat, si specie. Në kohën e monizmit, ky lloj peshku nuk tregtohej nëpër restorante, apo lokale, pasi nuk i shitej popullit, nuk kam parë tsë shitej, ka qenë i ndaluar për popullatën, ndërsa tani, në këto vitet e fundit të demokracisë, kapet, peshkohet, shitet edhe në dyqanet e peshkut, por edhe e gjen të gatuar, e që po tregtohet nëpër restorante. Me sa kuptohet, shteti atëhere e eksportonte dhe populli nuk e hante, por besoj, udhëheqja, patjetër që e hante, si shumë gjera të tjera, që populli atëhere nuk i shihte me sy, e kam fjalën për artikujt e rrallë si përveç peshkut Koran, ishin, bananja, ananasi, etj gjera që ishin me pakice e të rralla për vendin tone, për të mos thënë që nuk i shikonim me sy në treg. Tani falë demokracisë shumë gjera kanë ndryshuar, sidomos ato që kanë qenë mollë e ndaluar për popullin e thjeshtë. Po ka dhe gjëra që si e thashë më sipër, janë çregulluar, e duhet vënë dore. E kam fjalën për qytete si Pogradeci, Durrësi etj qytete ku shkohet me pushime, apo për vizitë, e nuk janë si duhet, por duhet të kenë më shumë vëmendje, si nga rregulli, pastrimi,

TEUTA KARANXHA (GANXO)

gjelbërimi. Jeta e njeriut është e lidhur shumë me ambientin që e rrethon, rregullin, pastertinë në përgjithësi, apo dhe atë të ajrit, mjedisit, në veçanti, nuk mund të jenë të ndara nga njera tjetra, jeta, mjedisi, rregullsia në to. E sidomos në këto qytete, ku njerezit, vijnë me pushime për të shpërndarë, për të mbledhur forcë për të punuar seriozisht në vitin në vazhdim, ky problem i rregullsisë, i ambienteve të këndshme për pushim, shpërndarje, arëtim, më një kuptim të veçantë. Nuk ka kuptim vajtja në qytetin e Pogradecit, për të bërë pushime, apo edhe rastesisht, po nuk shijojë peshkun e kësaj qyteti, apo dhe kernackat, si i thonë ata qoftë të pjekura në prush, të cilat ata i bëjnë mirë, dhe që në verë, në lokalet në buze të liqenit, e pranë lulishtëve ata i tregetojnë. Një gjë më ben pershtypje sa herë që shkoj në Pogradec, ky është bari i freskët i lulishtëve që ri gjithmonë njelloj, jeshil në të gjelbër të çelët, i freskët, e i pa shkelur. Kjo falë shërbimit të punëtorëve të gjelbërimit, që unë i kam parë me zorë uji në dorë duke i ujtur çdo mëngjes në verë. Po ashtu edhe lulishtet e qytetit, që janë shumë të bukura, me lule shumëngjyeshme, karakteristike për Pogradecin, e që janë gjithmonë të çelura, të ujtura, të freskëta, si puna e barit që thashe më sipër. Unë mëdoj se përveç shërbimit të punëtorëve të gjelbërimit, në Pogradec janë dhe njerezit më të kujdesshëm, më me kulturë për mirëmbajtjen e ambienteve të tyre me gjelbërim sidomos, por dhe të tjerave në përgjithësi, si ruget, vendet e hedhjes së mbeturinave etj. Po këtu është dhe kujdesi i madh i bashkisë së qytetit, e cila ka vënë impiante për hedhjen e plehrave nën tokë, si dhe kosha për hedhjen e mbeturinave të vogla, në çdo pak metra. Duke parë lulet gjithandej në Pogradec, të kujtohet, se jo më kot, kësaj qyteti i thonin dhe qyteti i luleve. Lulet që kam parë në Pogradec, më kanë bërë pershtypje edhe në qytetin e vogël të Permetit, në të cilin kam ndeshur një dorë të mirë e të kujdesur për lulet. Mëdoj se gjelbërimi i një qyteti, mirëmbajtja e tij është

kulture ne radhe te pare,pastaj dhe detyrim per ata qe e kane detyre,por dhe per qytetaret qe e shijojne e dhe e shohin cdo dite,e jetojne ne te ne vete qytetin,ruget,lulishtet e tyre. Qyteti i Pogradecit, meqe eshte qytet i plazhit ne vere,qe pret dhe percjell shume njerez,nga brenda e jashte vendit, i takon te gjithëve, sepse te gjithë e shijojne ate. Duke folur per qytetet qe une kam qene, ku kam kaluar, jetuar, mesuar, punuar, etj si ne nje parade, nuk mund te le pa permendur dhe qytetin e Durrësit. **Po cfare me lidh mua me kete qytet do te thoni ju, kete po jua spjegoj me poshte.**

Durrësi, qyteti i plazhit tonë

Në këtë qytet edhe pse nuk kam jetuar, punuar, apo mësuar nëpër shkolla, përsëri e kam një qytet të dashur. Kjo ndjenjë më vjen ndoshta, ngaqë aty kam pasur të afërmit e mi që unë i vizitoja shpesh, për më tepër që kam qenë afër me Tiranën ku unë kam bërë shkollat. Në Durrës unë kam pasur hallën,motrën e babait, ku shkoja shpesh tek e ndjera, pasi ka disa vite që ka ndërruar jetë. Vec kësaj, kam pasur dhe një kushërirë nga mamaja, teze Minon, vajza e xhaxhait të mamasë, ndjesë pastë dhe ajo, këto kanë qenë një arsye më shumë që unë kam qenë e kam shkuar, por edhe pa qenë këto, unë do shkoja, pasi në këtë qytet shkonim në plazh për pushimet e verës, sidomos në kohën e monizmit. Plazhi i Durrësit ka qenë i preferuar atëhere si dhe sot. Para viteve '90, ne shkonim ose me kabina, ose me fleta kampi. Tani në demokrac shkojmë privatisht, në shtëpi me qera, ose me autobuza ditore vajtje ardhje .Vec këtyre nga Durrësi kam pasur dhe disa shoqe shkolle, në shkollën Teknologjike në Tiranë, këto ishin Suzana Kapllani dhe Sadete Sheni. Në Durrës kam ndenjor kur isha në shkollën e mesme në Tiranë, si e ftuar nga shoqja ime e Durrësit, Suzana, për 2 javë. Ajo më ftoi atëhere, pasi donte që të mësonim bashkë, për provimet e maturës, pasi unë isha nxënëse

TEUTA KARANXHA (GANXO)

më e mirë se ajo. Suzana po të ulej të studionte jepte rendiment, por me zor ulej, dhe për këtë arsye më kërkoi ndihmë nga unë. Ajo e kishte shtëpinë tek Vollga, afër saj si dhe afër me kalanë, që atëhere unë e pëlqeva shumë Durrësin. Nëna e saj Nailja, punonte në uzinën e duhanit. Suzana ishte e lezecme, me sy të mëdhenj. Që në shkollë u dashurua me një djalë që ishte student në Tiranë, por nuk përfunduan bashkë. Suzana ishte vajzë e dashur, e shoqërueshme, por nuk qe tipi im, ajo ishte më lozonjare, unë isha ëe serioze. Ajo kishte dhe dy vëllezër, nëna e saj ishte e divorcuar dhe poi rriste fëmijët e vetme. Për Durrësin mund të themi se është shumë i dëshiruar nga të gjithë. Për këtë ai nuk është vetëm qyteti i durrsakëve, por nga pak i të gjithëve. Po ti referohemi historisë e të kthehemi mbrapa në kohë, Durrësi është qyteti, që organizoi rezistencën kundër Italisë fashiste, në kohën kur ajo na sulmoi në 7 Prill të 1939. Jo më kot kësaj dite të kobshme, populli i ka ngritur këngë si: “Ditën që hyri Prilli,/ pushoi këngën bylbyli...etj..

Patriotet luftëtarë si, Mujo Ulqinaku e shumë të tjerë trima, u përballën me ushtarët Italianë, që zbritën nga anijet e tyre, për t'iu drejtuar brigjeve të Durrësit. Po kjo rezistencë nuk zgjati shumë, pak ditë, pasi populli ishte i pa armatosur. Ish mbreti Zog ishte larguar, shteti nuk funksiononte si duhej, vetëm tek tuk ndonjë direktivë a urdhër i ndonjë ministri të qeverisë së atëhershme. Tashmë e gjithë vemendja ishte që të mbahej Tirana, pasi shumë qytete ishin pushtuar. Mbrojtja e vendit ishte shumë e vështirë, pasi forcat Italiane ishin të shumta, kurse ato tonat ishin vetëm disa qindra, në grupe të vogla rezistence që ishin organizuar më shumë nga patriotë e luftëtarë vendas, e më shumë vullnetarisht, se sa të organizuar. Kështu e dimë nga historia. Po citoj disa vargje të këngës kushtuar luftës, më shumë Mujo Ulqinakut, i cili ra duke luftuar si patriot, luftëtar trim, i paepur në mbrojtje të lirisë së Durrësit, të Shqipërisë. “Durrës ti, o Durrës plak,/ hasmi

po të shkel në prag,/ po lufton një ulqinak,/ lufton djali, lufton plaku,/ lufton Mujo Uqinaku,/ gjer në gju na vajti gjaku,/ bjeri Mujo Ulqinaku”. Për liri. si të gjithë qytetet e fshatrat e vendi tonë dhe Durrësi e ka larë me gjak lirinë e tij, nga shumë dëshmorë të rënë. Durrësin e kanë lakmuar shumë vende të huaja, sidomos fqinjët tanë. Jo të pakta kanë qenë përpjekjet e ish Jugosllavisë për të gllabëruar pjesë të vendit tonë, sidomos Durrësin, pasi ata donin që të kishin dalje në det. Këtë e kam lexuar si nga historia e jonë, por edhe në shumë shkrime të tjera të shkrimtarëve e historianëve të huaj, një prej të cilëve edhe Zhustin Gudart, diplomati francez, që ka shkruar shumë për vendin tonë, si e kam përmendur dhe më sipër, por edhe të tjerë shkrimtarë i kanë përmendur këto përpjekje e synime për të marrë me pa të drejtë, territore nga vendi ynë.

Durrësi më ka pëlqyer me plazhin e tij, me detin, me rërën, me rrugën për tek Vollga, që është për mua një perlë, me panoramën e saj, me lokalet, muzikën, me zhurmën e gjallërinë e saj. Në rini na pëlqente shumë kjo zhurmë, ndërsa tani dua më shumë qetësinë, qe e ka më shumë Pogradeci. Po edhe Durrësi ka vende të ndryshme për plazh si, Golemi, Shkëmbi i Kavajës, Mal i Robit etj. Durrësi ka më shumë shtrirje, hapsirë, lokale nate e dite, e për këtë e pëlqen shumë si rinia dhe mosha mesatare, ndërsa më të moshuarit, duan një vend më të qetë, sic është Pogradeci. Po Durrësi ka kripën e detit që është me vlera kuruese, që e bën plazhin e tij të veçantë, si dhe jodin e detit, që janë kurative për shëndetin. Tani në demokraci mundësitë janë më të mëdha për pushime. Dhënia e shtëpive me qera e ka zgjidhur këtë problem, perveç hoteleve që janë të shumtë. Mua si person, më pëlqejnë shumë qytetet me det apo me liqen, kot nuk ka dalë ajo shprehja, ”afër detit, afër mbretit”. Këto qytete, sidomos në verë janë të këndshëm, me gjallëri, me freskinë e ujit, që është elementi më jetësor, si dhe me freskinë e ajrit, që është po aq

TEUTA KARANXHA (GANXO)

jetësor, janë qytete romantike, për panoramën e bukur që krijojnë deti, qielli, toka dhe rëra në plazh, që së bashku me gjelbërimin e me njerëzit përreth bëhet shumë romantike, shumë e dashur, interesante, ndjellëse, dehëse. Familja ime pra, unë, burri im dhe të tre fëmijët e mi kemi qenë shumë si në Durrës dhe në Pogradec, por tani në vitet e fundit, 3 a 4 vitet e fundit, kemi zgjedhur Pogradecin, se plazhi i Durrësit është populluar shumë dhe ka pasur për pasojë ujra të ndotur nga mos mbajtja e regullit si nga njerëzit dhe nga mos kontrolli nga ana e atyre që e kanë për detyrë, nga ana e institucioneve përkatëse... Si pasojë e hedhjes së mbeturinave vend e pa vend, plazhet janë ndotur dhe si të tillë nuk të vjen të shkosh në këto vende. Tani ka ca kohë që sikur po ndryshon, po pastrohet si bregu i detit apo liqenit dhe po ashtu dhe rëra. Gjëja që më pëlqen mua në afrim të mbrëmjes në këto vende është mëngjesi, kur bej ecjen e mëngjesit cdo ditë, dhe mbrëmja kur dielli perëndon dhe e përpin deti e vjen nata, ku hëna është ngjitur lart e ka zëvendësuar diellin duke ndricuar, e bashkë me të dritat e shumta që bashkë me muzikën e lokaleve të natës e bëjnë mbrëmjen të gëzueshme, të hareshme. Une jam natyrë e ndjeshme, e si e tillë më pëlqejnë shumë këto lloj natyrash, ku dora e zotit i ka dhënë të gjitha të mirat, bukuritë, që ne njerëzit e krijuar po nga ky zot, ti gëzojmë, ti shijojmë, ti ruajmë, të kujdesemi, që ti kemi përherë të bukura, të pastra, të virgjëra sic janë shumë natyra të pa shfrytëzuara, me qëllim që ti kemi ne dhe brezat që janë pas nesh e të tjerë që do vijnë. Ajo që na kërkohet të bëjmë ne si qytetarë, si njerëz të formuar, është fare pak krahasuar me atë që kanë bërë të tjerë njerëz, që kanë jetuar disa breza para nesh, si para lufrave turke, greke, italiane e gjermane etj, si dhe më pas. Ashtu si përmendet dhe nga historia, për shumë vende, qytete e fshatra të vendit tonë, por dhe për Voskopojën, për traditat, zakonet si dhe për përbërjen shoqërore, fetë, lufrat, natyrën e Voskopojës, janë të shumta përpjekjet e

TEUTA KARANXHA (GANXO)

njerëzve në breza që në kohën e Skënderbeut, e deri në gjithë periudhën e sundimit otoman, përmendur në librin e shkrimtarit tonë të njohur Ben Blushi, në romanin e tij, “Te jetosh në Ishull”, ku bëhet fjalë për shqiptarët, që kanë jetuar në Voskopojë, të bashkuar, të krishterë e muslimanë, duke u drejtuar nga trima e njerëz me tradita e ndjenja të forta kombëtare për trojet e tyre, për të mos lejuar turqit që të hynin në Voskopojë, si e përmend dhe autori, duke trajtuar problematikat shoqërore e politike të Voskopojës e të vendit tonë në tërësi, për përpjekjet e shqiptarëve të dëgjuar, luftëtarë e trima, të krishterë e muslimanë të atëhershëm, që janë personazhet e librit si, Arianit Komneni, Mihal Komneni, Sara Komneni si dhe bashkëshorti i Sarës, Ibrahim, i cili kaloi nga i krishterë në musliman, të cilët kanë qenë nga familje me emër, e që kanë qenë breza trashëgimtare të prijësit Arianit, në kohën e Skënderbeut, që i ka dhënë Donikën për grua, pra vajzën e tij Skenderbeut, me qëllim për të bërë dhe aleancë për forcimin e mbrojtjes kundër Turqisë etj. trima që luftuan pa u kursyer për Voskopojën, Shqipërinë e deri në Janinë e Kretë, ku ranë shumë trima në luftë me turqit. Edhe ne sot, në vazhdë të këtyre heroizmave e të shumë të tjerave përpjekje të atdhetarëve tanë të Rilindjes e deri më vonë në kohën e luftës për arsimin shqip, e pas të asaj për clirim e deri në ditët tona, ku kemi pasur e kemi shumë njerëz të nderuar që e duan kombin, punojnë për të, le ti ruajmë dhe ne vendet tona sot në këtë kohë paqeje, të sjellë nga ato brezat e mëparshëm, të ruajmë e të forcojmë traditat. zakonet e tona si shqiptarë, tua përcjellim brezave këto, të ruajmë e pasurojmë këto bukuri natyrore, të mbajmë të pastër jo vetëm ambientin, por dhe shoqërinë shqiptare, ta ruajmë nga ndotjet natyrore, si dhe ndotjet e tjera si nga barbarizmat e huazimet, në gjuhë e në të folur, le të flasim Shqip në vendin tonë. Ky është dhe mesazhi me te cilin unë po i afrohem mbylljes së shkrimit tim, në udhëtimin, në rrugën e jetës sime. Me këtë rast

TEUTA KARANXHA (GANXO)

falenderoj zotin dhe prindërit e mi që më dhanë jetën, që më rritën e më bënë ajo që unë jam sot, falenderoj secilin që kam pasur pranë në familje e shoqëri, si dhe të afërm,që më kanë dashur dhe i dua, që kanë ndarë me mua gjithcka të mirë e të keqe, falenderoj shumë edhe i dua shumë bashkëshortin dhe fëmijët e mi, faleminderit që ekzistojnë, si dhe vëllezërit dhe motrat e mi shumë të dashur, me të cilët jam shumë e lidhur, dhe pse jam larg në distancë. Megjithëse po i afrohem fundit të shkrimit tim për jetën time, nuk mund të le pa përmendur dhe një qytet tjetër po aq të dashur për mua, edhe pse nuk kam jetuar e punuar a mësuar në të, por që e kam shkelur dhe vizituar, e pak kohë dhe kam pushuar në të. Ky qytet është qyteti i bukur i Sarandës, qytet ky, së bashku me Delvinën, komshi me qytetin tim të lindjes , Gjirokastrën.

Saranda Perla e Jugut të Vendit

Ky është një qytet tjetër që unë e dua, pasi është qytet i Jugut, i trevës nga jam dhe vetë. Ky qytet, që është jo më shumë se 1 orë e pak nga qyteti i Gjirokastrës, kuptohet, kur lëviz me makinë të vogël e jo me autobus, ka vecantinë e tij. Qyteti i Sarandës është një qytet i vogël, por shumë i bukur, ai më ngjason pak me qytetin e Pogradecit, sepse rrugicat i ka pothuaj njëlloj, edhe shëtitoren buzë detit, në të gjithë gjatësinë e saj. Këto dy qytete kanë edhe shumë gjera të përbashkëta, bukurinë buzë ujit, freskinë, romancën etj. Ky qytet, që laget dhe është në buzë të detit Jon, i cili ka të vecantë ngjyrën blu të thellë të ujit, thellësinë e tij qysh në breg, ka dhe një klimë më të butë se ajo e qytetit të Gjirokastrës, i cili ndryshe nga Saranda, është i rrethuar nga male gjithandej. Qyteti i Sarandës të tërheq përveç se me plazhin e tij të bukur, edhe me disa pika turistike e piktoreske, por edhe historike e të hershme. Këto janë si, Kalaja e Lekursit, Butrinti, Syri i kaltër etj. Në këtë qytet kam qenë disa herë me familjen time për pushime verore, si në kohën e monizmit, por dhe më pas,

TEUTA KARANXIIA (GANXO)

por tani, në këto vite nuk kam qenë më aty, sepse aty ku une jetoj kam më afër qytetin e Pogradecit, të cilin e kam frekuentuar më shumë tani, por dhe në Durrës ndonjë herë kam shkuar me ditë. Ajo që të bën përshtypje dhe në këtë qytet është mikpritja, bujaria dhe dashuria që kanë njerëzit për njeri- tjetrin si dhe për të ardhurit me pushime në stinën e verës. Aq të bën përshtypje kjo gjë, ashtu si dhe në Pogradec, sa të duket, sikur njerëzit, edhe të panjohur, sikur janë të afërt me njeri- tjetrin, miq ose kushërinj. Këtë gjë nuk e kanë qytetet e tjera më të mëdha, ose kjo mund të jetë dhe traditë më shumë e njerëzve që jetojnë në jug të vendit, të Shqipërisë, ose ngaqë mund të jenë edhe më shumë autoktonë, vendas, por mua më duket se njerëzit e Jugut, si dhe ata atë Veriut i kanë më të ruajtura traditat e mikëpritjes dhe të dashurisë për njeri- tjetrin, qofshin këta dhe të pa njohur. Ashtu si dhe në Pogradec edhe në Sarandë më pëlqen si mengjesi, po ashtu dhe mbrëmja, sidomos mbrëmja me atë xhiron buzë detit, që nuk ka të paguar, me atë muzikën e mbrëmjes, pa harruar dhe tregtarët e vegjël, ambulante, që shesin produkte të ndryshme nëpër rrugë, si të ngrënë dhe të tjera artikuj industrialë, apo artistike. Nuk mund ta mbyllja këtë shkrim pa e përmendur dhe këtë qytet, i cili ka dhe shumë të vecantë dhe të përdorshëm peshkun e tij, të llojeve të ndryshme, si përshebull llojet si qefull, levrek, koce, ngjalë, trofte apo llojet e karkalecave të detit, midhjet etj.....të cilët janë të parat produkte që serviren nëpër restorantet e Sarandës. Saranda ka klimë të mirë, të butë dhe dimri atje nuk është i ashpër. Kjo e dallon dhe nga qytetet e tjera bregdetare, sidomos nga Durrësi që ka erën karakteristike të tij sidomos, në dimër. Por, përveç këtyre 6 qyteteve, që unë përmenda, në të cilat unë kam jetuar, jam shkolluar, kam bërë pushimet verore, kam dhe një qytet tjetër të admirueshëm, që në ëndrra e kam dashur dhe këtë, sepse ky edhe më ngjason pak me Gjirokastrën, ashtu

TEUTA KARANXHA (GANXO)

me duket, të cilin e kam vizituar vetëm një herë. Ky është qyteti i Korcës, ose si i kanë thënë ndryshe njerëzit, Parisi i vogël.

K o r ç a P a r i s i i v o g ë l

E quajnë kështu, besoj prej zhvillimit, qytetërimit të tij të hershëm. Korçarët që në kohët shumë përpara, kanë qenë shumë punëtorë, të emancipuar, kjo falë emigrimit të tyre të hershëm, që në vitet 1900, sipas mundësisë që kishin, kanë kaluar kufijtë e vendit, duke shkuar sidomos në Amerikë, po dhe gjetkë në vende të zhvilluara. Kjo ka bërë që atje të marrin qytetërim ndryshe, të marrin kulturë ndryshe, të fitojnë dhe para, e kështu të ndihmojnë ekonominë e familjeve të tyre dhe të qytetit të tyre. Ka pasur nga ata që kanë dërguar dhe fonde që andej nga janë, nga ato kursimet e tyre, për të ndërtuar dhe ndonjë rrugë, apo rrugicë të lagjes, e për të restauruar pse jo, dhe ndonjë kishë. Korca ka qenë një vend arsimdashës e kulturëdashës, si dhe Elbasani e ndonjë vend tjetër, në këtë qytet, u hap dhe mësonjtorja e parë shqipe. Jo më kot i këndohet dhe kënga, si më poshtë: "Lumja ti moj Korcë o lule, / që le pas shoqet e tua, / si trimi në ballë u sule, / ta pacim për jetë hua!" Në Korcë u hap dhe liceu i parë. Korca dallohet jo vetëm për arsimin, kulturën e patriotizmin, por dhe për muzikën e saj. Kjo vjen shumë e dashur e ëmbël, si e kam përmendur dhe më sipër, në rrëfimin tim për të, sidomos, serenatat korcare, që janë me famë, e që nuk ka familje korcare që të mos i këndojë, e nuk ka shqiptar që të mos i dojë ato. Ato të ngrenë peshë, të përkëdhelin, si dhe sikur të përkundin. Korca ka shumë këngëtarë të dëgjuar, po ajo që mua më tërheq më shumë, e që e admiroj, është Eli Fara, por dhe Lazarela, si dhe ata dy vëllezërit korçarë, Endri dhe Stefi. Këngët e Elit unë i kam pasur nëpër kaseta, disqe e i kam dëgjuar shpesh. Ato që më pëlqejnë më shumë nga këngët e Elit, janë ato si: "**Perëndesh e bukurisë më je, / unë për ty**

moj do të pëlças , / dashurinë që kam shtënë për ty, / obobo si do tia bëj...!"/ etj., si dhe ajo tjetra: “ Kur nata Korcën e mbulon, / dhe kafenetë mbushen plot, / atje rri zemra ime dhe vajton, / dhe raki kërkon, / do të vi do të vi moj xhan, / do të ulem dhe do të qaj, / zjarrin e zemrës sime do ta shuaj moj me duhan, / do të vi do të vi moj shpirt, / do të ulem dhe do të rri, / zjarrin e zemrës sime, / do shuaj moj me raki...!” etj..vazhdon akoma. Në Korcë kam qenë një viti, me bashkëshortin dhe djalin tim, atëhere, kur në Elbasan binin shumë tërmete, para disa vitesh, ato ishin të shpeshta dhe njerëzit nga frika, natën dilnin në rrugë, e një pjesë flinin nëpër makina përjashta, për cdo rrezik. Për këtë, ne vendosëm që të lëviznim ca ditë, e si fillim shkuam në Pogradec tek njerëzit e bashkëshortit tim, tek kushërinjtë e tij, në një fshat të Pogradecit. Po si për ironi të fatit, tërmetet sikur na ndoqën, sepse dhe aty ra një tërmet, por më i lehtë, e ne lëvizëm përsëri, shkuam drejt Korcës, ky qe dhe mendimi im se nuk e kisha vizituar Korcën asnjëherë. U nisëm me një fugon dhe për gjysëm ore arritëm në Korcë. Hyrja e saj nuk mu duk gjë, por më pas, pasi ecëm me brenda, pamë kishën, rrugët e rrugicat, parkun e këtij qyteti etj. më pëlqeu. Korca mu duk si një zonjë e rëndë nën hijen e malit të Moravës.

Kur isha në shkollën e mesme në Tiranë kam pasur 2 shoqe nga Korca, Diton dhe Fatmirën, me të cilat kam kohë pa u parë. Njëra nga këto është martuar dhe jeton në Elbasan, Fatmira Ibro, e takova nja dy herë kur erdha në fillim në Elbasan, shkuam dhe në shtëpitë e njera-tjetrës, pastaj nuk e pashë më, ndërsa Diton, e kam takuar një herë në fillim kur erdha në Elbasan, i shkova në Cërrik, se aty jetonte e martuar, pastaj më thanë se iku në Greqi, në emigracion, dhe nuk pamë më. Ditua, u dashurua me atë që në shkollën Teknologjike ku ishim bashkë. Kështu, si e përmenda më sipër, me familjen në Korcë, kemi ndenjur një ditë e më pas u kthyem sërish në Pogradec, e pastaj në Elbasan. Këtu tërmetet

TEUTA KARANXHA (GANXO)

sikur qenë rralluar disi. Në këtë periudhë, vajzat e mia nuk ishin në Elbasan. Vajza e madhe ishte në Tiranë, në shkollë, ndërsa e vogla ishte tek njerëzit e mi në Gjirokastër. Prindërit e Arjanit, bashkëshortit tim, ndjesë të kenë nuk jetonin më atëhere. Kjo ishte dhe për sa i përket rrëfimit tim për qytetin e Korcës.

E tani për të lëvizur nga Korca, theksoj, se këtë shkrim, unë e bëra në vigjilje të 80- vjetorit të ditëlindjes së nënës time, si një dhuratë për nënën time të dashur në radhë të parë, si dhe si një kujtim të shkruar, për të gjithë, për veten time, si dhe për fëmijët e mi dhe burrin tim, por dhe për të afërmit, shoqërinë time, si dhe për cdo lexues që do ti bjeri në dorë ky shkrim. Jo vetëm kaq, por ky do jetë dhe si një ditar i jetës sime, që unë dua ta kem të shkruar dhe të përmbledhur, për ta pasur dhe para syve të mi si një pasqyrë edhe pse i kam të freskëta këto kujtime në mendjen time, përsëri duke qenë të shkruara, mundet që ta lexoj sa herë që unë të dua, si unë po ashtu dhe familjarët e mi, por vecanërisht fëmijët e mi, të cilët të shohin, të lexojnë, të ndjejnë dhe ata pak nga ato që kam kaluar unë, nëna e tyre, me qëllim që të dinë se jeta nuk është shesh me lule, por duhet shumë punë e luft, sakrifica, përpjekje, devocion në punën që bën, përkushtim në familjen tënde që po ndërton, apo që e ke ndërtuar etj. gjera që duhen bërë në jetë. E bëra këtë shkrim, pasi koha ecën dhe ndonjëherë dhe kujtimet në mendjen e secilit, zbehen me kohën, por ajo që është e shkruar nuk vdes kurrë. Duke përfunduar kujtimet e jetës sime deri këtu ku kam ecur në rrugët e saj, them se jeta më ka mësuar që të shikoj përpara, përpos vështirësive, problematikave e fatkeqësive, që më kanë ndodhur, shumë punëve që unë kam bërë, mendoj se kam akoma detyra për të bërë, për t'u kujdesur për veten time, familjarët e mi, të afërmit etj. njerëz në nevojë, për nipër e mbesa që kam e që do të lindin nga fëmijët e mi.

Për të gjitha ato që kam bërë dhe do bëj, falenderoj, në radhë të parë zotin, që më ka drejtuar në rrugën e tij, që më ka hedhur me njerën dorë, e me tjetrën më ka ngritur.

Falenderoj shumë së dyti nënën time, që më ka mësuar, edukuar, më ka dhënë shumë dashuri, forcë, gjithcka dhe më jep akoma. I uroj asaj në këtë 80 - vjetor, jetë e shëndet, pleqëri të mbarë, të jetë nënë e gëzuar. Prandaj, për këtë, dua të citoj disa vargje të recituara nga artistja jonë e madhe e teatrit dhe kinematografisë, Margarita Xhepa, të kënduara nga këngëtarja jonë Jolanda Dhamo, kushtuar nënës. Këto janë vargje për të gjitha nënat:” **Kur zemra thërret nën,/ të gjitha i ka thën,/ njëlloj të jesh në botë,/ edhe nënë edhe zot!**” Jo vetëm kaq, por dhe në librat e shenjtë, nënës i jepet përparësi. Konkretisht e shprehimisht po citoj disa rreshta të lexuara si: **“Duaje atë, duaje atë,/ duaje atë, nënën,/ duaje dhe babanë!”** Pra 3 herë përsëritet këshilla që jepet për të dashur në vecanti nënën. Prandaj për të gjitha këto thënie, këshilla si shoqërore dhe fetare, në një mënyrë të vecantë duhet që të duam nënat, pasi ato na japin jetën, na rrisin, e nuk pushojnë gjithë jetën nga përkushtimi e detyrimi ndaj nesh, fëmijëve të tyre, sado të mëdhenj qofshim, sikur edhe 50 apo 60 vjec për nënat, ne mbetemi gjithmonë fëmijë. Por edhe për ne, nënat asnjëherë nuk kanë moshë, sado qofshin, ato janë nëna, e sidomos kur i humbasim ato, moshë sado e thyer të jetë, nuk na ngushëllon, ato janë nëna, vetëm nëna. Edhe unë jam një nënë e tre fëmijëve, e si shumë nëna, dua që të jem gjithmonë në vazhden, rrugën e nënës time, model i saj. Nuk e di se sa do të arrij, po do të përpiqem. Jetën time deri tani ia kam përkushtuar familjes sime, fëmijëve të mi, bashkëshortit tim, e nga pak edhe rrethit familjar, motrave e vëllezërve, për të cilët ndjej një detyrim të madh, sepse jam motra më e madhe, por e para për mua, pas fëmijëve, është nëna. Edhe pse jam në distancë me familjen time të madhe, prindërit, motra e vëllezër, nuk rri pa komunikuar me

TEUTA KARANXHA (GANXO)

ta, të marr vesh si janë, çfarë halle e probleme kanë, duke biseduar në telefona, por edhe shkoj shpesh i shikoj. Ne si familje e madhe jemi të lidhur shumë me njeri-tjetrin, e kështu do të vazhdojmë. Jeta ime kështu do të jetë me detyrat e saj për familjen që kam këtu ku jetoj, si dhe me përkujdesje dhe për familjen e madhe që kam në vendin ku kam lindur e jam rritur. Për mua nuk kanë rëndësi shumë paratë, jo se nuk duhen, por më të domosdoshme janë virtytet, dashuria për njeri-tjetrin, përlësia, të jesh i dëgjueshëm, i sjellshëm, jo mendjemadh, fodull e kokëfortë, mbi të gjitha duhet të dish të falësh, sepse si i thonë fjalës, gabimi është njerëzor, por falja është hyjnore. Këtë dua që të kenë parasysh dhe fëmijët e mi, këto cilësi. Unë këtë mesazh u përcoj atyre, të kenë dashuri me njeri-tjetrin, të bëhen të dobishëm për familjet e tyre që kanë krijuar e do të krijojnë, si dhe për shoqërinë, të na duan ne prindërve, ashtu si dua dhe unë të mitë, të jenë të respektueshëm në shoqëri. Edhe ne, prindërit e këtyre fëmijëve kemi akoma për të bërë, por edhe pse jemi akoma në moshë jo të thyer, duhet që të shohim dhe pak veten tonë, sepse për ca vjet do jemi në moshë të thyer, që është mosha e tretë, e si të tillë do të jemi në vitet e fundit të jetës sonë, që është në dorë të Zotit, po kështu është cikli i jetës, do të ikin të vjetrit, do vazhdojnë të rinjtë, rëndësi ka që jeta, ajo të eci, të riprodhohet, të ketë vazhdimësi. Nuk ka rëndësi se sa vjet jeton, po se si e jeton jetën, ajo duhet jetuar, sikur cdo ditë e saj të jetë e fundit. Po a e bëjmë ne këtë? Them se jo, sepse janë dhe shumë faktorë sociale dhe ekonomike, që nuk e bëjnë dot atë, plotësisht të mundur, e që nuk varen nga ne, po ka dhe gjëra që varen nga ne, ato ti shohim mirë, e të

mos i lemë të na kushtëzojnë jetën e përditëshme. Po sidomos ne gratë, që jemi dhe krijesa më të ndjeshme, të mos biem në pesimizëm në vitet e pleqërisë, kur ajo të na vijë, apo atyre që ju ka ardhur tashmë, të mos ndihen të padobishme, sepse janë në

TEUTA KARANXHA (GANXO)

këtë moshë, se tani nuk bëjnë dot punët që bënin dikur, dhe si të tilla nuk i duan më njëlloj, si familjarët e tyre, po ashtu dhe të afërmit. Ato duhet të dinë se janë akoma të dobishme, edhe sikur të mos të bëjnë më asnjë punë, kanë fjalën e tyre, cilësitë e tyre mencurinë, eksperiencat e tërë jetës, dashurinë pa kufi, për fëmijët e tyre, nipërit, mbesat, e të gjithë të njohurit.

Në një libër të shkruar, nga aktorja, kineastja e madhe Sofia Loren, kjo aktore e madhe me famë botërore, në librin e saj, ajo bën fjalë për gratë dhe bukurinë e tyre, si të mbajnë trupin e tyre, pamjen e tyre të bukur, e në formë, ku tregon sekretet e saj për bukurinë, si e ka mbajtur ajo, e si duhet të veprojnë gratë për të qenë të bukura, në formën e tyre më të mirë pavarësisht moshës. Ajo citon nga fundi i librit, për rolin e rëndësishëm e madhe të gruas, në familje e shoqëri. Mesazhi i saj, për të gjitha gratë, e sidomos për ato të moshës së thyer, është ky: **“Edhe kur duart e fytyrën tuaj, ta kenë mbushur rrudhat, edhe kur duart t’ju dridhen nga moshja, asnjëherë mos mendoni se nuk vleni, se nuk duheni më. Juve, që aq shumë keni bërë me ato duar, e akoma bëni, ato janë të dobishme si dhe ju, kur ju me zërin tuaj, me përkëdheljen tuaj, prekni fëmijët tuaj, nipërit e mbesat. Ata ju duan, sic ju kanë dashur!”** E me këtë mesazh të Sofia Lorenit, e cila tashmë është për vete një grua, me moshë të thyer, duke marrë forcë, edhe unë për veten time, edhe ne të gjitha gratë e vajzat për ta mbajtur lart moralin, forcën, se kurdoherë, them se jemi e do të jemi të dobishme. Familjet dhe shoqëria, kanë shumë nevojë për ne, **“ne jemi motorri i shoqërisë, jemi kënga, muzika e shtëpive tona, jemi vetë dashuria dhe jeta.”** Më thoni ju a mund të mbinte e të bëhej gjë në këtë botë, n.q.s. nuk do të kishte tokë, jo nuk bëhej asgjë. Prandaj për këtë, **ne gratë, vajzat, jemi si vetë toka, në të cilën mbijnë shumë farëra, bimë e pemë të ndryshme, në trupin tonë, mer formë, lind dhe rritet**

TEUTA KARANXHA (GANXO)

vetë jeta. Jeta pa ne do të ishte e zbrazët, e shurdhët edhe e zymtë, prandaj dhe zoti na krijoi.

Pa e zbehur dhe rolin e burrave në jetën tonë, kjo është një e vërtetë e pamohueshme. Me këtë fabul, apo metaforë, si mund ta quajmë, po e përfundoj dhe unë shkrimin tim, pasi dhe unë jam një ndër ato shumë gra apo vajza, që e jetojnë jetën e tyre, sic e jetoj dhe unë atë timen. Kjo pra ishte jeta ime, të cilën unë do e vazhdoj, që ta jetoj, me mundësitë që do më jepën, me forcën që kam pasur e kam, dhe me dashurinë e respektin për të, si një dhuratë nga zoti dhe nga prindërit e mi, sikur cdo ditë e saj, të jetë dita ime e fundit. Kjo duhet të jetë motoja e jetës për cdo njeri, pasi jeta na jepet vec një herë dhe nuk ka kthim pas për ta jetuar prapë atë sërish nga e para. Ajo është e pakthyeshme, e pa përsëritëshme. Prandaj, o ju njerëz, kudo që jeni, jetojeni jetën tuaj, mos e lini të iki atë pa e jetuar si duhet! Cdo njeri në fund të jetës së tij, afërsisht në një moshë madhore, të vjetër, e bën një bilanc të jetës, duhet që ta bëjë, si jetoi, si punoi, si gëzoi. Dhe në fund fare po citoj fjalët e këngës në festivalin e Radio Televizionit Shqiptar, të muajit Dhjetor të fundvitit 2014, festivali i 53: **“Jeta qenka si fëmija, jepi dorën që t’a ngresh!”** Por, nuk mund ta mbyll akoma këtë shkrim pa përmendur dhe disa vargje të shkrimtarit, poetit të madh **Dritëro Agollit**, të cilat bëjnë që cdo njeri që i ka lexuar apo kënduar ato me melodi, ti ndjejë thellë në shpirt. Ato janë vargjet:

“Kur ti të jesh mërziur shumë, / në mes të librave qëndro, / atje atje i fshehur do të jem unë, / në ndonjë rresht a ndonjë shkronjë, /

por unë do të vi, / do të vi pranë teje, do të vi...etj...etj...”

Këto vargje unë i përmenda jo pa një kuptim, por për të gjithë ata që më duan dhe i dua, si familjarët e mi, miqtë, shoqëria ime, ata që duan të më gjejnë e të më njohin më mirë, por dhe që të më

TEUTA KARANXHA (GANXO)

kujtojnë e të cmallen me mua, duhet të lexojnë, e të më gjejnë në këto rreshtat e shkrimit tim. Unë do jem me ta!

Kjo ishte pra, jeta ime, e jetuar sipas ritmeve të saj, sipas mënyrës edhe mundësisë time, sipas kohës, ku unë e jetova atë, e ndarë në dy kohë, një pjesë në diktaturë, si fëmijëria e rinia, e pjesa tjetër në demokraci, ajo e moshës së pjekur dhe më pas moshë madhore e ajo e vjetër që do të vijë pas pak vitesh. Në këtë shkrim për jetën time, unë kam dhënë si dhe kam përmendur dhe disa ngjarje për historinë e qyteteve që kam shkëlur, jetuar, punuar apo pushuar e shkolluar. Kam përmendur pak nga historia, apo dhe kultura e tyre, për atë sa kam pasur njohuri dhe atë sa kam hulumtuar, pasi historia e tyre është shumë më e gjerë si edhe kultura e tyre, pra ka shumë për të folur për to, e për këtë flasin më mirë historianët e shkrimtarët, prandaj unë nuk jam zgjatur shumë, pasi nuk jam dhe në atë stad për ti përshkruar sa e si duhet, si dhe nuk ka qenë dhe ky qëllimi kryesor i shkrimit tim, por ka qenë kryesisht historia ime e jetës, punës, familjes e shoqërisë time, aty ku kam jetuar e punuar, apo ku jam shkolluar e kam pushuar. Edhe njëherë kërkoj ndjesë për ndonjë lapsus apo ndonjë pasaktësi, në përshkrimin e ngjarjeve të qyteteve të rrugëtimit të jetës sime, të historisë e kulturës, si dhe arsimit të tyre. Unë jam munduar sado pak ti paraqes këto qytete, me njohuritë që unë kam pasur dhe që kam fituar në jetë.

F U N D

Elbasan më Dhjetor-Mars 2015



100